


BIBLIOTERA

B SH-31  
A 37

Dritëro Agolli

# Kalorësi lakuriq

Roman



ÇABEJ


8SH - 31

A 37

Dritëro Agolli

# *Kalorësi lakuriq*

roman



ÇABEJ

Profesori dhe akademiku Xheladin Apollonia, njeri me autoritet të madh në shkencat ekonomike, me ballë të gjerë vija-vija dhe me flokë të thinjur, shtatlartë dhe pérherë i veshur me kostum ngjyrë hiri, rrinte në dhomën e tij të punës me një lehtësim në shpirt, rrinte dhe shikonte i përmallshëm raftet e librave përmes tymit të kaltërt të cigares që mbante në buzë. Sapo e kishte mbaruar së shkruari kumtesën që do të mbante në një konferencë shkencore për disa probleme ekonomike, kumtesë që e pati munduar ditë me rradhë dhe i pati ngjallur mjaft shqetësime, të cilat mund t'i marrin me mend vetëm ata që kanë provuar të shijojnë pemën që rritet në fushën e humtimit dhe të krijimit shkencor.

Tek rrinte, madje mund të thoshim, notonte në atmosferën krijuuese, në dhomën e punës me një dritare të madhe dhe ball-kon të gjatë, dhomë që e quante studio, erdhën ta takonin dy kolegët e tij të vjetër, njerëz me grada shkencore të rëndësish-me, anëtarë të komisionit qendror të përgatitjes së konferencës kombëtare. Këta ishin anëtarët me korrespondencë të Akademisë, Zyrap Kandari dhe Sotir Kucka, burra me horizont të gjerë kulturor, të dy të hollë, me fytyrë të imët dhe shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin, aq të ngjashëm sa mund t'i merrje si binjakë. Edhe kostumet i kishin të njëllojtë, edhe kravatat, edhe këmishët. Vetëm këpucët u ndryshonin ngaqë nuk i kishin këmbët të barabarta. Ndofta, edhe puna në të njëjtat kushte të veprimtarisë shoqërore kishte ndikuar për t'i bërë këta dy njerëz të ngjashëm, pasi flisnin me gjuhë të përafërt, me terma dhe përkufizime të njëllojta, "koncepti ekonomik, veprimi i ligjeve ekonomike, akumulimi, vlera, kostoja" e me radhë.

E kështu, ata erdhën në studion e profesorit dhe akademikut Xheladin Apollonia me ndjenjën e admirimit dhe përulësisë së madhe ndaj tij. Sa e zunë për dore, thanë të dy përnjëherësh:

– Mbaroi, domethënë!

Xheladin Apollonia u ra shpatullave, iu lut të uleshin me mirësjellje të lartë dhe iu përgjigji:

– Mbaroi! Kumtesë e vështirë! Vlera, mbivlera, ligji themeltar e të tjera... – pastaj: – po gratë nuk i paskeni marrë? Ah, gratë! Punë, telashe, kokëçarje me fëmijët, radhë në dyqan...

Zyrap Kandari vështroi Sotir Kuckën me një domethënie të madhe. Profesori dhe akademiku ynë më i shquar, i zhytur në hulumtime shkencore, për një çast nuk harron ngarkesën e grave në punët e shtëpisë! Pu-pu! Ç'burrë – mendoi ai dhe u përgjigji:

– Gratë vijnë pas nesh, profesor!

– Mbaroi kumtesa, domethënë! – tha Xheladin Apollonia. I ngriti lart fletët që fshihnin perlën e veprës, i tundi pak në erë dhe me përkëdhetje i vuri përsëri në vendin e tyre.

Të dy kolegët e vjetër i kryqëzuan vështrimet mbi dorë-shkrimin me përulësi, siç bëjnë zakonisht përpara njerëzve me autoritet të madh.

Këtu u hodh Sotir Kucka, duke zgjatur përpara dy buzët e holla dhe duke formuar me to shkronjën o:

– O! Kumtesë e vonuar vërtet. Por lisi dhe rrapi blerojnë vonë. Bajamja dhe kumbulla blerojnë herët! Kemi një kumtessë-lis! He-he! – dhe ngriti lart gishtin e hollë.

– O! Kumtesë-lis! – përsëriti kolegu i tij Zyrap Kandari.

Xheladin Apollonia vuri buzën në gaz dhe trokiti me gishterinj në tryezën e lëmuar e të llistrosur, se sapo ia kishin sjellë në shtëpi, trokiti me një kënaqësi të veçantë shpirtërore.

– Vlera, mbivlera, ligji themeltar e të tjera... – përsëriti ai frazën që i kishte mbetur në mend nga kumtesa.

– Në plan teorik, domethënë! – tha Zyrap Kandari.

– Në rrafsh teorik, domethënë! E po në këtë rrafsh duhen parë fenomenet ekonomike. He-he! – tha Sotir Kucka dhe lëvizi paralelisht syçkat. – Nuk mund të hyjmë në hollësira se sa

mund tē fitohet nē kêtë ndërmarrje apo nē kêtë kooperativë. Në ekonominë politike, që është zemra e marksizmit...

- Edhe leninizmit, – e ndërpree Zyrap Kandari.
- Që është zemra e marksizmit... – përsëriti Sotir Kucka.
- Edhe leninizmit... – e ndërpree përsëri Zyrap Kandari.

– Të lutem! Shumë tē lutem! Ti s'më le ta them fjalën «leninizëm». Më ndërpret pikërisht pas «marksizmit» – u nxeh Sotir Kucka. – Pra, në ekonominë politike, që është zemra e marksizëm-leninizmit, kanë rëndësi ligjet themelore të zhvillimit: vlera, mbivlera, raportet send-mall-para. Ky është objekti ynë i studimit. Pa, se sa qumësht japin lopët nē tufat dhe tufëzat le ta shohin veterinerët dhe mijelëset...

Ndërkohë ra një qetësi. Studioja e profesor Xheladin Apollonisë heshtte e djersirë nga barra e librave, kumtesave, diskutimeve, fjalimeve dhe dosjeve. Sytë e Zyrap Kandarit dhe Sotir Kuckës, përkëdhelnin kêtë djersë tē ndershme, tē grumbulluar prej kohësh nē muret e kësaj studioje.

- Ka punë gruaja e shkretë me këto libra! Pastrim nga pluhuri, sistemim... – tha Zyrap me sy nē libra.
- More, pluhuri nuk mbetet, se ato shfletohen orë e çast, por sistemimi, thuaj! – ndërhyri Sotir Kucka.
- E, po! S'e pamë gruan! – tha Zyrap Kandari.

Akademiku u ngrit, vuri dy gishtat e mëdhenj nën sqetulla nē tē dy anët e jelekut, si Lenini, nxori gjoksin përpara dhe filloi tē ecë: – Është pak e shqetësuar për punën e çupës. Pardje e nisëm nē Vjenë ta vizitojë ai profesori i famshëm. Ka kohë që vuan nga bajamet! – tha ai.

Zyrap Kandari mori pamje serioze dhe tē vuajtshme:

- Nuk janë tē thjeshta bajamet! – tha ai.

Akademiku Xheladin Apollonia ferkoi mjekrën me njérën dorë, ndërsa me tjetërën shtrëngoi një kopsë nē jelek.

– Mjekët tanë janë tē zotërit. Por me fëmijët e kuadrove u dridhet dora. Atëhere nga një bajame e pëson fëmija. Prandaj disa kuadro janë tē detyruar t'i bëjnë operacion fëmijët nē Vjenë apo nē Paris.

– Nga dy bajame se... – nuk është një bajame, por dy... – e ndërpree Sotir Kucka.

Pastaj ata qeshën të tre. Dhe pa u shuar gjurmët e buzëqeshjes, në korridor, të cilin Xheladin Apollonia e quante sallon, u dëgjuan zëra grash dhe përnjëherësh në studio, bashkë me zërat, hyri edhe era e mirë e kozmetikës. Erdhën ato që priteшин Adelina dhe Anifeja. Anifeja, e shoqja e Zyrapit, një grua e hijshme, e gjatë, me sy me bisht në formën e bajames, me flokë gështenjë, të derdhur e të ndritshëm e me një zë të butë, ia dha dorën e para Xheladin Apollonisë dhe u ul para tij, që ta kishte brenda veprimit të fushës së rrezeve të vështrimit të saj. Adelina, gruaja e Sotir Kuckës, me triko të trëndafiltë, e shëndetshme, e ndrojtur, pak e ngathët, me flokë të verdhë, u ul pranë të shoqit duke lënë pas një psherëtimë përtacie. Pak pas tyre erdhi edhe Rita, e motra e Sotir Kuckës, një zeshkane e pamartuar, me një bluzë të bardhë si kartë, me një vijë të hollë në mes të buzës së poshtme, e pashme dhe me një trup të lëmuar si të nepërkës. Ajo ishte më e bukura e të gjitha femrave të ardhura, se përvëç të tjerave ishte e re si studente, megjithëse kishte dy vjet që kishte mbaruar Universitetin përmjekësi. Rita kishte pamje krenare dhe mospërfillëse, aq sa edhe akademiku Xheladin Apollonia nga vështrimi i saj ulte sytë.

Gruaja e profesorit i la një copë herë gratë në shoqërinë e burrave përmarrë gjérat që nevojiteshin përmirësuar. Në një tabaka të gjatë ajo solli gotat me liker dhe konjak, karamëlet dhe çokollatat dhe iu uroi mirëseardhjen.

Duke afruar gotën në buzkat e saj të trëndafilita, Anifeja i ndali sytë në kumtesën e akademikut, që shtrihej në një cep të tryezës:

- Mbaroi, profesor?
- Më në fund! – u përgjigj e shoqja e profesorit triumfalisti pa ia lënë radhën Xheladin Apollonisë.
- E shoh që edhe gratë po marrin pjesë në fatin e kumtesave tonë!... – tha profesori duke ngritur vetullat.
- He-he! Është e natyrshme. Në familjet e shkencëtarëve ngaherë do të flitet përmirësuar... – tha Sotir Kucka.

Profesor Xhelafin Apollonia vuri përsëri dy gishtërinjtë e mëdhenj nën të dy sjetullat në jelek, u ngrit, nxori gjoksin përpara dhe filloi të ecë në atë copë vendi të lirë të studios, siç bënte kur i vinte në mendje ndonjë ide. Gratë, me admirim të papërmbarjat, e ndiqnin me vështrimet e tyre dhe prisnin se ç'mendim do t'i fekste këtij njeriu me kulturë të madhe, që numërohej si krenaria e kryeqytetit.

– Në përgjithësi, – tha akademiku, – nga bisedat në familje mund të nxjerrësh konkluzionin se nga ç'profesion janë kryefamiljarët. Në familjet e mësuesve bisedohet për problemet pedagogjike, në të shoferëve për problemet e komunikacionit e me radhë.

– Ku i gjen këto shprehje profesori! – tha Anifeja, duke përpjekur buzkat me erë të mirë dhe duke kapulitur syçkat në formën e bajmes.

Ndërsa Rita e vështroi me përcnim Anifenë se iu duk tepër e gjunjëzuar para akademikut. Fundja, në fjalët e akademikut asnjë mendim të zgjuar nuk kishte. Ishin ca fjalë të zakonshme që çdo njeri mund t'i shprehte. Anifeja e vuri re vështrimin përcmues të Ritës dhe uli syçkat. Edhe profesori e ndjeu dhe për të kapërcyer situatën ngriti kokën:

– Gëzuar edhe një herë, vëllezër dhe motra!

Pas trokitjes së gotave papritur u dëgjua zilja e derës. Burrat e gratë shfaqen në fytyrë pakënaqësinë, që nuk mund të rrinin dot të qetë pranë akademikut të famshëm. Gjithmonë kështu ndodh. Sa fillon një kuvendim i këndshëm, troket dikush në derë dhe ta merr lumi kënaqësinë!

– Prisni miq, profesor? – pyeti Anifeja.

Xheladin Apollonia hapi krahët:

– Shtëpia ka portë! Porta është për të hyrë dhe për të dalë.

– Ç'fjalë! – pshëreti Anifeja.

Vërtet erdhi një mik i papritur. Ishte shoku i fëminisë të profesorit, Dane Gajtani, që punonte në një kooperativë bujqësore jashtë rrëthit të Tiranës. I gjatë sa një lis i vendlindjes, ai mbante në dorë kapelen prej kashte dhe rrudhët hundën me lesh ngaqë ndjente parfumin e grave. U përqafua me Xheladin Apolloninë, i zuri për dore të gjithë dhe u ul, duke mbaj-

tur në gjunjë kapelen e kashtës. Xheladin Apollonia përnjëherësh u trishtua. Ah, vetëm të mos i shkojë në mend Danes për të përdorur atë zakonin e prapë! Ah, ç'zakon të keq që ka! Po e përdori, na turpëroi në sytë e këtyre grave të nderuara! Vetëm mos i teket! Na ruaj zot! – mendoi në çast Xheladin Apollonia dhe iu drejtuar shokut të tij të fëminisë:

– Ka kohë që s'na ke dalë nga Tirana!

Dane Gajtani, gjithmonë me kapelen e kashtës në gjunjë e me qime të gjata mbi kurriz të hundës, i vështroi një herë gratë e bukura, i shkoi kalimthi sytë mbi burrat e tyre dhe u kthye me tërë trupin nga profesori dhe akademiku...

– Jam ftuar në Konferencën Shkencore, por erdha pak më përpëra se kam edhe një punë tjetër.

– Ashtu? – pyetën në të njëjtën kohë Zyrap Kandari dhe Sotir Kucka.

Ai i vështroi që nga lart të dy dy anëtarët me korrespondencë, shtrëngoi anët e kapeles prej kashte dhe pyeti:

– Ju të dy vëllezër jeni?

Ishte një pyetje pa ceremoni, që të jepte përshtypjen sikur Dane Gajtani tallej. Por ç'ishte e vërteta ai e kishte me gjithë mend pyetjen e papritur.

– Të njëjtën gjë mendojnë ata që i shohin për herë të parë!

– tha Anifeja. – Por nuk janë vëllezër. Janë shokë të ngushtë.

– Gëzohem! – tha Dane Gajtani dhe iu drejtua Xheladin Apollonisë:

– Të shohim në televizor, të dëgjojmë në radio, të lexojmë në gazetë, i dashur Xheladin! Na bëhet qejfi që nga bangat e dikurshme të asaj shkollës sonë të vjetër, doli një njeri me dituri të madhe. E kam fjalën, që të shoh e të takoj shpesh, vetëm se nuk të prek dot me dorë, se në ekran të televizorit ti je transparent, fluror, figurë, pasqyrim materiali.

Gratë vunë buzën në gaz dhe filluan ta kthejnë vëmendjen në këtë burrë, që në pamjen e parë u la përshtypjen e një njeriu larg fushës kulturore. Vetëm Rita nuk reagoi. Ajo rrinte me gotën e likerit të gjelbërt përpëra dhe vështronte studion e akademikut librat dhe dosjet e trasha. Njeriu me kapele kash-te nuk i bëri ndonjë përshtypje të madhe gjer në ato çaste që

foli fjalët e fundit. Mbështetje nuk donte ta jepte veten, siç bëjnë disa vajza, që kanë formuar një mënyrë sjelljeje të tyren për t'u treguar moderne me një gjakftohtësi si të shtirë. Pastaj vjen një çast që kjo gjakftohtësi shkrihet dhe shembet copëracopëra si akulli dhe ato nxjerrin lakuriqësinë e tyre. Megjithatë Ritës i bënë përshtypje qimet e gjata dhe të zeza në kurrizin e hundës së këtij njeriu. Ky me këtë hundë do të bëjë ndonjë çudi! – mendoi ajo dhe i erdhi për të qeshur nga ky mendim.

Xheladin Apollonia iu kthye miqve:

– Me Dane Gajtanin, siç e dëgjuat nga goja e tij, kemi qenë bashkë në shkollën fillore. Unë mbarova studimet e larta, ai për arsyen ekonomike i ndërpren për një kohë dhe i vazhdoi më vonë. Tani është veteriner në kooperativën bujqësore N. Ka qenë shakatar i madh, – tha akademiku dhe mendoi për atë zakonin e prapë të Danes. “Po ta përdorë, më fiku!”

Anifeja, e shoqja e Zyrapit, i perëndoi syçkat në formën e bajames në drejtim të Danes dhe i ndali mbi qimet e gjata në kurrizin e hundës. Duke ia soditur qimet, humbi në përfytyrimë të çuditshme. Sikur këtë hundë me qime, mendoi ajo, të ta mbështesë në qafë e në gjoks, ç'mund të ndjesh vallë? A mund të të vijë të gudulisura? – dhe filloi të qeshë duke mbuluar buzkat me dorën e vogël të bardhë si top dëbore.

Dane Gajtani, pa dashur vuri gishtërinjtë në leshin e hundës me vështrim nga Anifeja si i përhumbur. Xheladin Apollonia, duke e njohur mirë natyrën e Danes, filloi të shqetësohej dhe mendoi se do të ndodhë ndonjë hata.

– Zonjë, – tha Dane Gajtani, me dorë në hundë, – nuk iu lejoj të kulloj si gjatë në leshin e hundës sime!

Këtë e tha pa turp, si një gjë të zakonshme. Prandaj Anifesa në fillim i dolën sytë nga orbita, pastaj u pushtua nga një e qeshur pa fre. E qeshura ishte kaq e madhe, sa iu muar fryma nga që gjelltiti gjellënjka të mëdha ajri. I shoqi i saj, Zyrap Kandari, u ngrit, e vështroi vëngër Dane Gajtanin, mbushi një gotë me ujë dhe ia dha gruas për ta qetësuar nga kolla. Ndërsa Rita kishte ulur kokën në gjunjët e hijshme dhe qeshte, duke spërkatur fundin e saj të kuq. Që nga këto çaste ajo filloi ta admirojë këtë njeri që nuk u ngjante burrave të këtij rrëthi shkencor.

Dane Gajtani i shkoi më pranë dhe duke mërmëritur "vlera, mbivlera, ligji themeltar e të tjera", e zgjati gishtin e ia vuri në prapanicë akademikut, nën të çarën e pasme të xhaketës. Akademiku ndjeu nga pas gishtin e Dane Gajtanit dhe u hodh përpjetë, duke i hequr duart nga jeku.

– Dane! – tha ai ngadalë dhe me të lutur.

– Vlera, mbivlera, ligji themeltar e të tjera, – tha Dane Gajtani dhe u ul, duke e lënë akademikun në këmbë.

Të gjithë të turpëruar, nuk guxonin të vështronin në sy njëri-tjetrin. Si është e mundur një sjellje e tillë? T'i vesh gishtin nga prapa një akademiku? Dhe tavani i studios së shkencëtarit u duk sikur u ul mbi tryezë. E vetmja që nuk i kishte ulur sytë përdhe ishte Rita. Edhe ajo e paturpshme shikonte buzagaz Dane Gajtanin, i cili ia mbyllte syrin e djathtë, duke bërë ca shenja të pahijshme. Dy gratë e tjera filluan të flasin vesh më vesh dhe pastaj të qeshnin fshehurazi nga burrat. Por Anifeja nuk u përmbajt. U shtrëngua, u skuq e tëra në fytyrë dhe e zbrazi të gjithë të qeshurën në tryezë.

– Uh, uh, uh! Amani se vdiqa!

Kaq duhej pér të qeshur të gjithë në një kor të përbashkët. Me këtë kor u bashkua edhe akademiku Xheladin Apollonia, kurse Dane Gajtani rrinte tërë inat me kapele në gjunjë. Atëhere ndërhyri Neta, e shoqja e akademikut, pér të ndryshuar këtë atmosferë, që në dukje ishte e gëzueshme, por përbrenda tepër e nderë. Gruaja e akademikut u ngrit, ia mori kapelen e kashtës Danes dhe, duke ia kthyer vithet e trasha, tha në ecje e sipër:

– E ç'ma mban këtë kapele në gjunjë sikur do të ta vjedhin?

Dane Gajtani u hodhi një vështrim nga lart poshtë vitheve, lëvizi pakëz gishtin dhe i vrenjtur nuk foli, por tundi kokën me mérzi. Akademiku në fillim, kur Neta ktheu vithet, ngriu i téri. U-pu-pu, bëri ai me vete. Mos i shkrepet pér ndonjë marrëzi tjetër më të paturpshme dhe t'i vërë Netës gishtin nga pas!

– Vërtet, kumtesa është e një niveli të lartë shkencor! – tha Sotir Kucka, duke iu drejtuar Dane Gajtanit pér të marrë mendimin e tij dhe pér të qetësuar gjendjen.

Dane Gajtani aty për aty ia mori një këngë:

*Në studion me libra të rrallë  
Ku rri miku im Xheladin  
Po vijnë kolegët me radhë  
Dhe zonjat pa dert e trishtim.*

*Po vjen dbe një mik i braktisur  
Nga fshatrat diku prapa resh  
I lodhur me fat të gremisur  
Dhe hundën e shkretë me lesh.*

*Po vjen nga vrapon tufëzimi  
Nga qan për një qengj çdo fshatar,  
Po vjen ku gjëmon diskutimi  
Për ligjin e madh themeltar.*

*Jeton ky ligj nëpër libra  
Fshatari pa lopë jeton,  
Në hell shkencëtarë pjek qiqrra,  
Fshatari për gjizën vajton.*

*Këndojmë ekonomi politike  
Kumtesat i bëjmë përsesh.  
O Dane, ke gjuhë heretike  
Dhe hundë të madhe me lesh...*

Ai këndonte me zë të trashë, duke i përcjellë vargjet qartë sikur t'i recitonte. Burrat dhe gratë e dëgjonin me kureshtje të madhe.

- Ç'vargje, more! – tha Sotir Kucka.
- Të hidhura! – psherëtiu akademiku Xheladin Apollonia.
- Megjithatë bukur! – tha Sotir Kucka.
- Po kumtesa e profesor Xheladinit si t'u duk? – e pyeti Dane Gajtanin akademiku Zyrap Kandari.

Dane Gajtani me majë të gishtit preku leshin e hundës. Burrat dhe gratë prisnin mendimin e tij. Sakaq ai tha:

– Zero! Ze-ro!

Menjëherë pas kësaj fjale të vetme, por të rëndë në përsëritjen e saj, në studio asgjë s'pipëtiu. Ajri u rëndua si para një rrëbeshi. Vetëm Rita ndjente një kënaqësi të jashtëzakonshme. Autoritetit të madh të shkencës guxoi një njeri t'i thotë zero! – mendoi ajo më tepër ndoshta për snobizëm se sa për ndonjë objektivitet.

– Mos bën shaka? – e pyeti Anifeja Danen, që kishte pranë.

– Zero! – përsëriti Dane Gajtani dhe vetullat e trasha i ranë mbi sytë e mëdhenj.

– U-u-u! – u dëgjua në dhomë një zë i bashkuar si oshëtimë.

Akademiku Xheladin Apollonia u mundua ta vërë buzën në gaz, megjithëse e dinte se Dane Gajtani nuk bënte shaka.

– Daneja me mua nganjëherë bën shaka! - tha me ndrojtje.

Dane Gajtani rrinte i drejtë në karrike dhe trupi i tij i madh ngrihej mbi të tjerët një pëllëmbë më lart. Ai ndoshta nuk do të fliste, sikur Rita Kucka të mos i kishte hedhur zjarrit benzinë me qëllim që Dane Gajtani ta shpinte deri në fund mendimin.

– Doemos bën shaka! – tha ajo me vështrim të ëmbël në fytyrën e Danes.

– Nuk bëj shaka! – tha ai, – lexova disa fletushka pa vlerë, me fraza të përgjithshme që askujt nuk i hyjnë në punë!

Ai u bë më i errët në fytyrë. E hodhi këmbën mbi këmbë dhe mbështeti krahun si degë ahu, duke vështruar nga dritarja. Sillte ndërmend kumtesën që sapo kishte lexuar, mundohej të kujtonte ndonjë frazë, por më kot. Para syve parakalonin vetëm shkronjat që formonin fjalët: vlera, mbivlera, ligji themeltar, kostua, cilësia, arritjet dhe “në këtë drejtim”. Dane Gajtani sikur të ishte fillikat, psherëtiu dhe tha me një zë të zvarritur plot pikëllim:

– Rrëmbimi i bagëtive të fshatarëve dhe futja e tyre në tufa e tufëza, lënia e bujqëve pa tokë vetjake, fryrja e kooperativave bujqësore dhe kthimi i tyre në kombinate të palëvizshme, varfërimi dalëngadalë i fshatit, ngordhjet e herëpashershme të dhene, prishja e jetës shpirtërore të njerëzve; shkatërrimi i

virtuteve njerëzore, vdekja shkallë-shkallë e demokracisë, që sjell shuarjen e civilizimit... Dhe kumtesat: vlera, mbivlera e të tjera... Peh! – bëri ai dhe u hodhi një vështrim shfarosës të gjithëve në studion e lustruar, në studion me erë të mirë, në studion me gra të hijshme. Pas këtij vështrimi ai e çoi këmbën nga këmba tjetër dhe e lëshoi me forcë, me gjithë peshën e saj, në dysheme.

U bë një heshtje e thellë. Dëgjohej vetëm frymëmarrja e njerëzve dhe ndonjë pëshpëritje e grave mes tyre. Secili mendonte se si mund të dilej nga kjo heshtje e pakëndshme. Dhe kjo u gjend. E shoqja e akademikut, Neta, që Dane Gajtani e njihte mirë, ngaqë kishte ardhur shpesh në shtëpinë e tyre, psherëtiu:

- Eh, ç'të bësh? – tha ajo kot, pa kuptim.
- Çupës tani duhet t'ia kenë filluar analizat! – tha Anifeja.
- Mjekët e Vjenës sa të shkosh në spital, të fillojnë analizat!
- tha Sotir Kucka.
- E po, bajamet ka për t'i operuar! – tha Adelina, gruaja e rrumbullakët e Sotir Kuckës, që gjer atëhere nga përtacia nuk kishte folur asnjëherë.
- Bajame, vërtet, por!... – tha Zyrap Kamberi.
- Të bëhet mirë pa! – tha akademiku.

Dhe Dane Gajtani mësoi se e bija e akademikut Xheladin Apollonia kishte shkuar në Vjenë për të bërë operacion bajamet, që në gjuhën shkencore quhen angina. Por për këtë gjë ai nuk u interesua dhe nuk e vrau mendjen. Vështroi vetëm orën në dorën e majtë, një orë të madhe, që dikur kishte qenë orë xhepi. Atë pastaj e kishte përshtatur për në dorë.

Kur i hodhi vështrimin orës, kolegët e akademikut dhe vetë Xheladin Apollonia pritën me padurim që ai të ngrivej.

– Keni ndonjë punë që vështronit orën? – pyeti pa takt Sotir Kucka, me sy të vegjël në orën e Danes.

- Kam, – tha Dania.
- Ndonjë punë që ka lidhje me shkencën? – pyeti Anifeja.
- Aty, aty! Kam ardhur të marr spermë! – tha ai ftohtë. – Spermë demash dhe deshësh të racës, për mbarsjen e lopëve dhe dhënve. Lëng i gjallë, lëng që bën qënie lëvizëse...

Njerëzit ulën kryet. Anifeja dhe gratë e tjera u skuqën. Rita shikonte Danen sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ajo ishte mjeke dhe ky term i dukej i zakonshëm.

- Nuk flitet në këtë mënyrë! – tha akademiku.
- Aman! – prishi buzkat Anifeja.

Dane Gajtanit iu ngrit një damar i trashë në ballin e madh dhe iu drejtua Xheladin Apollonisë.

– Po s'i flitet? E dini ju që kooperativat dhe fermat bujqësore marrin spermë në qendrën zooteknikë në Tiranë? – ai u kthyte pastaj nga gratë: – dhe kjo spermë, zonja të nderuara, vlen për ndërzin e dhënve dhe lopëve... Nuk u folka kështu! Po ç'emer t'i vemë spermës që ju të mos turpërohi? Shkenca i ka emrat të saktë. Në anatomi, që e njeh mirë kjo doktoresha, – tha ai dhe e vështroi Ritën, – është përshkruar me hollësi edhe prodhimi i spermës nga penisi.

– Mjaft tani, – tha Anifeja, duke zënë veshët me dorë dhe u ngrit. Por Dane Gajtani kishte në mend të ngrivej me kohë. U çua nga vendi, mori kapelen prej kashte të varur në korridor, i zuri për dore të gjithë dhe doli.

– I tmerrshëm, – dëgjoi Dane Gajtani nga pas pëshpëritjen e grave dhe ndali për një çast.

– *E dini se mua ky njeri më pëlqen. Patjetër dua ta takoj!* – tha Rita e skuqur.

– Është edhe i pamartuar, – tha Neta, e shqoja e akademikut.

– Është njëlloj, edhe të jetë i martuar, për mua nuk ka rëndësi! – tha Rita.

Dane Gajtani dëgjonte i qetë, duke hapur ngadalë derën e korridorit që të nxirrte në shkallët. Në zbritje të shkallëve ai bëri me buzë:

– Pëh!

Në fund të shkallëve Dane Gajtani qëndroi dhe mbajti vesh. Ndjeu trokitjen e takave të një palë sandaleve, një trokitje me ritme të shpejta, dhe e kuptoia se ishte një grua që vravonte. Me anën e trokitjes së hapave ai mund të përfity-

ronte qenie të tëra të gjalla: dele, dhi, lopë, kuaj, mushka... Ndërsa gratë e kishte shumë lehtë t'i dallonte, madje që në hapat e para. Ah, kjo është grua, mendonte ai kur dëgjonte një hap me ritme të barabarta e simetrike, si tingulli i rrokjeve të vjershave me vargje të matura. Dhe e pëlqente hapin e grave, veçanërisht në mes të qetësisë së një mëngjesi apo të një mbrëmjeje. Duke dëgjuar trokitjen e takave të grave, ai përfytyronte edhe kërcinjtë dhe pulpat e tyre të hijshme, vithet e rrumbullakta lëkundëse si lëkundjet e dy të verdhave të vezës në pjatë, gjinjtë me thumba në mes, me uljet e ngritjet kërcënuese, llërët e lëmuara me lëvizjen e këndshme para dhe pas... Në mëngjes këto hapa atij ia vazhdonin èndrrat që kish-te parë natën. Në mbrëmje ia largonin mendjen nga vogëlsirat dhe andrallat e ditës.

Hapat që ndjeu në shkallë përnjëherësh i têrhoqën vë-mendjen, prandaj qëndroi dhe mbajti vesh. Pastaj qeshi me vete, bëri me dorë në erë dhe u largua me xhaketë nën sqetull. Duke ecur murmuriti: vlera, mbivlera, ligji themeltar e të tjera. Tek murmuriste ndjente se po ajo trokitje sandalesh me po atë ritëm po bëhej më e qartë dhe më kumbuese. Po më afrohet një grua, mendoi ai, por nuk e ktheu kokën.

*Aty për aty dëgjoi një zë!*

*– Veteriner Dane Gajtani!*

Qëndroi gjithmonë pa e kthyer kokën. E kuptoi se ishte Rita Kucka. Po kjo ç'do? Unë tani sa isha mes shoqërisë së saj intelektuale, mendoi ai pa lëvizur. Këto vajza e gra moderne si Rita, që herë i hapin dhe herë i mbyllin buzkat, që herë përkëdhelen duke u përdredhur si nëpërka, dhe herë tregohen të rrepta si tigresha; që herë kalojnë në elegancë dhe herë në vulgaritet zhapiu, ai i donte se përpinqeshin të mjerat të prishnin monotoninë e moralit shoqëror, i donte se zbavitej me takimin zhurmues dhe vlues të tyre. I vinte edhe për të qeshur me mençurinë e tyre të shtirë, me gjestet dhe lëvizjet asimetrike të gjymtyrëve, duarve, këmbëve, gjoksit. Kjo zbavitje për atë, ndonjëherë ishte çuditërisht e domosdoshme, kur vinte në kryeqytet. I qeshej, por edhe trishtohej me dëshirën dhe synimin e këtyre vajzave dhe grave për të shëmtuar dhe

banalizuar veten, për të mbathur pantallona të shtrënguara që e tregojnë qartë trekëndëshin e fryrë përpara dhe që nxjerrin thelat e mishit njerëzor prapa, për të lidhur në mes rrypa të rrjepur si palldëme kuajsh; për t'i shpupurisur flokët si në çastin kur ngrihen nga gjumi, për t'i lyer qerpikët, queskat e syve, vetullat e faqet me ngjyra të tillë që shtrembërojnë figurën e femrës... Sigurisht Rita me veshjen e saj nuk kishte ndonjë synim për ta shëmtuar veten, përkundrazi ruante masën e ndjenjës për t'u treguar elegante dhe tërheqëse. Por ajo mundohej ta shëmtonte veten në një kënd tjeter: në fjalët e ashpra dhe të egra në bisedë, në snobizmin e sjelljes, në anarkizmin e moralit, në patrupësinë dhe lakuriqësinë e mendimeve, doemos pa rezikuar në qëndrimet politike... Ajo ngrinte krye dhe nuk e dinte se kundër kujt ngrinte... Edhe kjo e bënte përtë qeshur Dane Gajtanin.

– Veteriner Dane Gajtani! – u dëgjua përsëri zëri i Ritës tek ai qëndronte pa lëvizur kokën, sikur t'i vinte drojtje të tregonte hundën me lesh.

– Ju mori malli të kullojni në leshin e hundës sime? – tha ai me fytyrën përpara.

Rita qeshi me zë të lartë. Vetëm atëhere Dane Gajtani ktheu kokën dhe e pa Ritën tek i afrohej me trupin e saj të lëmuar dhe të lakueshëm si të drerëve të maleve. Ajo i ra Danes pakëz në ije me grushtin e vogël, sikurse të kishte vite që e njihte dhe e qortoi për sjelljen e papërfillshme ndaj seksit të bukur.

– Vërtet, - tha Dane Gajtani, – kam një zakon të prapë që mezi e kthej kokën pas. Ky zakon më ka mbetur që në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, kur filloi të më rritej leshi në hundë. Atëhere mua më vinte turp ta ktheja fytyrën para njerëzve, pasi sa më shikonin, më quanin «hundëlesh». Nga ky turp, edhe kur më thërrisin me zë të lartë prapa shpine, nuk ua tregoja fytyrën. E shihni se ç'zakon më ka mbetur?

– Mua më pëlqen hunda juaj me lesh! – tha Rita me patrupësi, po natyrshëm dhe pa asnje lloj shenje snobizmi.

– Zonjëz, – tha Dane Gajtani, – një lavdërim të tillë nuk ma ka bërë asnje femër. Një vajze të hijshme si ju nuk i shkojnë fjalët hundë dhe lesh, megjithëse unë ato i mbaj

tërë jetën me vete. Po leshin unë e kam me shumicë në një vend tjetër.

Ajo u skuq dhe qeshi. "Ky është një copë natyre", mendoi me vete.

– Në studion e profesor Xheladin Apollonisë ju u treguat i mrekullueshëm. Dhe në përgjithësi keni një espri të jashtë-zakonshme, – tha Rita.

– Në studio unë s'pata asgjë të mrekullueshme. Ju e zmadhoni, u ndodha papritur në mesin e profesorëve të ndruar dhe e ndjeva veten vështirë. Fola plot marrëzira dhe kjo mbase më bëri të veçantë. Edhe një budalla mes të zgjuarve është i veçantë. Prandaj e veçanta nuk është gjithmonë e bukur. Ju siguroj, zonjëz, se unë nuk jam aq i mençëm. Unë tani jam rrëth pesëdhjetë vjeç. Kur isha njëzetvjeçar e ndjeja veten budalla. Për çudi edhe sot budalla e ndjej. Pres të shoh ndryshim, por është e kotë. Në moshatarët e mi këtë ndryshim shoh. Ata më duken shumë të mençëm. Duhet ta dini, «zonjëz», (ai e përdorte shpesh fjalën «zonjëz»), se personalitetin tim për një kohë të gjatë ma ka ndrydhur leshi që kam në hundë dhe që juve ju paska pëlqyer. Po, po! Mos qeshni! Prononi ju t'ju quajnë gjithmonë «hundëlesh». Do të luanit mendsh! Ah, «zonjëz» do të ishte një torturë e vërtetë, veçanërisht po të jetonit në provincë, ku njerëzit i kanë qejf nofkat, kur s'lenë njeri pa i vënë atribute të tilla. Nofkat në provincë janë mjete zbavitëse, janë shtyrje e kohës. E çfarë s'kam bërë unë për ta zhdukur këtë lesh që ma shikonin në kurrizin dhe në pllajën e hundës. Në fillim, kur isha djalosh, e rruaja dy herë në ditë. Por unë budallai nuk e dija se leshi sa më shumë rruhet, aq më i pasur bëhet. I shembëllen barit, që sa më shpesh ta kositësh, aq më i dendur del. Dhe erdhi e m'u rrit ky lesh, që më shikoni, si bari në livadh! Sa më tepër që më rritej leshi, aq më lart ngrihej zëri i qeflinjve të nofkave: "shihni, shihni Danen! Po i del më shumë lesh në hundë. E dini se natën ia pret e ëma me gëershërë?" Këto pëshpëritje nuk i bënин vetëm djemtë dhe burrat e provincës, por edhe vajzat e gratë. Ato vinin dorën në gojë dhe qeshnin sa më shikoni: "Gi-gi-gi! Dania e ka hundën me lesh si...", – dhe

thoshin fjalë ilegale që më mungon guximi t'i tregoj. Atëhere im atë, ndjesë pastë, më shpuri te mjeku, pasi kujtoi se do të gjendej ndonjë ilaç për ta ndaluar rritjen e leshit... Mjeku tha se ky lesh vetëm po të pritet hunda merr fund. Im atë më vë-shtroi me keqardhje dhe më qetësoi, duke thënë se leshin në hundë kanë nderin ta kenë njerëz të rrallë dhe se ai është shenjë e një gjallërie të madhe dhe e një pjellorie të begatë. Ah, im atë i zi! Shenjë pjellorie na qenkësh ky lesh, kur unë mbeta pa martuar! E ç'të martohesha? T'i thoshin gruas sime: «e shoqja e hundëleshit», ja dhe juve, «zonjëz» t'ju shohin njerëzit disa herë të shoqëruar me mua, do t'ju tregojnë me gisht: “ajo që shkon me Hundëleshin”...

Rita uli kokën dhe vuri pakëz buzën në gaz.

– E shihni si e ulët kokën? – tha Dane Gajtani.

– Ah, po! Një përfitim të paçmuar kam patur nga leshi në hundë. Më kanë dashur dhe më duan shumë të gjitha kafshët, të buta dhe të egra, pasi edhe ato kanë lesh në hundë. Në fund të fundit, më mirë të të duan kafshët se njerëzit. Njerëzit merren me luftën e klasave, me intrigat, me zilitë, me thashethemet, me privilegjet, me mëritë. E ç'vlerë ka se të do një akademik si Sotir Kucka? Ah, më fal, harrova se Sotir Kucka është yt vëlla! Më bukur është të të dojë një sqap, se një frazor, që përsërit në qindra kumtesa: “vlera, mbivlera, ligji themtar”! E keni parë cjin se ç'madhështor është? Ia shkon edhe akademikut më të ndershëm!... – tha Dane Gajtani dhe pa dashur ia hodhi dorën Ritës në lukthin e shpinës së saj të rrumbullakët e të lëmuar si delfini dhe filloj ta zbriste poshtë deri ku ndahan më dysh vithet.

Rita në fillim u tulit si shqerkë, pastaj u hodh përpjetë sikur dora e Dane Gajtanit të ishte me gjemba. Ai përnjëherësh e largoi dorën sikur t'i kishte djegur nga thëngjijtë. Vërtet atje në fundin e vitheve thëngjij kishte!...

– Kërkoj ndjesë! U vërtetua ajo që unë nuk jam i mençëm, pasi dhe dora më del jashtë kontrollit! - tha ai.

Këto lloj femrash, - mendoi Dane Gajtani, - nuk janë deri në fund moderne, siç tregohen në sipërfaqe. Modernia për to është deri në një kufi, deri atje ku mbaron artificialiteti dhe

shtirja artificiale e partnerit të tyre. Kur kalon ky kufi, ato zhveshin petkun e modernes dhe veshin rrobën e të zakonshmes së përshtatur. Për to modernë janë ata djem që shkojnë në hotel «Dajti» apo «Tirana», që rrijnë këmbë mbi këmbë dhe pijnë cigare me gazetarë të huaj, që flasin të matur për civilizimin...

– Mos u preke? – pyeti Rita pakëz e purpurtë në fytyrë.

Dane Gajtani e vuri xhaketën në krahun tjetër:

– Unë nuk prekem. E largoj mendjen, duke u hedhur nga arsyetimi në arsyetim. Në xhunglën e arsyetimit edhe mendja më e ndritur humb dhe nuk jeton me realitetin konkret. Në çastin që më pyetët nëse u preka, unë arsyetoja për thelbin e modernes në seksin femër.

Ajo e vështroi me këershëri.

– E si e mendoni ju?

Ai ia shpjegoi pa droje arsyetimin që kishte bërë më parë.

– Ju gaboni, – tha ajo, – mua ju më dukeni më modern se ata djemkat e «Dajtit» – dhe si heshti pakëz lëshoi një psherëtimë që as vetë nuk e kuptoi nga i erdhi. Kjo iu duk si dobësi ndaj këtij njeriu të gatuar nga një brumë i veçantë i thartuar në magje.

– Ju psherëtini, pasi nuk arrini dot të më njihni me gjithë dëshirën tuaj përvëluese, – tha ai paturpësish.

“Djall me lesh”, mendoi ajo pa i kthyer përgjigje. Dhe vërtet, ç’t’i khente përgjigje? Ajo do të kishte dëshirë të shkonte në krahinën ku ai jetonte, të hynte në shtëpinë e tij, të shihë se si e kishte ndërtuar jetën. Sipas mendimit të saj një njeri nuk kuptohet vetëm nga fjala, kuptohet edhe nga mjedisi i shtëpisë, nga orënditë e dhomës ku ha, ku punon e ku fle, nga miqtë që pret, nga tryeza, nga pjatat e nga lugët, nga fotografatë në muret... Eh, sa do të dëshironë të kishte fotografinë e saj në murin e dhomës së tij! “Mendim i marrë!” tha ajo me vete dhe i erdhi për të qeshur.

– Pse qeshni?

Rita u turbullua.

– Kot. Jam në një ekip mjekësh dhe do të vij në Korçë. Mund të hidhem edhe në fshatin tënd, - tha ajo dhe e vështroi

hapur Dane Gajtanin për të parë se ç'trysni do të bënин fjalët e saj në fytyrën e tij.

Ai vuri dorën në leshin e hundës.

– Ju sajoni! Paturpësish sajoni, si letrare e re. Ekipi i mjekëve është një sajim i juaji. Por edhe sikur të ketë një ekip të tillë, ju as kini patur në mend të bënët pjesë, – tha Dane Gajtani.

Ajo kishte frikë se mos skuqej dhe filloj të shtrëngojë me dorë mjekrën dhe gushën deri në dhimbje. Me këtë donte të largonte atë valë të purpurt që po i mbulonte fytyrën. Ishte e vërtetë se nuk bënte pjesë fare në atë ekip mjekësh, që rastësisht e kishte marrë vesh nga një e njohura e saj. Dhe djalli hundëlesh ia zbuloi këtë gënjeshtër të vockël, që nuk sjell asgjë të keqe.

Dane Gajtani hodhi xhaketën mbi sup dhe shikoi orën, si të ishte mërzitur nga qëndrimi i gjatë me Ritën.

– Artificializëm! – tha ai i zyntë.

Rita ndjehej e fyter. Nuk i kishte ndodhur ndonjëherë që të mos vinte poshtë një mashkull me hiret e trupit dhe mendjes së saj, me vështrimet hipnotizuese prej magjishtareje, me sjelljet dhe thyerjet e ligjeve të moralit ambientues.

Ky hundëlesh që dukej sikur ajo e pëlqente, qenka i papërkulur. Njerëz si ky, mendoi ajo, duhet të kenë inate të vjetra me tërë botën dhe nuk dinë se kujt t'i vërsulen për të marrë hak.

– Ju nuk dini me cilin të zemëroheni! – tha ajo pas heshtjes së tij.

– Hëm! – bëri ai. – Mua të gjithë ju më jeni neveritur. Të gjithë: akademikët, gratë, drejtuesit, rrugët, qytetet, kalimtarët... Ngado shoh lajkatarë dhe hipokritë që fshehin të vërtetën, që mizerjen e quajnë arritje, që ligjet absurde ekonomike e shoqërore i bazojnë teorikisht për të justifikuar varférinë dhe për t'i vënë këto ligje e këto parime në vitrinat e dyqaneve në vend të mishit, qumiështit, djathit dhe patateve... Xhungël lajkatarësh dhe gënjeshtarësh! Në këtë xhungël bëni pjesë edhe ju...

Dane Gajtani këto fjalë i tha me zë të lartë dhe tërhoqi vështrimin e tre-katër kalimtarëve.

– Për ju nuk janë moderne fjalët që dëgjuat! Moderne për ju është studioja e akademik Xheladin Apollonisë dhe bajamet e vajzës së tij të prera në Vjenë; moderne për ju është regëtimë e djemkave të lëpirë nga gjuha e mirëqenies në «Dajti», ku një kafe kushton pesëdhjetë lekë të vjetra, sa dita e punës së fshatarit, të mbetur me ahur shkretë, ku nuk dëgjohet asnjë blegërimë deleje dhe pëllitje lope. Lajkatarë, rrenacakë, që tunden nëpër konferanca dhe sesione shkencore me çanta të mbushura me fletushka kumtesash, që bien erë myk mendimi dhe erë mizerie filozofie – vijoi ai, duke shtrënguar dhëmbët.

– Mjaft! – thirri Rita dhe zuri veshët me duar.

Ai e la vajzën dhe filloi të çapitej i gjatë me kapele kashte në kokë dhe me xhaketë të hedhur supit, duke marrë me vete mërinë që kishte ndaj të gjithëve. As mendoi të khente kokën dhe të shihte Ritën, megjithëse e mori me mend tronditjen e saj. Por vrik e pushtoi një pikëllim e madje një trishtim hiri. Iu rrotullua në mendje studioja e akademikut Xheladin Apollonia, e mbushur me libra, dy lajkatarët me korrespondencë Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari, të ngjashëm në trup dhe në mend dhe tri gratë e kozmetizuara, arsyetimet për ligjin themeltar ekonomik, gjykimin me mburrje për operacionin e bajameve në Vjenë; iu kujtua dhe një djalosh njëzetetë vjeçar që vdiq në fshat nga mungesa e serumit që do t'i shtinin në gjak. Djalin e quanin Ilir, siç e quanin Iliriana edhe vajzën e akademikut. O Zot, psherëtiu ai, kështu do të jetojmë?!

Ekte me xhaketën hedhur pas shpine dhe dukej sikur nuk shikonte njeri, ecte nëpër një zbrazëti toriqeliane; që nuk kish te as shije, as erë, as pamje. Ja, po piqeshin nëpër ara piperkat. As vaj, as gjalpë nuk kishte nëpër shtëpitë për t'i fërguar! Fshatarët e hanë mëngjesin në fushë me një copë bukë, duke e përcjellë me ujë me sheqer, apo me sherbet uthulle. Dhe këta këndeje bëjnë konferanca kombëtare për ligjin themeltar ekonomik, – mendoi ai.

Në një qoshe të rrugës e priste makina, që kishte marrë spermë për ta shpënë në fshat. Ai do të nisej drejt monotonisë së hallevë dhe derteve.

Një ditë para se të hapej Konferenca Kombëtare Shkencore, studioja e akademikut Xheladin Apollonia përsëri ishte mbushur me miqtë e zakonshëm. Ishin po ata dy anëtarët e imët me korrespondencë të Akademisë, Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari; ishin po ato gratë e tyre ftyrëlëmuara, Adelina dhe Anifeja; ishte po ajo Ritë me kokën lart e me pamjen përbuzëse. Akademikët ishin të qetë dhe të lumtur, pasi i kishin shkruar kumtesat dhe madje u kishin dhënë edhe dorën e fundit. Burrat rrinin mbi kolktukë këmbë mbi këmbë, lëviznin duart dhe përpinqeshin të zgjidhnin në bisedë fjalë të mençme intelektuale, si «civilizim», «proces», «kontestim», «intolerancë», «strukturë», «infrastrukturë», «procedurë», «kontinuitet»... Këto fjalë kishin dalë mbi cipën e fjalorit të akademikëve veçanërisht kohët e fundit, kur Shqipëria kishte filluar të përpëlitez më shumë se kurrë ndonjëherë tjetër. Dhe, siç dihet, në përpëlitje e sipër në fillim dalin fjalët mbi cipën e fjalorit, ashtu si peshqit e vegjël mbi cipën e liqenit, kur ai fillon e përpëlitet lehtë-lehtë nga një puhibë fare e vakët. Fjalët mbi këtë cipë dalin gati pa peshë dhe të jatin përshtypjen sikur një fuqi e padukshme i shtyn nga poshtë për të kërcyer sipër. Me daljen e tyre ato diçka paralajmërojnë, diçka të padëgjuar dhe të jashtëzakonshme. Prandaj nuk thuhet kot e famshmjë shprehje “në fillim fjalë”.

Pasi mbaronin fjalët e mençme akademikët nisnin të ku-vendorin për vendet evropiane, që kishin vizituar, për ekonominë e tyre të përparuar dhe për demokracinë borgjeze dhe hidheshin në ligjet ekonomike që veprojnë në Shqipëri dhe në Evropë. E shihnin të udhës, për hir të së vërtetës, se ligjet ekonomike, veçanërisht ai themeltari, në Shqipëri janë në baza më

të shëndosha se në Europë, pasi rrjedhin nga objektiviteti marksist-leninist për të pasur qëndrueshmëri çmimesh dhe për të mënjanuar papunësinë, që bëhet gangrenë e pashërueshme në kapitalizmin e plakur.

– Planifikimi i prodhimit dhe harmonizimi i ecurisë së degëve të ekonomisë janë arritjet më të mëdha. Edhe natyra bën planifikim! Është një harmonizim degësh! Të marrim botën shtazore dhe të shohim organizimin e saj. Kjo botë planifikon: sa femra dhe sa meshkuj i duhen. Planifikimi shtrihet në llojet e specieve: sa lepuj, sa arinj, sa ujq, sa mace, madje edhe sa minj i mjaftojnë një territori të caktuar. Planifikimi i natyrës është tepër i centralizuar. Ka njerëz që e vënë në diskutim centralizmin. Hëm! Pa këtë centralizëm do të vërvonte anarkia në prodhim, do të vinte inflacioni, që është inondatë mbytëse për ekonominë! – tha profesor Xheladin Apollonia dhe ngriti lart gishtin me një pamje të hijshme prej dijetari, që ua merr mendjen veçanërisht grave dhe vajzave të kulturuara dhe të shëtitura.

– Ua! Ku i gjen këto fjalë, profesor! – u shkri Anifeja me gotën e likerit në dorën e majme.

– Dhe sa hije i kanë! – u mallëngjye Adelina përtace me gushë të bardhë si top dëbore.

Kurse Sotir Kucka filloi të dridhej aq sa mezi e mbante në dorë gotën e konjakut, që e kishte bërë gati për ta ngritur për shëndetin e akademikut Xheladin Apollonia.

Akademik Xheladin Apollonia e vuri re:

– Ç'pate, profesor Sotiri?

– Sesi më erdhi! – tha Sotir Kucka i imët me gjoks dhe fytyrë nga akademiku.

– Hëm! E di unë nga i erdhi kjo dridhje! – tha profesor Zyrap Kandari në mënyrë enigmatike me pamjen e tij të ngjashme me të dhelprës.

Ngashmëria e njerëzve me kafshët nuk është ndonjë gjë e jashtëzakonshme. Ka njerëz që u ngjajnë arinjve, ka që u shembellejnë kuajve, ka që afrojnë me hipopotamët, ka që anojnë nga ujqit apo luanët. Kjo është e zakonshme. Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari u shembëllënin dhelprave, megjithëse nuk shquheshin për zgjuarsi.

– Sotiri nesër do të mbajë kumtesën për planifikimin ekonomik, – tha Zyrap Kandari. – Ju profesor ia kujtuat kumtesën me mendimet që sapo shprehët dhe ai u tremb. I duket sikur nuk e ka shkruar mirë. Ndoshata, me fjalët që sapo para shtruat, i dhatë ide të reja dhe tepër origjinale.

Akademik Xheladin Apollonia e nxori përpara gjoksin, i ngrohur nga krenaria dhe i lumtur nga efekti i fjalëve të tij.

– Vërtet? – pyeti ai.

Profesor Sotir Kucka e vuri gotën në tryezë, duke u dridhur dhe e ktheu kokën nga Xheladin Apollonia:

– Fatmirësish vërtet! Ju shprehët një mendim origjinal për planifikimin që bën natyra. Ky mendim do t'ia rriste vlerën dhe nivelin cilësor kumtesës sime! Veçanërisht tronditës është krahasimi i planifikimit të ekonomisë me ekuilibrin e natyrës. He-he-he!... – dhe ferkoi duart.

Xheladin Apollonisë iu mbushën sytë me lëng, aq sa i fshiu me gisht. Mandej vuri duart në ije si Lenini dhe qeshi me të madhe. Nxori shaminë dhe përsëri fshiu sytë, duke iu kthyer Sotir Kuckës:

– Këtë mendim, profesor Sotiri, ta kam falur! Përdore si të të vijë për mbarë! Vetëm kumtesa të të dalë e pjekur, që të nderosh konferencën dhe të mahnitësh dëgjuesit.

Sotir Kucka u bë me krahë. Filluan t'i skuqeshin faqkat, madje edhe qafa rrëth jakës së bardhë të këmishës. Pastaj iu drodhën pakëz buzkat e holla dhe nuk dinte sesi ta falendonte profesor Xheladin Apolloninë, që i dha një ide me vlera aq të larta. Ai përfytyroi seancën e konferencës, kur do të merrte fjalën për të mbajtur kumtesën; përfytyroi anëtarët e Byrosë Politike në presidium, personalitetet më të mëdha të vendit, kamerat e televizionit dhe mikrofonët e radios dhe rroddhi lëngu i gjëzimit në gjithë qenien e tij. Pa le pastaj kur të dëgjonin mendimin: “Madje edhe e madhja natyrë bën planifikim të padukshëm!” Me siguri që pas këtij mendimi të figurshëm, auditori shkencor do të mahnitej dhe do t'i bënte dhuratën më të çmuar: duartrokitjen. Mandej në pushimin e seancës do ta thërriste udhëheqja në sallonin e veçantë për ta përgëzuar: “Mendimtarë të tillë na duhen”.

Por shpejt kjo lumbturi e përfytyruar u këmbye me një trish-tim real. Po sikur akademiku Xheladin Apollonia, që do ta hapë Konferencën Kombëtare Shkencore, ta përdorë këtë mendim në fjalën e tij të hyrjes? Dhe ai filloj të sjellë në mend disa raste, që vërtetojnë pabesinë e akademikut Xheladin Apollonia. Një herë në kryesinë e një forumi ia lavdëroi studimin Zyrap Kandarit, pastaj në një sesion shkencor ia shau haptazi dhe ashpër, duke ia hedhur poshtë.

– E? Thashë gjë? – pyeti Sotir Kucka i zgjuar nga përhumbja, pasi kujtoi se përfytyrimet i kishte thënë me zë të lartë.

Akademiku Xheladin Apollonia hapi krahët:

– Jo! Asgjë nuk folët!

Rita, e motra e Sotirit, i hodhi të vëllait një vështrim që e fshiu si fshesë me korrent. Nga buzët e saj shpëtoi një fjalë fyeze, të cilën mund ta kishin dëgjuar edhe të tjerët në studion e akademikut.

– Ç'thua? – pyeti i vëllai.

– Impotent! – përsëriti Rita me zë të ulët, duke ia afruar buzët prapa veshit të verdhë si fletë lakre.

Sotir Kucka u hodh përpjetë. Kjo e paturpshme, mendoi ai, përdor edhe fjalë... ilegale! Gjithmonë s'më ka dashur si vëlla. Edhe me Adelinën grindet si grifshë e keqe! Kësaj sno-beje s'kam ç't'i bëj...

Pastaj burrat u hodhën në një kuvend tjetër, që nuk kishte hapësirën e të parit, por nuk ishte edhe pa interes. Dikush nga ata e kishte parë Dane Gajtanin në kryeqytet.

– Dhe me cilin e kishin parë, do të thoni ju? – e nisi Sotir Kucka.

– Po? – pyeti Xheladin Apollonia.

– Me drejtoreshën e Shtëpisë së fëmijës! – shpjegoi Sotir Kucka.

– Mos ka ndonjë kopil atje ky Dane Gajtani? – tha Anifeja, duke vështruar me bisht të syrit Ritën.

Rita hodhi flokët pas me nervozizëm, duke lënë të kup-tohej se këto thashetheme nuk i pëlqenin aspak.

– Aman! Ç'na e kujtoni këtë Dane! – tha përtacija Adelinë dhe prishi buzët e skuqura.

Rita e vështroi me përcnim këtë hamëse dhe admiruese të artit të kuzhinës. Adelina e vuri re përcmimin e të kunatës.

– E di, që të tërheq ky tip! – psherëtiu ajo.

– Më tërheq! – tha Rita ftohtë.

– Veçanërisht hunda e tij e leshtë... – tundi kokën me përtim Adelina e majme.

– Më pëlqen më tepër hunda me lesh se sa koka jote pa tru, – ia ktheu Rita kunatës dhe një nerv iu drodh në faqen e djaththë pranë hundës së bukur.

Ata që e dëgjuan ulën kokat dhe nuk dinin sesi t'i shmangeshin këtij kuvendimi. Ndërsa Sotir Kucka u tremb. Ai kish te frikë se mos pëlciste ndonjë sherr mes dy kunatave, që shkoni si macja me miun. Në qarqet shkencore më shumë ia hidh-nin fajin Adelinës dhe e merrnin nëpër gojë për përtacinë e saj mendore dhe fizike, por kjo bëhej shpesh me qëllim për ta ulur figurën e Sotir Kuckës, që nuk kishte mundur të gjente një grua intelektuale më të mirë, që të harmonizonte me figurën e tij prej shkencëtarë të dëgjuar. Doemos, thashethemet ndikonin në karrierën e Sotir Kuckës. Edhe helmi i ngadaltë i tyre ndikonte që ai të mos bëhej anëtar i Akademisë, por të mbetej tërë jetën «me korrespondencë». «T'i lemë për një çast këta cmirëzinj, mendoi Sotir Kucka. Atyre s'ke ç't'u bësh! Po kjo Rita ç'kërkon të nxjerrë me përbuzjen e saj ndaj meje? Ajo edhe me simpatinë që shfaq ndaj një hundëleshi si Dane Gajtani, mundohet të më ulë dhe të më zhvlerësojë, duke i ngritur lart mendimet e tij rrebele dhe duke më quajtur mua të mykur dhe steril. Rrite qenin të të hajë shkopin! Unë e kam futur që të vogël në rrethe shkencore e letrare, në njerëz të zgjedhur e të qytetëruar, në klube dhe në shtëpi të kulturuara, ku mblidhet ajka e shoqërisë. Në sajën time i doli drojtja dhe turpi dhe fitoi pavarësi mendimi. Ndonjëherë më trembte kjo pavarësi. Kisha frikë se mos bënte ndonjë proçkë me profesor Xheladin Apolloninë, që e tërhoiqte aq shumë në kuvendimet për shkencën, për historinë, për artin dhe për civilizimet e reja dhe të vjetra. Për një kohë ajo mbyllej në studion e tij, kur Neta ndodhej në punë. Rinin gjatë pranë e pranë në kanapenë e re dhe qëllonin njëri-tjetrin me vështrime të dyshimta...”

Dhe Sotir Kucka nuk i harronte ato çaste, kur e kishte gjetur të motrën në studion e Xheladin Apollonisë të skuqur dhe me flokë të shprishura. I kishte ardhur rëndë dhe kishte bërë sikur nuk i kishte vënë re. Ishte turbulluar edhe profesor Xheladin Apollonia dhe mezi ia ngrinte sytë Sotir Kuckës. U kuptua që diçka kishte ndodhur në mes tyre. Ndoshta një dramë e vogël dashurie...

Nga hutimi Sotir Kucka kishte harruar se për çfarë kishte ardhur. Kishte qëndruar pak dhe i kishte bërë shenjë Ritës të ngrihej. Akademiku i kishte lutur të rrinin për drekë, por ata kishin trilluar një shkak dhe kishin dalë. Sotir Kucka, duke dalë në rrugë, megjithëse nuk kishte guxim të fliste hapur me të motrën, nuk ishte përbajtur:

- "Ka gjëra në jetë që... Gjëra që domethënë... Kërkojnë frenim të vetvetes... Ti e kupton vetë... Një çast e huton njëriun. Logjika përbajtet nga vërvshimi i ndjenjave. Pastaj vjen pendimi..."

- "E unë nuk pendohem!... Mua sot për sot më pëlqen profesori. Nesër nuk e di..." – i ishte përgjigjur Rita.

– "Kjo të bën të ulërish..." – kishte thënë Sotir Kucka dhe deri në shtëpi e kishte kyçur gojën.

Ishte e kotë të merreshe me Ritën. Do të merrte atë që mendonte ta pinin bashkë gotën deri në fund.

Ajo hynte e dilte në studion e Xheladin Apollonisë pa drojtje, e pa turp. Gratë e Sotir Kuckës dhe Zyrap Kandarit filluan të çirrnin faqet e të pëshpëritnin për Ritën e pacipë dhe për akademikun e lajthitur në moshën pesëdhjetëvjeçare. Rita këtë e ndjente. Në fytyrat e Anifesë dhe të Adelinës kishte filluar të vihej re një fshehtësi, që shprehej në lëvizjet e syve, në dridhjet e muskujve të faqeve dhe në kërcimet e cepave të buzëve. Ato nuk hapeshin para saj dhe shtireshin sikur nuk dinin asgjë, por zbuloheshin herë nga shenjat e fytyrës, herë nga kapërcimet që bënин në bisedë, kur vinte parpitur Rita, herë me psherëtimat pa shkak dhe të stisura. E gjithë kjo shtirje e tërbonte Ritën dhe mundohej ta thyente e ta prishte, kur të gjente rastin më të mirë. Këto bizele, që hiqeshin si ëngjëj ndershmërie, ajo i njihte nga flokët gjer në

thonjtë. Kur rrinin të veçuara nga njerëzit, nga buzkat e tyre të lyera dilnin fjalët më të ulëta e të të paturpshme për gjithë pjesët e trupit të mashkullit e të femrës, për gjithë lëvizjet dhe kënaqësitë trupore në shtrat, për gjithë format e organit të gruas dhe të burrit, duke treguar anekdota dhe histori, sa para tyre nuk janë asgjë rrëfimet e Bokaçios në «Dekameronin» e tij.

Një ditë Rita i zuri vetëtimthi në mes të një kuvendimi të lakuriqtë. Ato heshtën përnjëherësh dhe filluan të lëviznin sytë dhe të pshëretin. – “Eh, botë i thënçin! Eh!...”

Rita vuri duart në mesin e saj të hollë si të grerëzës së kërrikut. Edhe fustanin e kishte të verdhë në të limontë me vija të zeza me kafe si ngjyrat e grerëzës.

“Vazhdoni... Pse i gëlltitët fjalët? Edhe nga gëlltitja e fjalëve njeriu mund të mbytet!” tha ajo.

Anifeja me Adelinën u bënë trëndafil në fytyrë. “Eh! Ja, që kemi edhe ne të fshehtat tonë! Edhe fjala është si femra. Nuk mund të dalë para çdo njeriu lakuriq”.

“E, unë dua t’i zhvesh fjalët. Kam menduar ta ndaj akademik Xheladin Apolloninë nga Neta e tij. Do të martohem me të! Dhe ju do të lëpiheni pas fustanit tim, se do të jem gruaja e akademikut që ka në dorë burrat tuaj!” tha Rita.

Anifeja me Adelinën në fillim hapën gojët, pastaj qeshën me zor:

“Uh, mbamëni se vdiqa! Ha-ha! Sa qesha!... tha Anifeja duke përplasur pëllëmbët në gjunjët e majme.

Rita i hoqi duart nga mesi dhe u ul përballë tyre në një kolltuk të veshur me pelice në studion e të vëllait, ku rrallë hynte. Ishte një çast zgjimi. Gjithë trupi i saj dukej sikur shkëndijonte. Nëse dikush padashur do ta prekte, mund të digjej e tëra duke shkrepëtirë. Sytë ishin zbardhur si nga temperatura e lartë që jep tifoja, ose ethet e gushtit.

“Ju jeni të përdala! Bëni ajrogami! Çnderohi natë për natë nëpër èndrra. Po t’ju jepet rasti shkonit dhe ndjeni kënaqësi edhe me fshirësit e oxhakëve, vetëm mos t’ju shohë njeri”, thirri ajo, duke dalë jashtë logjikës me sy të kërcyer tej orbitës.

E kunata, Adelina përtace, vari duart në të dy anët e gjunjëve të zbuluar nga fustani i hollë. Dhe kur e ndjeu vështrimin e Ritës e tërhoqi fustanin për t'i mbuluar kofshët e bardha, si para një mashkulli të shthurur.

“Aman! Mos na kall datën!” tha ajo me përtaci.

Ndërkohë u hap dera e jashtme. Kthehej nga puna Sotir Kucka. Anifeja me Adelinën u çuan duke ngritur fundet e fustaneve të tyre të zhubyrosur nga qëndrimi i gjatë në kollukët e veshur me pelice. Fill pas tyre u ngrit edhe Rita me kokën lart si të drenushës. Sotir Kucka i takoi ato në sallon dhe u mërzit që ishin ngritur. Ai gjithmonë kishte dëshirë të rrinte pakëz në shoqërinë e femrave, të ndjente erën e tyre, veçanërisht të Anifësë, gruas së mikut të tij më të afërt, Zyrap Kandarit.

“Rrini, rrini!... tha ai, duke e hequr borselinën dhe duke rrrotulluar sytë e vegjël si rruaza të zeza.

“U çmallëm, zoti Sotir! Edhe mua më pret Zyrap. Bashkë dolët nga zyra?” tha Anifeja me përkëdheli dhe me naze prej lozonjareje.

“Bashkë, si gjithmonë!” tha Sotir Kucka me buzëqeshje të sinqertë.

Anifeja ia shtrëngoi dorën dhe doli. Rita shkoi në dhomën e saj. Fill pas saj Adelina filloj pëshpëritjet me të shoqin për të kunatën, pëshpëritje që për Sotir Kuckën nuk ishin të panjohura. Ai e njihet mirë të motrën, vetëm e kishte peng në zemër që ajo nuk po martohej. Ia kishte rënduar jetën në shtëpi. Hija e saj futej në çdo vrimë e skutë të apartamentit. Krijonte një trishtim e një ankth të çuditshëm edhe kur mungonte, mjafton që ta dije që do të kthehej nga çasti në çast. Sotir Kucka kishte bërë çmos që t'i gjente një apartament e ta largonte nga shtëpia. Por asaj nuk i pëlqenin apartamentet që i gjente i vëllai. Ato herë ishin larg qendrës së qytetit dhe herë të shëmtuara, me mure të shtrembëra dhe me tavane me gunga...

Këto kujtime ia larguan Sotir Kuckës mendjen nga studioja e akademikut Xheladin Apollonia dhe nga çastet kur mund të pëlciste grindja në mes të së shoqes dhe të motrës.

Dhe kur fillonte grindja e tyre, e gjithë shtëpia ishte në një tendosje të plotë. Të dyja mbanin kokën mënjanë, ecnin me duar në ije, afroheshin dhe e preknin njëra-tjetrën me bërryl të heshtura. Ky ishte prologu i një rituali, që në pamjen e parë i shembellente një loje, apo fillimit të një valleje populllore. Sotir Kucka i vështronte në heshtje me bisht të syrit dhe nuk guxonte t'i qortonte, pasi ndonjëherë ato hidheshin kundër tij, duke e quajtur të qulltë, të kërmilltë e të dështuar.

Pasi preknin me bërryl njëra-tjetrën, ulnin duart nga ijët dhe ktheheshin ballë për ballë. Në fillim nuk flisnin. Shikoeshin pa lëvizur sytë me një përcëmim të tmerrshëm ndaj shoqja-shoqes, pastaj vinin përsëri duart në ije, përshtyheshin dhe shaheshin me fjalët më të lakuriqta dhe më të paturpshme. Adelina i kujtonte Ritës zbavitjet me akademik Xheladin Apolloninë dhe mbylljen e të dyve në studio me orë të tëra. E quante bishtpërdredhur, që u bën lajka profesorëve për t'u dukur në mes të njerëzve dhe për t'u mburrur në elitën e kryeqytetit si një grua moderne. Mandej fillonte ta zhveshte dhe t'ia numëronte kockat një për një: xhadi qimezezë, sisëlëpirë, vithecëmbithur, qafëkafshuar, shalështrënguar... Ndërsa Rita e vështronte që nga lart me krenari të palëkundshme:

“O Zot, ma mbyll gojën, që të mos shpenzoj fjalët e mia të çmueshme me këtë injorante! O Zot, asnjëherë nuk kam qenë kurrnace! Kjo po më bën kurrnace ndaj gjérave më të shtrenjta, ndaj fjalëve! – dhe i kthehej të vëllait, – ruaje këtë thesar, Sotir Kucka. Ky është një thesar mish, një thesar tulesh që vlejnë për roston e shtratit tënd! Ti këtë e ke marrë për mish shtrati!”

Sotir Kucka doli nga përhumbja. I kapuliti sytë dhe vështroi studion e Xheladin Apollonisë. Ishte po ajo gjendje e tendosur. Ndërkohë zonja e shtëpisë, Neta, u kujtua ta nxirrte shoqerinë nga gjendja e vështirë, duke përsëritur me zë të lartë disa thënie të Dane Gajtanit:

– Si i tha Anifesë ditëshkurtëri, moj? I tha: “zonjë, nuk të lejoj të kullosësh në leshin e hundës sime”.

– Po profesor Xheladin Apollonisë si ia bëri, duke ia vënë gishtin nga pas?... – tha Rita me dorën para gojës për të përbajtur të qeshurën.

Profesor Xheladin Apollonia bëri sikur nuk dëgjoi, kurse Sotir Kucka kafshoi buzën duke e kërcënuar Ritën:

– Rita!

– Profesor! – iu drejtua Zyrap Kandari akademikut Xheladin Apollonia.

– Po!

Ky Dane Gajtani me tërë mend do të vijë në konferencë?

– Ftesën e ka! – tha akademiku i menduar. – Ai dikur ka qenë kryetar kooperative. E hoqën për marrëzitë e tij. Rebel!

– Mendon edhe të diskutojë, apo bën shaka! – pyeti përsëri Zyrap Kandari.

Sotir Kucka përpoqi buzkat:

– Nga ai çdo gjë mund të pritet!

– Mundet, mundet! – psherëtiu Xheladin Apollonia.

Rita shtrëngoi ballin me dorë. Asaj filluan t'i ziejnë mendtë nga jehona e fjalëve të Dane Gajtanit që i dëgjoi atë mbrëmje në rrugë. Për një çast ajo u rrënqeth. Po foli me atë gjuhë në konferencë, do të jetë skandal! Këta matufë asgjë s'dinë, mendoi ajo, duke u hedhur një vështrim shkencëtarëve që flisnin me hamendje për Dane Gajtanin.

Gratë filluan të çuçurisnin me zë të ulët, duke afruar kokat e tyre të bukura pranë njëra-tjetrës. Flisnin dhe qeshnin lehtë e të përbajtura me duar para buzëve, që vinin erë të mirë nga parfumet e dyqaneve evropiane. Me siguri merrnin në gojë Dane Gajtanin dhe në të njëjtën kohë thumbonin Ritën, simpatizanten e tij. Kurse burrat nisën të hapin gojën nga plogështia dhe të shikonin orët. Kjo do të thoshte se akrepët e orëve vërtiteshin ngadalë dhe plot përtim. Miniera e fjalëve të burrave tanimë ishte mbaruar së shfrytëzuari. Dihet që sa më e pasur të jetë miniera e fjalëve dhe sa më e ethshme të jetë dëshira për ta shfrytëzar, aq më shpejtë i vërtit akrepët zembreku i orës.

Në kohën kur shkencëtarët shikonin orët dhe bëheshin gati për t'u ngritur, tingëllói zilja e derës. Shkencëtarët panë shoku-shokun, gratë pëshpëritën me njëra-tjetrën dhe larguan

kokat e bashkuara. Zilja e derës prishi unitetin e kokave të tyre, siç do të shprehej Dane Gajtani.

– Ai do të jetë! – tha me pikëllim akademiku Xheladin Apollonia.

– Shih, obobo! – i ra ballit me pëllëmbë Zyrap Kandari dhe ia hodhi sytë ngjashmërisë së tij, Sotir Kuckës, për t'i lënë të kuptonte se duhej të ngriheshin.

– Dihej që ai do të vinte në konferencë! – psherëtiu Sotir Kucka.

Rita u mënjanua nga gratë, duke ndërruar kolltukun. Zilja e derës asaj i tingëllói deri në fund të lukthit të gjoksit. Ishte zilka e ankthit dhe njëkohësisht e kërshërisë pér ta parë këtë njeri pér të dytën herë.

Zilja tingëllói edhe një herë, më gjatë se në fillim. Xheladin Apollonia e vështroi Netën, gruan e tij të shumëdashur dhe të shumënderuar dhe i bëri shenjë:

– Po hape, të shkretën!

– Shko hapja vetë. Të duroj unë dorën e tij nga pas! – tha Neta duke treguar vithet e saj.

Adelina me Anifenë ulën kokat dhe filluan të qeshin fshehurazi me zë të ulët. Kurse Rita rrinte e drejtë në kolltuk si një bust me piedestal të ngritur dy pëllëmbë mbi tokë.

– Oh, Dane Gajtani! Ty sa të kishim në gojë! – tha Xheladin Apollonia, me zë të zgjatur dhe e përqafoi, duke e myllur derën me këmbë.

– Kujto qenin, dhe bëj gati shkopin! – ia ktheu Dane Gajtani.

– Ah, jo! Kujto mikun, dhe shtro sofrën! – qeshi Xheladin Apollonia.

Dane Gajtani kishte veshur po atë kostum të bardhë dhe kishte vënë po atë kapele të bardhë kashte. Veçse, pér çudi, ai këtë radhë grave iu duk më i gjatë dhe me lesh më të rritur në hundë. Nga kjo habi ato vështruan njëra-tjetërën, pastaj ua hodhën sytë këpucëve të tij, pasi kujtuan se mos i kishte rritur takat. Po jo, ishin po ato këpucë!

Ai kaloi nëpër studio, i zuri pér dore me radhë burrat dhe gratë dhe hoqi kapelen në shenjë nderimi:

– Paski pak dritë në studio! Kastile e keni ulur dritën për të krijuar ambient romantik familjar? Por kur drita është e pakët, sendet duken me përmasa më të mëdha dhe njerëzit më të gjatë, – tha Dane Gajtani dhe u ul pranë Ritës me kapelen e kashtës mbi gjunjë.

Gratë çakërritën sytë. E po ky është djall! Vërtet, kur erdhë radhën e parë në studio, edhe pse ishte mesditë, ishin hapur gjithë dritat, pasi lexoheshin kumtesat. Prandaj Dane Gajtani u duk më i shkurtër.

– Erdhët të merrni pjesë në konferencë? – pyeti Adelina me një zë të butë.

– Po! – tha Dane Gajtani shkurt.

– Jeni konsultuar me literaturë ekonomike? – u bë kurioz Sotir Kucka.

Dane Gajtani ktheu kokën nga Zyrap Kandari, pasi kujtoi se e pyeti ai. Atyre vërtetë u shëmbellente jo vetëm fytyra, por edhe zëri.

– Unë pyeta, – i tërhoqi vëmendjen Sotir Kucka.

– A, më falni! Po ju shëmbëlleni kaq shumë! Përse pyetë?

– Jeni konsultuar me literaturë ekonomike? – përsëriti Sotir Kucka.

– Pse, ka ndonjë literaturë të tillë në vendin tonë? Unë nuk di të ketë! Jam konsultuar vetëm me literaturën që kanë shkruar dhentë dhe lopët e fshatit tim!... – tha Dane Gajtani i zyrtë.

Në studio ra një heshtje e tendosur nga nihilizmi i Dane Gajtanit. S'pipëtinin as burrat, as gratë. Ai me paturpësinë e tij i kishte fyer të gjithë. Po veprat e akademikut Xheladin Apollonia nuk janë literaturë ekonomike? Po studimet dhe artikujt e anëtarëve me korrespondencë të Akademisë, Sotir Kuckës dhe Zyrap Kandarit, që përbëjnë vëllime të tëra, nuk qenkan literaturë ekonomike? Po veprat e udhëheqësve?...

Atëherë këta burrat tanë s'paskan bërë gjë, – menduan gratë e nderuara. Ky Dane Gajtani jo vetëm që na qenka i paturpshëm dhe cinik, por edhe nihilist mendjemadh. Me këto fjalë ai e di ku shkon? Hëm, shkon atje ku fjalosesh me muret... Në burg shkon... U bë ky të shajë çdo gjë...

Në këtë çast mori guxim të ndërhynte Adelina, me gjithë përtacinë e saj mendore dhe trupore.

– Si s'paskemi literaturë ekonomike! Po veprat e profesor Xheladin Apollonisë?

– Zero! – ia preu ai shkurt.

– U-u-u!... – u lidhën bashkë zërat e burrave dhe grave.

Dane Gajtani i ra me bërryl Rités që rrinte pranë tij.

– Po ju pse s'bëni «u-u-u»?

Rita nuk u përgjigj megjithëse i erdhi mirë që ai ktheu vë mendjen ndaj saj.

– Nuk është ashtu, xhanëm! Shkenca jonë ekonomike ka një fond të pasur, – tha Xheladin Apollonia.

– Nejse, kjo është një temë e ndërlidhur! – tha Sotir Kucka që nuk donte ta thellonte konfliktin.

Në të vërtetë Sotir Kuckës iu bë qefi që Dane Gajtani i quante zero veprat e akademikut Xheladin Apollonia. Me këto vepra të quajtura zero ai mburrej në konferanca e në mbledhje zyrtare, në gazeta e në ekrane televizori. Nuk kishte presidiume që të mos ishte karrigia e tij dhe, ja, tanë vjen një ditë një Dane dhe e heq nga presidiumi. Po në të ardhmen sa Dane do të vijnë? Kur dymijë, tremijë, katërmijë Dane të bërtasin «zero», ç'do të bëjë akademiku Xheladin Apollonia? – mendoi ai dhe fërkoi duart duke qeshur:

– Ç'pate, Sotir? – pyeti akademiku Xheladin Apollonia.

– Konkretizova një mendim! – tha profesor Sotir Kucka duke fërkuar duart.

Zyrap Kandari rrudhi vetullat se veprimet e mikut të tij iu duken sjellje prej të sëmuri psiqik.

Kuvendimi tanë nuk ecte. Në rrugën e tij ishin hapur gropë. Studioja e Xheladin Apollonisë lëngonte. Trupat nëpër kolltukë herë merrnin frymë thellë, herë psherëtinin, herë kolliteshin dhe herë këmbenin ndonjë fjalë të vakët, të thënë me përtim me rrokje të ngrëna nëpër dhëmbë. Dane Gajtani shtrëngonte kapelen në gjunjë dhe herë pas here shfrynte përbrenda pranë Rita Kuckës, që heshtte me trup të drejtë në kolltuk. Ajo i dinte mendimet e tij për këtë botë të përgjumur dhe për këta njerëz të fjetur, me të cilët lidhej prej kohësh si

motër shkencëtari dhe si vajzë që e joshnin qarqet e kulturuar. Përbuzja e kësaj bote nga Dane Gajtani, sipas Ritës, shpjegohet edhe me zilinë e tij, që nuk ka mundur të hyjë në portat e saj. I mbetur në provincë, ai merr hak ndaj botës së gjerë të kulturës, duke e bërë atë fajtore. Sipas Ritës edhe kjo mund të jetë arsyaja e mërzisë së Dane Gajtanit.

Dane Gajtani thithi me zhurmë ajrin dhe e lëshoi ngadalë. Pastaj i kryqëzoi duart në njërin gju dhe e ngriti pakëz, duke thënë me vështrim nga dritarja pa iu drejtuar njeriu:

– Oh, ç’njerez! Kanë qejf të presin miq, të bëjnë bujë kotësie, të shtrojnë tryeza! Nuk ka rëndësi për ta se ç’përmban tryeza. Mjafton që të jenë pjatat nga Evropa dhe të kenë anash lugë, pirunj dhe thika me shkëlqim verbues; të kenë piceta të palosura në formë trekëndëshi, të bardha, me qëndisma të holla; të kenë kutiçka me kleçka për të kruajtur dhëmbët; të kenë gota të kristalta dhe para tyre kokrra kikiriku ose lajthie. Pjatat e tjera të mëdha mund të jenë edhe pa gjë, të zbrazura, s’prish punë. Të vocklat të kenë kikirik, lajthi dhe arra! Dhe dikush të merret me delikatesë me gostitjen dhe qerasjen. Është vëmendje e veçantë ndaj formës së vanitetit, që në shqip do të thotë kotësisë. Oh, ç’njerez! Këta merren edhe me mbarëvajtjen e lëkurës! Me lëkurën merren si me gojën. Goja kërkon mish, bulmet, zarzavate, pijë... Lëkura ka nevojë për kremra, kolonjë, të kuq buzësh, sapune e parfum, kërkon edhe pastë e brisqe rrojesh. Por ç’ë pyet, një industri e plotë punon sot për lëkurën! Në vendin tonë ka snobë që i josh kjo industri. Kur shkojnë jashtë shtetit blejnë të shkretët ndonjë krem, ndonjë kolonjë, ndonjë të kuq buzësh... Por këta snobë i përkasin elitës...

Zyrap Kandari i bëri me dorë Xheladin Apollonisë:

– Ç’thotë ky, more! Për ç’art flet?

– Lëre, le të flasë, Zyrap, lëre! Flet ai, flet!... – tha Xheladin Apollonia gjysëm i përgjumur.

– S’flet keq, për kokë të djalit! – tha Anifeja, duke hapur buzkat nga përgjumja.

– Por nuk e dimë se për cilët flet! – tha Zyrap Kandari.

– Ja, ka njerëz në botë, thotë, – shpjegoi Sotir Kucka.

Hundëleshi i shikonte dhe nuk fliste. I vinte edhe trishtim edhe gaz nga këto koka me vrima përpara: me sy, me veshë, me gojë...

Nga jashtë dëgjohej ndonjë zhurmë vture a kamioni. Era e lehtë frynte perdet e holla nga dritarja gjysëm e hapur. Qyteti ende nuk kishte fjetur. Njerëzit ecnin nëpër rrugë. Dikush bërtiste, dikush këndonte e dikush thyente shishe nëpër mure. Tek-tuk dëgjoheshin vërvëllimat e bilbilave të policëve.

Akademikut Xheladin Apollonia i hapej goja...

Dane Gajtani ndjeu një zbrazësi të thellë. Në studion e akademikut Xheladin Apollonia të mbështjellë me gjysëm errësirën e rëndë ai ishte i vetmuar pa lidhje me botën, pa telefon, pa televizor, pa radio. Nëpër rrugë lëviznin vetëm hije pa formë konkrete. Më tutje hijet e Sotir Kuckës e Zyrap Kandarit, përkrah hija e Rita Kuckës, mandej hijet e Netës, Anifësë e Adelinës. Përballë hija e madhe e Xheladin Apolloni. Hijet flisnin me gjuhën e hijeve. Fjalë pa shkronja, bashkëtingëllore dhe zanore pa tinguj. Hije! mendoi ai. Nga hijet a mund të ketë shkencë ku të konsultohesh?

- Hije! – tha Dane Gajtani me zë të lartë mes heshtjes.
- S’ të kuptova, – tha zymtë Xheladin Apollonia.
- Nga hijet del shkenca-hije! Dhe unë s’ kam se ku të konsultohem! – shpjegoi Dane Gajtani dhe këndoi një këngë:

*M'u shfaqën në ëndërr nja tri hije,  
Më morën hijet në një guvë,  
Më flisnin gjuhë çmendurie,  
Përmes kumtesave pa bukë.*

*Më pëshpërisnin qindra herë,  
Dhe qindra herë blegérinin  
Për mallin, vlerën dbe mbivlerën,  
Për Marksin, Engelsin, Leninin.*

*U bëra hije edhe unë,  
Ashtu si tri bijet e tjera,  
Dhe koka ime, dreq o punë,  
U mbush me vlera dhe mbivlera.*

*Kur m'u rëndua kokë e shkretë  
Më tha një hije ndaj agimit:  
"O mik, ti vlerën mbaje vetë,  
Mbivlerën jepja Xheladinit" ...*

Rita lëvizi nga kolliku dhe tërë nerva ngriti krahun dhe lëmoi me dorë flokët e zez, madje shtrëngoi edhe dhëmbët e vegjël. Dane Gajtani e mori me mend se vjershërimi i tij nuk i pëlqeu kësaj njohëse të arteve dhe në përgjithësi të vlerave shpirterore. Këto bejte sociale për këtë vajzë ishin të papranueshme. Atë e tërhiqnin vargjet e metaforave paradoksale ekspressive. Ajo edhe për humorin vetëm ndonjëherë kishte respekt. Ashtu si gjithë femrave humori nuk i pëlqente, pasi e quante shkallën më të ulët të artit. Shpirti i saj prirej drejt dramës. Ah, drama! Unë e dua dramën tragjike, me një fjalë, tragjedinë! Komedia është për shijet e Adelinës, – thoshte ajo kur vinte rasti dhe nuk harronte të zinte në gojë edhe të kunatën, përtacen Adelinë.

Ajo ktheu kokën nga Dane Gajtani:

– Ju flisni përqart, mos kini temperaturë? Ju edhe këndoni përqart!

– Do të isha me fat të flisja përqart, por s'flas dot, ndërsa këngët gjithmonë përqart këndohen, – tha Dane Gajtani, pastaj shtoi: – Të trembi Marks ty?

– Hesht! – urdhëroi Rita.

Ndërkohë Neta lëvizi nga vendi. Ajo kishte harruar ta qeraste Dane Gajtanin, pasi ishte hutuar nga fjalët e tij heretike. Megjithatë nuk guxonë të ngrihej e të sillte gotën e konjakut, pasi kishte frikë se duke ia shpënë me vonesë, ai do të thoshte ndonjë fjalë fyese në mjedisin e kësaj shoqërie kaq të nderuar. Por më në fund ajo vendosi të ngrihej.

Kur e solli tabakanë me piye, iu kthye familjarisht Dane Gajtanit:

– M’i morët mendtë me thumbat tuaja dhe harrova t’ju qeras.

– Ju prisni që unë të ngrihem e të iki. Po ju harroni se miku ikën vetëm pas qerasjes! – tha ai dhe e ngriti gotën e konjakut pa uruar njeri.

– E po ky të bën të skuqesh me zor, – tha Neta.

– Çfarë teme trajtoni në kumtesë, – pyeti papritur Zyrap Kandari me zë të hollë si një tenor që shtrëngohet duke kënduar.

Të gjithë nuk do të donin të bëhej kjo pyetje. Në kohën kur pritnin të shpërndaheshin, ky Zyrap i marrë ngrihej dhe nxiste një diskutim apo më saktë një zallamahi të gjatë!

– Nuk e kam kumtesë, por diskutim! – ia preu Dane Gajtani duke kthyer gotën e konjakut për të dytën herë.

– Edhe diskutimi ka një temë, – qeshi Zyrap Kandari.

– Sigurisht... – tha Dane Gajtani me përtim.

Ky mish i tharë, mendoi ai, po më pyet nga lart, sikur unë jam një nxënës apo një veprimtar si ata të vatrave të kulturës dhe të muzeumeve të fshatrave.

Dy shkencëtarët e tjerë, Xheladin Apollonia dhe Sotir Kucka u lehtësuan. Me sa dukej po i vinte fundi mbrëmjes, pasi Dane Gajtani po iu binte shkurt pyetjeve, duke mos dashur t’u përgjigjej.

– E di që diskutimin tim nuk do ta pranojë njeri në konferencë, por do të flas... – tha Dane Gajtani.

Njerëzit filluan të zgjoheshin nga plogështia. U bënë kuriözë se ç’kishte ndërmend të liste ky gjataman, por asnjieri nuk guxonë t’ia kërkonte diskutimin. Mund t’ia kërkonte vetëm akademiku Xheladin Apollonia, pasi ai ishte i ngarkuar që çdo kumtesë e çdo diskutim ta kontrollonte. Madje në qarqet shkencore atë e quanin «çenzori i madh». Dhe ishte çudi përsë nuk ia merrte diskutimin Dane Gajtanit. Mos vallë kishë te besim në zotësinë e tij? A nuk e vuri re akademiku se ç’mendim kishte ky nihilist për shkencën tonë ekonomike? Po ta shprehë këtë mendim edhe në konferencë ku do të futet Xheladin Apollonia?

– Hi-hi? Ju do të diskutoni? Mos bëni shaka? – tha Sotir Kucka, duke ia afruar fytyrën e hollë me pore si të mishit të pulës.

Dane Gajtani s'u përbajt dhe e zuri për veshi, pastaj ia përdrohhi pakëz.

– Pse, si të dukem unë, moj dhëlpër e ligur?

Sotir Kucka e vuri dorën në vesh i shtangur. Xheladin Apollonia ngrysi vetullat, i zymtë si fundi i gjymtit. Zyrap Kandari uli kokën. Gratë u skuqën. Vetëm Rita rrinte drejt me sy përparrë.

– Ngrihu, Sotir, të ikim! – urdhëroi Adelina.

– Ishte një shaka pa të keq! Prit, Adelina! – tha Sotir Kucka.

– Impotent! – përsëriti Rita me vështrim përparrë.

Sotir Kucka e dëgjoi fjalën «impotent» për të tretën herë apo të katërtën herë në këtë mbrëmje dhe e ndjeu veten të pazotin për t'i kthyer përgjigje së motrës dhe për ta sharë, megjithëse përbrenda zjeu i téri dhe mallkoi me një zemërim dhe një urrejtje deri në përvëlim të lëkurës të trupit të tij të imët. Me fjalën «impotent» Rita shante edhe profesor Xheladin Apolloninë pas ftohjes me të. Hyrjet dhe daljet e saj të shpeshta në studion e profesorit ranë edhe në sy të Netës. Në fillin ajo nuk donte ta besonte që i shoqi i saj, njeri me autoritet në qarqet intelektuale dhe i njojur jo vetëm në përmasa kryeqyteti, por edhe vendi, të binte me dashuri në vjeshtën e moshës së tij me një vajzë të re sa e bija. Prandaj fjalët e përhapura dhe thumbimet e tërthorta të Anifesë dhe të Adelinës ajo i merrte si thashetheme të thjeshta, ose si shaka pa të keq. Por një ditë tek e pa të vinte në apartament, duke kujtuar se do ta gjente të vetëm Xheladin Apolloninë, u bind se mes tyre patjetër duhet të kishte ndonjë histori. Rita, kryelartë dhe natyrshëm, sikur të mos kishte të bënte me asgjë të turpshme ia dha dorën Netës dhe pa pyetur hyri drejt e në studion e akademikut. Netën kjo sjellje e hutoi dhe e çarmatosi krejt. Madje e bëri që të mos u besonte thashethemeve. Sikur Rita të kishte ndonjë lidhje shpirtërore me Xheladin Apolloninë do ta shprehte në fytyrë, në lëvizje, në sjellje. Ndërsa kjo si të ishte mashkull hapi derën e drejt e në studio. Rita atë ditë kishte vendosur të këpuste çdo fije që e lidhte me akademikun. Nga ai ishte e lodhur dhe e mërzitur. E kishte kuptuar që ai donte ta

mbante si konkubinë dhe në të njëjtën kohë të jetonte në harmoni të plotë me të shoqen. "Unë", i kishte thënë, "sikur të isha një intelektual i thjeshtë, do ta kisha ndarë Netën dhe do të isha martuar me ty. Ç't'i bësh! Fat i keq. Jam njeri i njojur në të gjitha shkallët e shoqërisë. Më njeh e gjithë udhëheqja e shtetit, më njojin të vegjël dhe të mëdhenj, si të isha një aktor. Dhe të njojur më kanë bërë ekranit i televizorit, faqet e gazetave, presiduumet e mbledhjeve. Merre me mend se ç'bëhet në shoqërinë tonë sikur unë të ndahem me gruan! Skandal! Në shekullin e XIX kur njojja e personalitetit bëhej me vështirësi, pasi mjetet e informimit publik ishin të pakta, nuk ishte vështirë të ndaje gruan. Atëhere ishte lehtë të dashuroje. Le të sjellim ndërmend dashurinë e Napoleon Bonapartit, Balzakut, Gi dë Mopasanit e me radhë. Asnjeri nuk pëshpëriste. Kurse tani, sikur të jetonte shërbyesi i Napolon Bonapartit dhe sikur të bënte dashuri, do ta merrte vesh dhe do ta pëshpëriste gjithë Franca, pasi do të zhurmonte televizori dhe do të bërti-snin miliona faqe gazetash... Ndërsa në vendin tonë dashurinë kuadrot e paguajnë shumë shtrenjtë..."

Pas këtij monologu Rita as e kishte ulur kokën. Çuditej me besimin e tij kaq të madh në vetvete. Asaj as që i kishte shkuar në mend që t'i kërkonte këtij burraveci të linte gruan dhe pastaj të martoheshin bashkë. Edhe dy pulave budallaqe Anifesë dhe Adelinës u kishte thënë sa për snobizëm që do ta ndante Xheladin Apolloninë nga Neta. Pastaj e kishte vështruar me neveri akademikun, ishte ngritur dhe kishte dalë nga studioja e tij, duke thënë nëpër dhëmbë:

– Impotent!

Duke dalë, ishte përplasur padashur me Netën dhe ia kishte rrëzuar tabakanë dhe konjakun që po e sillte në studio për ta qerasur.

– Uh! – kishte bërë Neta.

Rita ia kishte hedhur sytë me përcnim dhe i kishte pëshpëritur me zë të ulët:

– Mos ki dyshim, pulë pularie, yt shoq është i paprekur, nuk ta merr njeri!... dhe kishte dalë nga apartamenti.

– E marrë! – kishte thënë Neta e çliruar fill pas daljes së Ritës.

Edhe pas kësaj ngjarjeje lidhjet e Apollonëve dhe Kuckave nuk u shkëputën. Të dy familjet hynin dhe dilnin si më parë, me to si gjithmonë bashkohej edhe Zyrap Kandari me të shqen. Kjo bënte që të shuheshin thashethemet e vjetra dhe të lindnin të reja të paparashikuara.

Sotir Kucka, për disa çaste i përhumbur, u kujtua të fërkojë llapën e veshit që ia kishte shtënguar Dane Gajtani. Ai vërtet ndjeu dhimbje dhe filloi ta urrejë Dane Gajtanin e paedukuar, me gjithëse në sy të të tjerëve gjestin e papëlqyer të këtij hundëleshi e quante si një shaka.

– Impotent! – pëshpëriti Rita për të vëllanë me vështrim përparrë.

Dane Gajtani e dëgjoi dhe bëri me dorë me mospërfillje. Këto atij i dukeshin skena kotësie pa vlerë, skena ëndrrash të njerëzve të zvarritur mes plogështisë. Pastaj ai u hodh në temën e diskutimit të tij.

– Që të bindem edhe unë në se vlen ky diskutim po ia jap Xheladinit t'i hedhë një sy! – tha ai me përtesë.

Mandej futi dorën në xhep, nxori një tufë lettrash të shkruara, u ngrit dhe ia dha Xheladin Apollonisë. Akademiku u vrenjt jo më shumë nga përtesa për ta lexuar, se sa nga vësh-tirësia e vlerësimit të këtyre letrave të prera përgjysmë. Të tjerët u bënë kuriozë dhe filluan të ndiqnin nuancat e shprehjes së fytyrës së akademikut tek lexonte.

Akademiku lexoi frazën e parë dhe i bëri shenjë të shoqes të çelte driten e madhe. E gjithë studioja vetëtiu. Nën driten e plotë u zbuluan tërë sendet e imta dhe skutat deri tanë të errëta. Nëpër raftet e bibliotekës, në vendet e zënë nga librat, filluan të duken kukullat e vogla, guralecët e rrumbullakët, vazot e miniaturta, guackat e detit e samarët e kërmijve, që profesorit ia kishin dhuruar nëpër konferanca kombëtare e ndërkombëtare.

Dane Gajtani i vështronë këto suvenire dhe sillte ndërmend shtëpinë e vet në fshat me atë tryezën në mes të dhomës, me ata kolltukët standarte anës mureve, me ato fotografitë të prera nga revista «Ylli» të varura në mure nga e ëma, me atë radion e vjetër kineze me etiketë shqiptare dhe evro-

piane «Mimoza» dhe i vinte për të psherëtirë. Por kishte edhe smirë. Të dy me akademikun ishin nga një fshat dhe të dy të pabarabartë...

Profesor Xheladin Apollonia, duke lexuar diskutimin e Dane Gajtanit, dalëngadalë filloi të vrenjtej pastaj të lëvizë supin, mandej të djersijë. Në çastin kur djersiu, i la fletët dhe nxori nga xhepi shaminë të fshijë ballin. Dy shkencëtarët e tjerë e prenë frymëmarrjen, ndërsa gratë nisën të çjerrin faqet fshehurazi. Rita shikonte drejt e heshtur. Në vështrimin e saj ndjehej një indiferentizëm i ftohtë, i stisur dhe i panatyrshëm.

Akademiku Xheladin Apollonia, kur arriti aty nga mesi i diskutimit, i la fletët në tryezë dhe përplasi mbi to pëllëmbën.

– Me të vërtetë me këtë diskutim do të shkosh në konferencë? – pyeti ai dhe i ndali gjatë sytë në fytyrën e rreptë të Dane Gajtanit.

– Sigurisht... – tha Dane Gajtani pa u lëkundur.

Xheladin Apollonia mori letrat nga tryeza, i tundi në dorë para të gjithëve dhe ngriti zérin:

– Ky është një skandal i vërtetë! Kjo është zhytje me kokë e me këmbë në pellgun e ekonomisë kapitaliste! Jo! Jo! Unë nuk mund ta lexoj më tutje këtë, këtë paskuil, këtë shtrembërim, këtë, këtë, këtë shkelmim të ligjeve tona ekonomike, të parimeve marksiste-leniniste, – thirri ai me të madhe dhe paritit vuri dorën në gjoks, u këput e ra në karrike, duke shpërndarë me njëren dorë letrat në tryezë.

U ngritenë të gjithë të shqetësuar. Neta vrapi duke lebetitur:

– Ç’pate Xheladin! Ç’t'u desh të lexoje fletushkat e një të çmenduri! – dhe u mat t’i merrte fletët e shpërndara në tryezë e t’i griste, por në çast u ngrit Dane Gajtani.

– Larg duart nga fletët e shkruara! – thirri ai dhe i mblođhi të gjitha nën vështrimin përcmues dhe të egër të shkencëtarëve dhe grave të tyre të shëndetshme dhe të lumtura.

Akademiku Xheladin Apollonia e çoi ngadalë kokën e rëndë dhe të thinjur, i vështroi me dhimbje një nga një fytyrat tretë tij, si një njeri që vinte nga një botë tjetër, buzëqeshi pak dhe bëlbëzoi:

– Ah, më kaloi... Ishte një tension nervor.

E shoqja duke i bërë fresk me një freskore kineze si bisht palloji, i lutej:

– Lali, aman të keqen, të thérresim doktorin...

– S’është nevoja, e dashur! Pa panik!... – bënte me dorë akademiku Xheladin Apollonia me një buzëqeshje të sëmurë, por me ndjenjën e plotë autoritare.

Miqtë e tij të përvuajtur dhe të dhimbshëm, tërë vanitet miqësie intelektuale, u ulën, duke lënë pas psherëtimat e gjata të një sentimentalizmi teatral. As ata, as akademiku i famshëm nuk ia hidhnin sytë Dane Gajtanit që rrinte në kolltuk indiferent me kapelen në gjunjë dhe me fytyrë përballë Xheladin Apollonisë.

Si është e mundur, mendonin kolegët, që një hiç njeri të fyente dhe të shqetësonte kokën shkencore të kombit, akademikun Xheladin Apollonia, krahun e djathtë të udhëheqjes dhe përfaqësuesin më të nderuar të Republikës në konferencat ndërkombëtare? Dhe ky hiç njeri i pafytyrë paska guxim të rrijë akoma në kolltuk pa u zverdhur dhe pa u skuqur!...

– Po çfarë ka shkruar vallë në ato fletushka të katranosura? – i pëshpëriti Zyrap Kandari në vesh kolegut të tij të ngjashëm Sotir Kuckës.

Sotir Kucka mblodhi supet dhe zgjati përparrë buzet e mbyllura. Atij vetëtimthi i shkuani mendtë në pabesinë e akademikut Xheladin Apollonia. Dane Gajtanin Xheladini e kishëte shok fëmijërie dhe ia zhveshi lakuriq diskutimin e shkruar, duke e sharë përparrë njerëzve gati të panjohur. Dhe kuptohet pse e bëri këtë. E bëri nga frika! He, he! Kur të ngrihet të diskutojë Dane Gajtani, ne ta dimë që Xheladin Apollonia ia ka sharë që më parë diskutimin. Atëhere, i thotë udhëheqjes: “unë ia dërmova diskutimin Dane Gajtanit, kur ma dha shoqërisht t’ia lexoja. Për këtë janë dëshmitarë akademikët Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari bashkë me gratë e tyre.”

Akademiku Sotir Kucka e ledhatoi me pëllëmbë veshin e skuqur, pastaj ferkoi instiktivisht duart dhe ia hodhi sytë Xheladin Apollonisë. Kësaj fytyre nuk i zihet besë, mendoi ai dhe psherëtiu.

Dane Gajtani, i huaj mes të njohurve, vështroi një herë rrëth mureve me rafte librash, i ngriti sytë në tavan, mandej mori kapelen e kashtës nga gjunjët e tij të gjatë dhe u ngrit, i pandjekur nga asnje vështrim. Le ky Sotiri që u zu për veshi, por këta ç'kanë që s'm'i hedhin sytë? – pyeti ai me vete.

Për atë nuk ishte e panjohur kjo gjendje shpirtërore, kjo pamje e këtyre njerëzve dhe e këtyre mureve të heshtur dhe kjo vetmi në kohën e largimit, kur askush nuk të përcjell dhe askush nuk të jep dorën. Po, po! Në kohën kur bëhej tufëzimi i bagëtive nëpër fshatra, kur shkonin e vinin të deleguar nga qendrat dhe rrëthet për t'ua mbushur mendjen bujqve se bagëtitë nuk duhej t'i mbanin nëpër shtëpitë e tyre, por lypsej t'i dorëzonin në kooperativë, ai, Dane Gajtani i marrë, kundërshtoi. Mblodhi fshatin në sy të deleguarve dhe tha:

– Po t'i hiqni lopët nga shtëpitë dhe t'i futni në pronën e përbashkët, do të vdisni. Nuk do të keni as qumësht, as djathë, as gjalpë, as gjizë. Do të ktheheni në blerës të thjeshtë apo më mirë në lypës. Janë gjepura ato që thonë të deleguarit se do t'ju mbajë me bylmet kooperativa. Lopët që do të dorëzoni ju në kooperativë do të kthehen në shterpa dhe do të ngordhin. Ju nuk do ta ndjeni më erën e gjalpit në tigan. Në oborret tuaja nuk do të dëgjohet më dybeku, prandaj mendohuni mirë para se të jepni lopët. Ky do të jetë hapi i fundit drejt varfërisë...

Mes fshatarëve u bë një heshtje varrimi. Të gjithë ulën kokat dhe trazonin me gishtërinjtë dhe me kleçka këpucët dhe opingat apo dheun ku ishin ulur. Kjo ndodhi në fillim. Pastaj u ngriten shtatë a tetë nga fronti, nga gruaja, nga rinia apo nga partia dhe filluan të bërtasin:

– Do t'ia falim lopët partisë! Për atë ne jemi gati të falim jetën, jo lopët! Do të shpëtojmë nga bajgat. Fëmijët tanë nuk do të merren me bagëtitë, por me shkollën. Do ta bëjmë fshatin si qytetin. Kryetari ynë gënjen, kur thotë se do të vdesim për një pikë qumësht. Socializmi nuk le të vdesë njeri...

Të deleguarve pas këtyre fjalëve u ndritën fytyrat. Njerëzit tani janë të brumosur ideologjikisht dhe nuk bien viktima të provokatorëve të tillë si Dane Gajtani, që shkel bukën e Parti-

së, që socializmi i dha shkollë dhe e bëri kryetar të një ekonomie të madhe dhe...

Më i moshuari dhe më i shquari në përgjegjësi i të deleguarve u ngrit, rrudhi ballin plot mendime, nxori gjoksin dhe zgjati përpara krahun. Tryeza e mbuluar me një beze të kuqe u tund në sheshin para shtëpisë së kulturës dhe u përbys kana me ujë nga lëvizja nervoze e të deleguarit të shquar.

– Vëllezër, – tha ai, – heqja e bagëtive nga oborret vetjake dhe futja e tyre në pronën kolektive u prit si sihariqi më i madh që dha Partia në të gjithë vendin. Tufëzimi i lopëve do të sjellë lumturi. Ja se ç'shkruan një nga poetët tanë të shquar:

### *Tufëzim*

*Ngjiturje në shkallën e lartë të qiellit,  
Të qiellit pa re komunist,  
Pastrim ndërgjegje nga vetjakja pronë,  
Vërvshim lumturie dhe drite sigurisht  
Por më shumë ngritje drejt së ardhmes sonë.*

Unë ju bëj thirrje që ju, vëllezër, të shprehni patriotizmin tuaj si dje në luftë dhe të përqafoni pa rezervë tufëzimin. Mua më vjen keq, që shoku Dane Gajtani të shprehë mendime prej dezertori revizionist, në një kohë kur uniteti i popullit është i çeliktë dhe Shqipëria shkëmb graniti.

Megjithatë fshatarët nuk i ngrinin kokat. Dane Gajtani e ndiente se ata nuk donin t'i jepnin lopët. Fshatari kur nuk pajtohet me diçka, nuk flet, vështron tokën dhe e kruan atë me kleçkë, ose, fut dorën në lukth të shpinës dhe me kokë mënjanë mundohet ta kruajë sa më thellë.

Nga mesi i fshatarëve u ngrit një burrë nja pesëdhjetëvjeçar dhe tha se çdo gjë do të marrë fund po të tufëzohen lopët. Fshati do të prishet dhe njeriu do të prishet. Do të kthehemë në një racë tjetër, që nuk do të na njohë Ballkani. Do të shkruajnë libra pér ne dhe do të mundohen ta gjejnë se si e ndryshuan racën, çfarë ilaçë pimë, çfarë shartime bëmë në fëmijët. Do të kthehemë në gozhumelë të tillë sa të llahtarism Ballkanin dhe kur të na pyesin: “çudi, si u kthyet në gozhu-

melë, ju që ishit raca më e mirë e Ballkanit", ne do t'u përgjigjemi:

– Të dashur ballkanas, ne u kthyem në gozhumelë se ja falëm lopët qeverisë!

Këtu plasi një gaz i padëgjuar. Njerëzit mbanin duart në ije dhe përkuleshin deri sa u zinte balli në tokë.

– Nuk duam të kthehemë në gozhumelë! Nuk i japim lopët! – thirrën të gjithë.

Të deleguarit u nxinë. Dane Gajtani gati sa s'qante (nga pajtimi i fshatarëve me mendimet dhe dëshirat e tij). Atij i vërshoi një valë e nxehë malli për njerëzit, për thërrimet e dheut, për fijet e barit, për fletët e pemëve, për rrëkezat e ujit buzë arave.

Atë ditë fshatarët nuk i dhanë lopët. Më vonë u bënë edhe mbledhje të tjera. Erdhën sekretarë të Komitetit të Partisë, ministra e zëvendëskryeministra, deri sa u duk se ua mbushën mendjen. Pastaj e detyruan Dane Gajtanin të bënte autokritikë, por nuk pranoi, atëhere e shkarkuan nga posti i kryetarit dhe e vunë bari dhensh. Katër vjet të tëra ai brodhi kodër më kodër e mal më mal me krrabë në dorë i vëtmuar, pasi njerëzit kishin frikë t'i afroheshin ngaqë ishte hapur fjala se do ta arrestonin. Dhe vërtetë disa herë e kishin thirrur në degën e brendshme, duke e pyetur se me ç'njerëz kishte folur kundër kolektivizimit dhe se nga i kishin lindur pakënaqësitet. Madje i kishin bërë edhe kontroll në shtëpi për t'i gjetur ndonjë dokument të shkruar. Për çudi të çudirave i kishin kërkuar të dhëna edhe për akademikun Xheladin Apollonia, duke e provokuar për të folur keq ndaj tij. Dreqi e merrte vesh se ç'plane kishin!

Por Dane Gajtani shpëtoi për mrekulli. Pas katër vjetëve e emëruan si veteriner në fshatin e tij. Dhe tani i qenqësh shkrepur të mbante dhe një diskutim në Konferencën Kombëtare Shkencore! Ah, ç'i marrë qenqësh ky Dane Gajtani!

I vëtmuar në shpirt ai qëndroi gjatë në këmbë në studion e Xheladin Apollonisë. Mandej ia dha dorën Rités, duke ia shtrënguar fort, aq sa ajo shtrembëroi fytyrën nga dhimbja.

– Skandaloz! – pëshpëriti ajo duke e parë drejt e në fytyrë.

– Për të tjerët, jo për ty! – tha Dane Gajtani me ngadalë dhe iu duk sikur ajo i buzëqeshi.

Ia bëri me kokë miqve që heshtnin pa vështruar njeri dhe doli pa derdhur asnje fjale nga buzët e tij të trasha.

Studioja e Xheladin Apollonisë u lehtësua nga pesha që mbante.

– Iku, mo? – pyeti akademiku me sytë në tryezë.

– Iku pa bërë zë! – tha Zyrap Kandari.

– Hi-hi! Do t’ia ndjejmë zërin nesër në Konferencë, – tha profesor Sotir Kucka duke fërkuar veshin e skuqur.

– Të dhëmb, mo? – pyeti akademiku Xheladin Apollonia.

– E, një shaka ishte! – tha Sotir Kucka dhe u mundua ta besonte edhe vetë se shtrëngimi ishte një ndër shakatë e Dane Gajtanit.

– S’do mend, qe shaka, – pohoi shembëllimi i tij, Zyrap Kandari.

Rita nuk e fshehu shprehjen e tharët të fytyrës ndaj të vëllait të saj të lëkundshëm dhe të qulltë, të atrofizuar në trup dhe në mendime.

Ditën e hapjes së Konferencës Dane Gajtani u ngrit herët, në çastet kur kurrizi i «Dajtit» merr ngjyrën e së kuqes së vezës së pulave të shtëpisë. Pulat e pularive shtetërore, mendoi ai, në dritaren e dhomës së hotelit, të verdhën e tyre e kanë të zbehtë e të limontë, si fytyrën e akademiku Xheladin Apollonia. Dhe ai filloj ta rikrijojë fytyrën e mikut të tij. Në këtë rikrijim vuri re diçka që nuk e kishte dalluar në takimet me akademikun. Kishin të dy një moshë, por ndërsa Dane Gajtani flokët i kishte të zinj, Xheladin Apollonia i kishte krejtësisht të thinjur dhe dukej shumë më i vjetër dhe më autoritar se ai. Dihet, mendoi Dane Gajtani, unë nuk shoh ndonjë ndryshim në mendjen time me kalimin e viteve! Është po ajo mendje e njëzet, pesëmbëdhjetë, apo dhjetë vjetëve të shkuar. Rita Kuckës këtë ia thashë me shaka, por është e vërtetë. Edhe flokët më kanë mbetur si dikur, edhe krahët, edhe këmbët... Pastaj vuri dorën në hundë. A, po! Edhe leshi i hundës... Këtu ai filloj të qeshë në dritaren e hotel «Pezës» përballë «Dajtit» me ngjyrën e së kuqes së vezës së pulave të shtëpisë. Mandej e pushtoi një mérzi. Kujtoi mbrëmjen në studion e akademikut Xheladin Apollonia. Nuk e merrte me mend se ç'ishte gjithë ai tèrbim pas leximit të diskutimit të tij. Mos njerëzit kanë harruar të flasin qetë dhe shtruar? Një mendim i quajtur i gabuar, pse hidhet poshtë me egërsi e të bërtitura si një krim? Shkenca ka një moral. Ku shkoi ky moral? A mund të bërtasë shkencëtarë si gardian burgu? Me këtë moral idetë zyrtare nuk mbrohen me diskutim, por sigurohen me roje, ndërsa idetë kundërshtare hidhen poshtë kategorikisht dhe burgosen.

Ai e krahasoi studion e akademikut Xheladin Apollonia me auditorin e konferencës. Studioja e akademikut është një

gotë verë, auditori i Konferencës është një fuçi nga ka dalë kjo gotë...

E provova me studion cilësinë e kësaj vere... Është më e udhës të mos e nxjerr nga xhepi diskutimin. Ç'më duhet të shkoj si cjapi tek kasapi! – tha me vete dhe i hodhi një vështrim ftesës së Konferencës Kombëtare Shkencore. Mbi Dajt tani ishte ngritur dielli i téri i kuq, si fytyra e një fshatari të ushqyer mirë në tetor. Dane Gajtani veshi xhaketën e bardhë, mori mbi tryezë ftesën dhe kapelen e kashtës dhe doli. Ishte fund qershori dhe dita do të rritej mes nxehësisë. Që në mëngjes, kur kjo ditë ishte ende fëmijë, ndjehej vapa e ardhshme e padurueshme, që do të ngathtësonte dhe përgjumte kryeqytetin, që do t'i zhyste mendimet në zhegun e dendur. Por edhe pa këtë vapë mendimet kanë qenë në zheg, të fjetur në gjumin përtac, që s'guxonte njeri t'i zgjonte, – mendoi Dane Gajtani duke dalë në rrugë e duke ndjerë afshin e tharët e të ngrohtë të asfaltit.

Mëdyshja e tij, ta mbante apo të mos e mbante diskutimin, ende përpërlej në muret e gjoksit të vet të gjerë. Meqë kishte ende dy orë deri sa të fillonte Konferenca, mjaftonte koha për t'u menduar përrugën që do të merrte diskutimi. Mbi të gjitha tani atij i duhej një kafe e fortë dhe një mik i mirë për të këmbyer ndonjë fjalë. Etja për kafen dhe përfjalën vjen pas heshtjes së natës, pas kuvendimit me vetveten, pas mërzisë monotone, dhe pas krijimit të zbrazësisë në gjoks. Zbrazësia ka nevojë të mbushet. Dhe atë e mbush fjalë.

Në kafe «Tirana» kishte vetëm tre-katër të moshuar, klientë të përhershëm, që pasi kishin bërë pazar duke qëndruar në radhë nga dy orë, ishin kthyer të preheshin dhe të pinin diçka. Ai asnje nga ata nuk njihte dhe u ul i vëtmuan në një tryezë në qoshe. Vuri kapelen e kashtës në gjunjë siç e kishte zakon, dhe nxori diskutimin nga xhepi për t'i hedhur vështrimin e fundit. Për këtë diskutim nuk ndiente as gjëzim e as emocion, përveç një ankthi të turbullt.

Kur i sollën kafenë, ai ngriti kokën dhe pa Ritën tek qëndronte krah kamarierit. Kjo ishte një e papritur e këndshme. Para saj fletët e diskutimit të tij u bënë akoma më të zbehta

dhe i futi në xhep, duke i zhubrosur, si letra të gjetura rastësisht në truall.

Rita u ul përballë tij. Qeskat nën sytë i kishte pak të fryra, sikur të kishte vuajtur nga veshkat dhe të kishte kaluar një natë pa gjumë. Megjithatë nuk e kishte humbur gjallërinë. Kërkoi shpejt e shpejt kafe e cigare, gërmoi në çantë për të gjetur kutinë e shkrepseve dhe shaminë e dorës dhe filloi ta pyesë Dane Gajtanin se si e kishte kaluar natën dhe nëse ishte mërzitur pas konfliktit në studion e akademikut Xheladin Apollonia.

– Kemi qenë shokë shkolle. Nuk e prisja sjelljen e tij të pahijshme, – tha ai dhe vuri në buzë filxhanin e kafesë.

Edhe Rita e ngriti filxhanin e saj dhe pastaj ndezi një cigare, duke e vështruar me bisht të syrit Danen.

– Dhe mendon ta mbash sot diskutimin? – Në tonin e pyetjes së saj nuk ndjehej dëshira që Dane Gajtani të fliste në këtë konferencë.

Dane Gajtani e vërtiti në dorë filxhanin e kafesë me një buzëqeshje të sëmürë.

– Mund ta mbaj... Zakonisht arrat e krimbura thyhen lehtë...

Rita e shkundi hirin e cigares në shpuzore.

– Po sikur të heqësh dorë?

Ai e la filxhanin dhe e shtyu në buzë të tryezës, pastaj ia afroi Ritës gojën në vesh dhe i këndoi ngadalë:

*Jam flutur e natës rrëth llambës  
Rrëth llambës se drita më fton  
Dhe prapë e rrëmbyer prej natës,  
Kur digjem dhejeta mbaron.*

*Përhumbur çuditem me veten:  
Me natën jetoj dhe pastaj  
Mërzitem dhe dritës i kthehem  
Që shpirtin ta vdes afër saj.*

Dane Gajtani pas kësaj, që vetë e quante këngë, heshti për disa caste, të cilat në këtë rast mund të dukeshin si një kohë e

gjatë. Vuri duart nga të dy anët e kokës me bërryla të ngulur si dy hunj në tryezën e vogël të rrumbullaktë dhe pshëretiu themë:

– Kur u ngrita në mëngjes dhe pashë kurrizin e Dajtit me ngjyrën e të kuqes së vezës së pulave të fushës, jo të pularive shtetërore, mendova të mos merresha me diskutimin dhe të kthehesha në fshat. Pastaj m'u prish mendja. Do ta mbaj...

Vajza e vuri natyrshëm dorën e saj mbi të tijën dhe e mbajti për një çast të pa lëvizur, mandej e ngriti dhe e vuri përsëri. Cigarja e saj në shpuzore kishte zgjatur cilindrin poroz të hirit.

– Profesori mbrëmë, pasi u largove tha se diskutimi yt ishte krejtësisht i gabuar, madje antiparti...

Dane Gajtani qeshi me zor.

– Me ton të lartë foli?

– Nuk është për të qeshur! Profesori e tregoi nëpër mjegull përbajtjen e diskutimit dhe tha se po të mbahet e prish tërësisht atmosferën e Konferencës. Me sa kuptova ai do të bëjë çmos që mos të ta japë fjalën. Prandaj, sa të bëhenh grindavec ose qesharak, më fisnike është që të heqësh dorë... – tha ajo.

Ai heshti për një çast. Mori nga gjunjët kapelen e kashtës dhe filloi ta shikojë, duke e vërtitur në duar sikur të kërkonte ndonjë vend të shqepur e të grisur në strehët e varura të saj. Këto vërtitje e mërzitën dhe e nevrikosën Ritën. E po ky qenka maniak pas kësaj kapeleje, mendoi ajo, por nuk foli.

– Ju do të vini në Konferencë? – pyeti ai pa i ngritur sytë nga kapelja.

– Konferanca nuk ka lidhje me mjekësinë, ku punoj unë, por Sotiri më ka gjetur një ftesë, – tha ajo.

– Atëhere diskutimin do ta mbaj...

Rita e kuptoi se këto fjalë nuk kishin të bënин fare me diskutimin, por me simpatinë që ai shprehte ndaj saj dhe, megjithëse në to ndjehej një shaka e lehtë, i erdhë mirë. Ky njeri i vështirë, sipas mendimit të saj, kishte filluar të zbutej.

Në kafe hyri Sotir Kucka me borsalinë dhe kostum ngjyrë hiri, i shtrënguar me një gravatë të kuqe me pikë të zeza. Po vinte ora e hapjes së Konferencës dhe ai ishte kthyer të pinte një kafe. I hodhi një vështrim së motrës, pastaj i bëri me kokë

Dane Gajtanit, duke hequr borsalinën në shenjë nderimi. Rita i bëri me dorë dhe e ftoi të ulej në tryezën e tyre. Megjithëse nuk donte të rrinte me Dane Gajtanin, iu bind së motrës.

– Mos u tërhiq, mbaje diskutimin! Shkenca kërkon guxim. Pa gabime s'ka shkencë. Profesor Xheladin Apollonia është personalitet me vlera të mëdha. Por... – tha ai dhe nuk e vazhdoi mendimin, pasi erdhi kamarieri.

– Një kafe për profesorin! – tha Rita.

– Po, po, një kafe, – përsëriti Sotir Kucka. – Por, ah, por... – iu kthyte Danes – Ah, por, ta lëmë më mirë këtë gjykim...

– Lëre, Sotir, – ndërhyri e motra.

Dhe Dane Gajtani e kuptoi më qartë se anëtari me korrespondencë i Akademisë Sotir Kucka, nuk duhej të kishte me Xheladinin ato marrëdhënie miqësore siç dukeshin në sipërfaqe. Me siguri mes tyre duhej të kishte ndonjë mëri të vjetër.

Kafen Sotir Kucka e rrufiste me zhurmë të madhe. Zhurma që dilte nga filxhani i ngjante frymës së erës në hatull. Rita mezi e duronte këtë rrufitje dhe prishte buzët me një ndjenjë të hapur ndoti në fytyrë.

Sotir Kucka sa e piu kafenë, vështroi orën dhe u ngrit.

– Minutat na ndajnë nga evenimenti! – tha ai solemnisht dhe ngriti lart gishtin tregues.

Në sheshin para ndërtesës së Kuvendit Popullor, ku do të mbahej Konferanca, shkonin e vinin njerëzit si në panair: shkencëtarë të thinjur e të rinj, brigadiere me përvojë, të veshur me rroba kombëtare, zyrtarë me çanta në dorë, gjeologë popullorë, mësues, barinj dhensh me arritje të larta në qu-mësht, shkrimitarë të temës së klasës punëtore, rapsodë që i kishin kënduar me lahitë e çifteli ekonomisë, heronj të punës socialiste me yje të artë në gjoks. Në shkallët kuvendorin me njëri-tjetrin djemtë dhe vajzat, nuset dhe dhëndurët e udhëheqësve, të veshur e të mbathur sipas modës së fundit europiane, me lëkurë të lëmuar në fytyrë, me gjerdanë e unaza nëpër gishtërinj, duke përtypur çamçakëza me përkëdhelje elegante! Kjo kategori njerëzish gjithmonë i ndiqte evenimentet e

mëdha historike, konferencat, festivalet folklorike kombëtare, kongreset e Partisë dhe të organizatave të masave dhe zinte vend ose në radhët e para ose nëpër llozha, duke gjuar ndërim të madh e duke dëgjuar pëshpëritjet tërë përulësi edhe të dijetarëve më të shquar:

- Djali i shokut...
- Vajza e shokut...
- Dhëndri i shoqes...

Më në fund arriti edhe akademiku Xheladin Apollonia me të shoqen, Netën. Kostumi i zi, jo si zakonisht, ngjyrë hiri, i derdhej në trupin e gjatë dhe kravata e kuqe i lulëzonte në jakën e këmishës së bardhë. Ai përshëndeti me kapele dhe shkoi drejt djalit, vajzës, dhëndrit dhe nuses së shokut K. apo Q. I zuri për dore, iu buzëqeshi, u lumturua në fytyrë dhe ngjitti me shpejtësi shkallët e gjera, të gurta për të hyrë në ndërtesën e Kuvendit Popullor e për t'u takuar me udhëheqjen, që pinte kafe në sallonin e veçantë të Presidiumit të Konferencës.

Dane Gajtani me Ritën qëndruan nën hijen e bredhit, që zgjaste krahët deri pranë murit të ndërtesës së Kuvendit Popullor. Ai pinte cigare dhe vështronë njerëzit e lumtur, që prisnin hapjen e Konferencës dhe me këtë rast takoheshin me njëri-tjetrin ose për të këmbyer dy-tri fjalë, ose për të ndërhyrë për të siguruar ndonjë të drejtë studimi në universitet, ndonjë apartament, ndonjë vend pune të ngrohtë, ndonjë transferim të një mik apo të afërm nga provinca në kryeqytet. Dane Gajtani nuk fliste. Vetëm pinte duhan dhe vështronë. Mundohet me vështrimin e tij të gjente ndonjë shkencëtar, por më kot. Madje edhe anëtari me korrespondencë i Akademisë, që pak më parë ishte krah tij i humbi nga sytë, dhe filloi të bëhej nervoz që nuk gjente shkencëtarë.

- Ku janë shkencëtarët? – pyeti ai Ritën.
- Nëpër njerëzit.
- Po gjithë këta njerëz ç'janë?

Rita qeshi.

- Të ftuar, aktivistë të shkencës, dashamirës, intelektualë...
- Hëm! Edhe shkenca paska aktivistë? Folklor, domethë-në... – bëri Dane Gajtani dhe s'e zgjati.

Nëpër lulishte vinte drejt Danes dhe Ritës një burrë i shkurtër me fytyrë të verdhë, me një çantë të zezë në dorë. Dane Gajtani e njoju. Ishte drejtori i drejtorisë së kuadrit në Ministrinë e bujqësisë, Selam Dervishi. Qenka bërë dhe Selami shkencëtar, qeshi ai me vete.

– Paske ardhur, Dane? Si ore s’na je kthyer nga ministria nënë që të mban me bukë, – qeshi Selam Dervishi dhe e zuri për qafe duke ia dhënë pastaj dorën Ritës.

– Rita Kucka, – u prezantua vajza.

– E motra e profesor Sotir Kuckës, – shpjegoi Dane Gajtani.

– Ah, fare bukur! Kush nuk e njeh profesor Sotir Kuckën!

– ngriti gishtin lart Selam Dervishi e shtoi: – do të më falni, më kërkon ministri.

Dane Gajtani e ndoqi me sy dhe pshëretiu.

– Pse pshëretin? – pyeti Rita.

– Ky ëngjëll me çantë do të më thërrasë në zyrë pas konferencës.

– Për ndonjë punë? – pyeti Rita.

– Për përbajtjen e diskutimit... – tha ai.

– Tuaf! – bëri Rita.

Ndërkohë njerëzit filluan të hynin të qeshur dhe festivë si në një koncert të madh. Po hapej Konferenca e shumëpritur.

Dane Gajtani me Ritën u futën të fundit, kur të nderuarit dhe të zgjedhurit po ngjiteshin në presidiumin e madh. Në këtë pallat të ajkës sociale, përveç shkencëtarëve, siç thamë, kishte edhe njerëz të dalluar në veprimtari shoqërore. Në mes të radhës së parë të presidiumit zuri vend akademiku Xheladin Apollonia. Ai rrinte në mes dy udhëheqësve të lartë, pasi do të hapte Konferencës, meqë kryetari i Akademisë ishte i sëmurë dhe mungonte.

Në një radhë në sallë rrinin të tri gratë e shkencëtarëve, Neta, Anifeja dhe Adelina, të lumtura që do t’i dëgjonin burrat e tyre të flisnin për gjëra të mëdha, që do t’i mbeteshin historisë kombëtare. Vërtet, vitet e fundit ato kishin filluar të mendonin për historinë. Madje, Neta këtë e kishte shprehur haptas. Një ditë në shoqërinë e grave të shkencëtarëve dhe të intelektualeve të shquar ajo kishte thënë:

– E dini, motra, se ka filluar të më shqetësojë historia? Dikur për historinë aspak nuk kam menduar. Tani historia s'më hiqet nga mendja. Burrat tanë, që neve na duken të zakonshëm, pasi flemë me ta, do të hyjnë në histori. Dhe ne bëjmë gabim që mendimet e tyre nuk i mbajmë shënim, apo nuk i regjistrojmë në magnetofonë të vegjël. U duhen brezave.

– Ke të drejtë! Dijetarët i përkasin historisë. E, historia! – kishte pshërëtirë Anifeja.

Ndërsa Adelina e ngathët kishte tundur kokën, ishte matur të fliste diçka rreth historisë, por e kishte lënë nga përtacia.

Xheladin Apollonia në presidium teatralisht tërhoqi zinxhirin e çantës së zezë dhe nxori fjalën e hapjes. Auditori preu frymën. Akademiku ktheu kokën një herë nga njëri udhëheqës dhe një herë nga tjetri dhe u ngrit mes breshërisë së duartrokositjeve të dëgjuesve, veçanërisht të grave, të cilat kishin një dobësi të hatashme për figurën e tij. Madje ato nuk përbaheshin pa bërë «oh» dhe «ah» kur e shikonin nëpër tribuna. “Lum ajo grua që e ka”, thoshin ato dhe Neta bëhej me krahë, pasi e njihetëndershmërinë e tij në marrëdhëni me femrat, megjithëse dëgjonte edhe ndonjë pëshpëritje.

Ai në fillim foli për rëndësinë e padiskutueshme të Konferencës Kombëtare Shkencore, numëroi arritjet e ekonomisë socialiste dhe u ndal në detyrat e shkencës ekonomike dhe të teorisë së saj. “Teoria, – tha ai, – është gjeneratori i centralit të formimit botëkuptimor, gjenerator që e ushqen me dritë orientuese njeriun”. Me t'u dëgjuar kjo shprehje, kjo sentencë figurative, gjëmoi në fillim breshëri i duartrokositjeve, pastaj fërfériu vala e admirimeve: “E, po këto janë fjalime! Ke qejf t'i dëgjosh!”. Ndërsa Dane Gajtani, që ishte ulur krah Ritës, e shtrëngoi mjekrën me dorë dhe shfryu:

– O zot, na mbyll veshët që të mos dëgjojmë gjepura të tilla.

Rita e pa me zemërim:

– Ju çdo gjë e nxini! Edhe një sentencë origjinale e merrni nëpër gojë!

– Hëm! – bëri ai dhe heshti.

Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari dy-tri radhë para Danes dhe Ritës, kishin ngritur kokat pakëz të shtypura nga pas dhe

dëgjonin si në gjemba. Sotir Kuckën e brente frika se mos Xheladin Apollonia e priste në besë dhe e thoshte në fjalën e hapjes atë mendimin që ia kishte dhuruar në studion e tij plot zemërgjerësi.

– Di të krijojë figuracion! – tha Zyrap Kandari për Xheladinin.

– Ia kam zili! – psherëtiu Sotir Kucka.

Akademiku Xheladin Apollonia, duke folur, e ngriti lart gishtin dhe, sikur të këndonte një këngë, theksoi me një zë melodioz:

– Mbi të gjitha ne vëmë planifikimin e prodhimit dhe harmonizimin e ecurisë së gjithë degëve të ekonomisë. Kjo formon centralizmin, si një domosdoshmëri zhvillimi...

– Pu, pu! – e tha i pabesi! – vuri duart në kokë Sotir Kucka.

– Prit, Sotir, se nuk e ka thënë, – e qetësoi Zyrap Kandari.

Ndërkojë akademiku Xheladin Apollonia vijoi:

– Madje edhe natyra, që është e pandërgjegjshme, bën planifikim. Ç'është ekuilibri i natyrës? Është planifikim. Ç'është ndotja e natyrës që prish ekuilibrin e saj! Është antiplanifikim! Është një farë anarkie. Natyra, madje, ka një planifikim tepër të centralizuar, pasi dëshiron të mbrojë vetveten. Pa centralizëm nuk ka mbrojtje të vetvetes. Edhe vetvetja është një centralizim...

Këtu të dy udhëheqësit zgjatën përpara duart dhe përplasën me të madhe shuplakat me një gaz të papërmrbajtur në ftyrrë. E gjithë salla u ndez nga një duartrokitje e paparë, aq sa dukej sikur qindra gishtërinj lëshonin shkëndija.

– Pë-pë, ç'figurë!

– Pë-pë, ç'kokë e madhe shkencore!...

– Krenari e vërtetë kombëtare!...

– Dimensione evropiane!...

– Këtij i them burrë unë!... – pëshpërisnin njerëzit të ekzaltuar nga fjala e akademikut Xheladin Apollonia.

Anifeja me Adelinën u përkulën dhe përqafuan Netën, të shoqen fatlume të akademikut. Ato madje i vunë kokat e tyre në prehërin e Netës, duke u përlotur nga vërvshimi i ndjenjës

së kënaqësisë. Dhe ndjenin krenari që ishin shoqe të gruas së kokës së madhe shkencore kombëtare. Por Adelina, që me vonesë e kapte mendimin, pas një çasti erdhi në vete dhe thirri:

– Pritni, pritni! Profesori sikur ia fali këtë ide Sotirit tím! Ç'bëri kështu, moj Netë! Kjo nuk është e ndershme! I ziu Sotir e kishte marrë me qejf këtë ide dhe e përkëdhelte tërë natën!

Neta prishi buzët.

– Ehu! Sa ide jep Xheladini! Ai kujt s'i ka dhënë ide! E harroi se kujt ia ka dhënë dhe e futi në fjalim! Punë e madhe!

– E, vërtet! – mori frymë thellë Anifeja dhe perëndoi syçkat.

Adelina i hodhi nga lart një vështrim keqardhës Sotirit, të shoqit të saj të përvuajtur. Ai e kishte varur kokën tërë mërzi dhe dukej sikur qante për idenë që ia kishin marrë. Kurse Zyrap Kandari, që i rrinte në krah, i ra me grusht anës së karrikes:

– I pabesi! Të dogji kumtesën!

– Ma fali botërisht idenë dhe ma mori përsëri, i paturpshmi! – tha Sotir Kucka me pikëllim dhe me vrer.

– Tani s'të mbetet gjë tjetër veçse të citosh në kumtesë Xheladin Apolloninë, – tha Zyrap Kandari, duke shtrënguar dhëmbët.

Edhe Ritës i erdhi keq për të vëllanë:

– I ligu Xheladin! – tha ajo me zemërim.

– Pse? – pyeti Dane Gajtani që nuk e kishte mendjen.

– Idenë e krahasimit të planifikimit të ekonomisë me planifikimin e natyrës Xheladin Apollonia ia kishte falur Sotirit ta përdorte në kumtesën e tij! – shpjegoi Rita.

Dane Gajtani qeshi me zë të lartë duke harruar se ishte në sallë.

– Ku-ku, moj nëne, ku kam rënë! – tha ai dhe vuri duart në kokë.

Zëri i tij u dëgjua në radhët e afërtë dhe njerëzit e vështruan me zemërim.

– Bah! Kush ua jep ftesat këtyre injorantëve? – pëshpëriti njëri.

Dane Gajtani nuk pushonte së qeshuri.

– Pse qesh? – tha Rita.

– Po ky krahasim është një gjepur me bisht! Unë habitem si duartrokasin këta të marrë në sallë dhe ata budallenj në presidium! – tha dhe uli kokën në dy pëllëmbët e duarve të mëdha.

Dane Gajtani e priste fjalën të nesërmen, pasi ishin mbajtur gjithë ato kumtesa dhe diskutime. Por edhe të nesërmen nuk donin që ai të diskutonte, megjithëse e kishte shënuar emrin me kohë në listën e diskutantëve. Me sa dukej Xheladin Apollonia e linte mënjanë emrin e tij, pasi e dinte përbajtjen skandaloze të diskutimit të këtij njeriu të rebeluar. Atëherë Dane Gajtani u ngrit nga vendi dhe kërkoi me zë të lartë ta linin të diskutonte. Ngritja e tij në mes të auditorit me njerëz të zgjedhur dhe të nderuar ngjalli anë e mbanë pëshpëritje, pasi u duk si shenjë e prishjes së harmonisë së kompozicionit të konferencës. Me javë të tëra ishin marrë masa që kjo Konferencë të hapej e të mbyllej me një rregullshmëri harmonike, si lëvizjet e një mekanizmi të përpiktë.

Me ngritjen e Dane Gajtanit lëvizjet simetrike të këtij mekanizmi dukej sikur prisheshin.

Akademiku Xheladin Apollonia, kur u ngrit Dane Gajtani, afroi buzët drejt veshit të njërit prej udhëheqësve dhe diçka i pëshpëriti. Udhëheqësi u ngrys në fytyrë.

– Në asnjë mënyrë! – bëri me dorë një shenjë kategorike mohimi.

Udhëheqësi tjeter u bë kurioz dhe pyeti akademikun.

– Si qëndron çështja?

Xheladin Apollonia ia afroi buzët dhe këtij tek veshi.

Edhe udhëheqësi i dytë i ngrysi vetullat dhe zgjati kokën pranë të parit. Koka e akademikut Xheladin Apollonia tani ngrihej mes dy busteve të anuar të dy udhëheqësve që konsultoheshin. Kjo kokë akademike dukej si prej allçiu, e bardhë dhe e palëvizshme.

– Hi-hi! Shiko si i ka mbetur koka profesorit! – i tha Sotir Kucka kolegut të tij, Zyrap Kandarit, duke fërkuar duart.

Mes heshtjes së sallës, pas një kohe, bustet e dy udhëheqësve u drejtuat dhe u shfaq madhështor gjoksi me kravatë të kuqe i akademik Xheladin Apollonisë. Ai zgjati buzët tek mikrofoni dhe pa vështruar sallën tha:

– Fjalën e ka Dane Gajtani, veteriner me përvojë të gjatë. Dane Gajtani u ngrit.

– Vërtet i gjatë qenka, si përvoja! – pëshpëriti një shkencëtar i ri. Përvojëgjati i ra përmes sallës së shtruar me tapet të kuq dhe ndali në tribunë. Me kokën lart dhe me hundën, që i dukej gjysmë e zezë nga leshi, i hodhi një vështrim auditorit dhe nxori nga xhepi fletët e shkurtra të diskutimit.

– Vetëm të jetë i marrë po t'i ketë lënë ato mendime që ka patur në variantin që lexova, – tha me vete Xheladin Apollo-nia, mes dy udhëheqësve.

Dane Gajtani nuk bëri asnjë hyrje për qëllimet e Konferencës dhe për arritjet në ekonomi. Tha se ekonomia ndodhet në vështirësi të mëdha. Vetëm këtu në Konferencë ekonomia është e lulëzuar dhe nuk ka as radhë qumështi, as radhë patatesh, as radhë frutash. Vetëm në kumtesa ka mish, gjalpë, djathë, televizorë, kompjuterë e pasuri të pafundme sipas ligji ekonomik themeltar. Mandej ai shpjegoi se pas heqjes së bagëtive të oborrit të fshatarit dhe pas reduktimit të tokës vetjake, njerëzit u varfëruan deri në palcë. Tufëzimi i bagëtive të fshatarëve ishte një hap i gabuar e shkatërrimtar jo vetëm për ekonominë në fshat, por edhe në qytet. Pa liri të pronës private në fshat e në qytet nuk ka as liri të individit, nuk ka as përparrim, as çlirim shpirtëror qytetar. Pastaj u ndal në centralizmin e repte të ekonomisë, që shuan çdo nismë të përparuar dhe nuk lejon asnjë stimul material. Është një mekanizëm i ngrirë dhe i palëvizshëm, që po vazhdoi, do të sjellë shkatërrimin e vendit...

Dhe këtu presidiumi i Konferencës lëshoi një «u-u-u» të zgjatur si ulërimë ere në tunel. Fytyrat e të dy udhëheqësve u mbuluan me mjegull të dendur zemërimi. Madje njëri s'u përbajt dhe goditi pakëz tryezën me grusht. Ndërsa salsa e shprehu pakënaqësinë ndaj këtij heretiku me një «o-o-o» uniteti kundër kritizerëve të socializmit.

– Dale, shok, dale! – e ndërprenu Dane Gajtanin njëri nga udhëheqësit. – Ti po hedh baltë në realitetin tonë dhe po na servir ide dhe mendime borgjeze dhe revisioniste! – thirri udhëheqësi tjetër duke u ngritur nga vendi dhe duke iu drejtuar me gisht Dane Gajtanit.

– Ky pseudo-intelektual, me njohuri mediokre, po na del haptazi kundër parimeve të ekonomisë sonë politike dhe kundër ligjeve të saj! – u hodh akademiku Xheladin Apollonia.

Pastaj u duk sikur presidiumi heshti. Atëhere Dane Gajtani filloj të flasë përsëri me një qetësi të çuditshme, që të tjerët e quajtën paturpësi. Por ai nuk mund ta vijonte diskutimin, pasi auditori ishte hipnotizuar nga egërsia dhe nuk përmbahej. Nga salsa u vërsulën përnjëherësh pesë-gjashtë kryetarë komitetesh e pesë-gjashtë gra brigadiere të veshura me rrobe kombëtare, duke kërkuar me zemërim t'i mbyllej goja këtij nxirësi të realitetit socialist.

– T'i jepet gjyqit!

– T'i jepet organeve të diktaturës.

Të dy udhëheqësit afroan kokat pranë akademikut Xheladin Apollonia, ndërsa Dane Gajtani vazhdonte të qëndronte në këmbë i zemëruar ndaj të gjithëve. Në këto çaste të ndera, Xheladin Apollonia trokiti me laps në mikrofon.

– Diskutanti Dane Gajtani! Auditori kërkon t'ju pritet fjala! Ju lutem mos na humbni kohën e shtrenjtë!

Dane Gajtani i mbledhi qetë fletët e diskutimit, i futi në xhep dhe nën vështrimin e egër të presidiumit dhe të auditorit kaloi mes sallës dhe u ul në vendin e tij, pranë Rิตës. Vështrimet e dhjetëra njerëzve u përqëndruan në ato dy karrike, si rezet e diellit të një lente. Këto vështrime të përqëndruara digjin. Nga zjarri i tyre Rita mbronte me duar faqet e saj të skuqura prush.

– Bravo, – tha ajo ngadalë me ironi, – u bëre që njerëzit të të tregojnë me gisht...

Ai nuk foli. Nuk është e mundur që gjithë këta njerëz që jetojnë në një botë, ku marr frymë dhe unë, të mos e ndjejnë e të mos e shohin të vërtetën, të mos jenë pjesëmarrës në

ngjarjet e jetës! Ku jetojnë këta njerëz? Pse egërsohen nga e vërteta dhe pse zbuten nga gënjeshtra? – mendoi ai dhe ktheu kokën për të parë njerëzit, për të zbuluar ndonjë vështrim të butë, apo qoftë edhe keqardhës ndaj tij. Vetëm vështrime të egra!... Dhe ai psherëtiu thellë, aq sa i erdhë për të qarë. Kaq e fuqishme të jetë gënjeshtra? Çfarë force satanike duhet të ketë?

– E, ç’ë kthen kokën pas? – i ra me bërryl Rita.

– Të zbuloj ndonjë vështrim të butë ndaj meje dhe të vërtetës! – tha ai.

– Për ç’të vërtetë flet? – pyeti Rita.

Dhe atij iu shtua pikëllimi. Si të gjithë edhe kjo! – tha me vete dhe psherëtiu thellë.

– Nuk është e mundur! – tha ai i papërqëndruar.

– Çfarë s’është e mundur? – pyeti Rita me zë të ulët.

– Që ato të vërteta që fola të mos i kuptojnë këta që janë ulur nëpër karrike... – tha ai.

– Ka të vërteta që nuk thuhen...

– Dhe vjen një kohë që thuhen përmes dhimbjes dhe ndoshta gjakut... – foli nëpër dhëmbë Dane Gajtani.

Mandej ai heshti, duke shtrënguar ballin me dorë. Për çudi i vinte gjumë, sikur të kishte lëruar tokën.

Rita për ta qetësuar ia vuri dorën në gjunjë. Ai u drodh.

Pastaj papritur i vetëtinë sytë. I erdhën në mend disa vargje të improvizuara dhe filloi t’ia këndoje Ritës në vesh:

*M'u shkrep të mbaj një kumtesë,  
Kumtesa u bë diskutim,  
Më thanë: – na preve në besë,  
Ndaj more nga miqtë mallkim,*

*Se ishte i keq diskutimi,  
E bënte dhe shkencën përshest,  
Në vendin ku ndrit përparimi,  
Kujeta e njerëzve qesh.*

*Tani të vjen turp nga një zonjëz,  
Që hesht e s'lëviz një qerpi...  
Nga shkenca s'kafshon as një copëz,  
O hunda me lesh heretik!...*

*Të presin mallkime të tjera,  
Vetmia të pret me trishtim,  
Kjo zonjëz do fryjë si era,  
Dhe kurrë s'të vjen në takim.*

*Ç't'u desh të shkosh në tribunë,  
Atje diskutimi ç't'u desh,  
O Dane Gajtani me gunë,  
O hunda e madhe me lesh...*

Rita qeshi dhe ia shtrëngoi gjurin me dorë. Ajo çuditej me këtë njeri që kishte zemër të bënte humor edhe mes një fatkeqësie kaq të rëndë. Ky ndoshta nuk e quan fatkeqësi, mendoi ajo.

Dane Gajtani e largoi mendjen nga vargjet dhe nga Rita dhe ia hodhi sytë presidiumit. Dy udhëheqësit flisnin me zemërim me akademikun Xheladin Apollonia. Me sa duket i tërhiqnin vërejtjen për lejimin e diskutimit heretik. Si ishte e mundur ta lejonte pa ia kontrolluar përbajtjen! Të dy udhëheqësit dhe Xheladin Apollonia nuk e kishin mendjen në asnjë kumtesë që lexohej në tribunë. Ajri i atmosferës së Konferencës kishte marrë tjetër përbërje kimike për faj të Dane Gajtanit, por edhe të Xheladin Apollonisë, që fshinte me shami djersët dhe diçka murmuriste mes dy burrave të shtetit.

Papritur nga salsa kérkoi fjalën anëtarë me korrespondencë i Akademisë Sotir Kucka, i imët dhe me kokën pak të shtypur nga pas. Sallën e mbërtheu përsëri qetësia. Sotir Kucka ishte njeri i njobur edhe në qarqet shkencore, edhe në rrëthet intelektuale.

– Me leje! – tha ai me zë të hollë dhe ngriti dorën e ligur lart.

– Po ky ç'do? – tha Rita me përbuzje për të vëllanë.

– Fjalën e ka profesor Sotir Kucka! – njoftoi Xheladin Apollonia nga mikrofoni.

Sotir Kucka, i imët me këmbë të shkurtëra e pantallona të ngushta, u ngjit në tribunë dhe zgjati prej saj kokën me mikrofon para buzëve që i dridheshin.

– Unë, – tha ai, – ka dy-tri dekada që merrem me shkencat ekonomike, por një diskutim të ngarkuar me kaq shpifje kundër rendit socialist nuk kam dëgjuar. Madje këtë diskutim të Dane Gajtanit do ta quaja armiqësor. Por mua më vjen habi, mua dhe kolegëve të mi, se si e lejoi profesor Xheladin Apollonia të diskutonte këtë njeri të dyshimitë.

– Dale! Ku ia dinte profesori përbajtjen! – e ndërpren udhëheqësi me autoritet, duke shfaqur haptazi simpatinë për Xheladin Apolloninë.

Akademiku Xheladin Apollonia u zbeh dhe filloi të lëvizë supin, ndërsa Sotir Kucka në tribunë kruajti pak veshin.

– Këtë vesh ia tërroqa mbrëmë! – i tha Dane Gajtani Ritës.

– Mjaft! – e shtyu Rita.

Pasi e kruajti veshin, Sotir Kucka buzëqeshi dhëpërisht:

– I nderuari Xheladin Apollonia ia lexoi Dane Gajtanit diskutimin mbrëmë në studion e vet. Ata janë shokë fëminije.

Auditori me një gojë bëri «u-u-u». Dy udhëheqësit u vrenjtën, u bënë nervozë dhe u dukën sikur filluan mërinë me akademik Xheladin Apolloninë, krahun e tyre të djathë. Mërinë e tyre akademiku e ndjeu dhe donte të ngrihej, për një replikë, por udhëheqësit nuk e lanë. Ata kishin frikë se mos akademiku diskretitohej. Me çdo kusht ai duhej mbrojtur.

Sotir Kucka e la tribunën dhe shkoi të ulej me një kënaqësi të veçantë. Tanimë e kishte marrë hakun. Me fjalën e tij parimore ia lëkundi pozitën zyrtare Xheladin Apollonisë. Ky i pasbesë nuk do të bëhej kryetar i Akademisë! Këtej e tutje udhëheqja do të mendohet...

– I pacipi! – e shau e motra.

– Si të gjithë, – tha Dane Gajtani. – Shikoni ndonjë njeri me cipë këtu?

– Pusho! – tha Rita.

Ndërsa Neta atje në vendin e saj ngriti me nervozizëm sytjenat, u skuq deri në fund të qafës së gjatë dhe shau Sotir Kuckën:

- Spiun i keq!
- Kujt i thua spiun moj? – doli nga përtacia Adelina.
- Tët shoqi, atij kokështypurit! Turp të ketë që mundohet të ulë autoritetin e një akademiku të madh, që pi kafe me udhëheqjen.
- Mirë ia bëri! Po yt shoq që ia mori idenë e falur, – tha Adelina duke e mbrojtur Sotirin e saj.

Anifeja, heshtte pasi nuk donte ta prishte as me njérën, as me tjetrën. Ajo lavdëronte fatin që Zyrap Kandari i saj nuk ishte përzier në këto punë të liga.

Pas fjalës së shkurtër të profesor Sotir Kuckës u bë pu-shim. Xheladin Apollonia në mes të dy udhëheqësve kaloi me kokën lart nëpër korridorin e shtruar me tapet të kuq dhe u kthye në sallonin e madh me kolktukë të rëndë, ku pinin kafe njerëzit e zgjedhur të presidiumit, ministrat dhe personalitetet e shquara. Në sallon flitej me zë të ulët, por nën këtë zë përvë-lonte shpuza. Diskutimi i Dane Gajtanit ishte një shpuzë, që nuk do të ftohej aq lehtë në kuvendimet e njerëzve.

Akademiku Xheladin Apollonia u ul përballë dy udhëhe-qësve, që rrinin të fundosur e të zymtë në kolktukët e rëndë. Njëri prej tyre, shoku K, pinte duhan dhe vështronë hirin e zbardhur të cigares së shtrënguar mes dy gishtërinjve të hollë. Tjetri me ballin me lëkurë të piklosur me njollëza të kuqe, vinte herë pas here në buzë gotën e kristaltë me ujë mineral. Pastaj me thikë priste mollë të mëdha starkinga, që mbushnin pjatën në mes të tryezës. Mollët e mandarinat në këto lloj tryezash nuk mungojnë dhe qenia e tyre nuk varet nga muajt dhe stinët. Ato do t'i gjesh edhe në maj, edhe në qershor, edhe në korrik. Por me sa duket shoku Bejto Xhara i kishte qejf pa masë mollët, pasi i bënин mirë përfytin dhe veçanërisht përlëkurën, në mënyrë që t'ia ndalonin apo frenonin përhapjen e atyre piklave të kuqe, që kishin filluar t'i zbrisnin shkallë-

shkallë nga pjesa e sipërme e ballit deri mbi vetulla. Akademiku i vështronte mollët me përvuajtje, por ndruhej të zgjaste dorën dhe të priste ndonjëren prej tyre, pasi ishte në gjendjen e një të kritikuari dhe nuk e kishte syrin e hapur. Gjithë ai fjalim, që mahniti auditorin dhe udhëheqjen shkoi për dhjamë qeni vetëm nga një rastësi e papërfillshme, nga një lëvizje gjuhe e një të marri si Dane Gajtani. A, po! Në këtë zuskë botë përqindjen më të madhe e zënë rastësitë. Rastësi këtu, rastësi atje. Nëpër këmbë na mpleksen rastësitë! Ato bëhen shkas për tragjedi të papara. Shamia e Desdemonës ç'është? Rastësi është. Ra në dorë të Jagos kjo shami dhe u sajua një tragjedi e tërë në vdekjen e Desdemonës, gruas së dashur të arapit të madh. Po sa kasaphana politike dhe morale janë mbushur me gjak si rrjedhim i rastësive? Sa burra të shquar e sa dijetarë mendjendritur janë fshirë nga faqja e dheut ose janë hequr zvarrë tërë jetën nga shkaku i rastësive? Nga rastësitë janë ndezur edhe luftëra. Prandaj duke u menduar thellë për to, të pushton trishtimi dhe mund të kthehet nga ateist në deist, nga materialist në idealist. Kështu mendonte akademiku Xheladin Apollonia në çastin kur udhëheqësi Bejto Xhara priste mollën e madhe të kuqe. Dhe ishte e çuditshme. Udhëheqësi kurnac nuk e bëri veten t'i zgjaste një mollë dhe t'i thoshte «urdhëro». Fundja ai, akademiku stazhgjatë, sa për një mollë i kishte shërbyer këtij pushteti! E kuptueshme. Xheladin Apollonia e ndjente që nga molla se udhëheqësit ishin zemëruar me të. Akademiku, sipas tyre, nuk kishte ditur ta mbronte nga ndotja atmosferën e konferencës.

— Po! — tha shoku K. me sy në hirin e cigares.

Xheladin Apollonia uli kokën. E dinte se pas «po-së» do të vinin fjalët që nuk do ta dëshironte.

Shoku K. e thithi cigaren dhe e vuri në shpuzore.

— Po! — tha ai, — ju e dinit skandalin e Dane Gajtanit me tufëzimin e bagëtive...

Ai heshti për një çast dhe ia hodhi sytë Xheladin Apolloni-së në fillim në fytyrë pastaj në jakën e këmishës dhe në kë-pucët. Ky vështrim akademikun nuk e shpoi vetëm në fytyrë, por edhe në qafë dhe në këmbë.

– Duke e ditur këtë skandal, ju pa u menduar ia dhatë fjälën. E pafalshme, shoku Xheladin, e pafalshme! Nuk e di se ç'mendim ka shoku Bejto, por kjo është rrugaçëri ... – e vëشتroi shoku K. kolegut e tij udhëheqës Bejto Xharën me flokë të rëna dhe me njëren nofull pak të shtrembër.

– Veprim i pamatur! – tha Bejto Xhara duke prerë mollën.

– Po! Kishte të drejtë akademiku Sotir Kucka me ndërhyrjen e tij parimore! – tha shoku K.

Xheladin Apollonisë i erdhi rrrotull salloni, kur dëgjoi emrin e Sotir Kuckës. Atë po e lavdëronte udhëheqja. Mora fund, mendoi ai. Është e qartë. Sotir Kuckës po ia bën me dorë fati. Këtej e tutje ai do ta zërë vendin tim! Pastaj do të fillojë hakmarrjen e mbledhur si liqen artificial nga rrëketë e pakënaqësisë shumëvjeçare. Doemos rastësia për një palë sjell tragjedi dhe për palën tjetër fatbardhësi. Disa dobësohen, disa majmen. Kjo mumje, apo ky mish pastërmaje, ky Sotir Kucka, që s'i ka prirë kurrrë shëndeti, do të fillojë të majmet dhe do t'ia kalojë së shoqes së tij, trashaluqes Adelina. Mandjej do të fillojë të mos më përfillë as mua, – mendoi Xheladin Apollonia tërë pikëllim dhe smirë.

– Faji im, shoku K! Nuk e mendova. U tregova dritë-shkurtër... – tha akademik Xheladin Apollonia dhe iu drodh buza e poshtme.

Shoku K. psherëtiu dhe i perëndoi sytë në thellësi të sallonit deri në banakun e kafesë, ku qëndronin më këmbë njerëz me filxhanë në dorë.

– Nuk na vjen mirë të humbim për një pakujdesi të vogël një kuadër si ju, shoku Xheladin, – tha ai pas psherëtimës.

Akademikut i vetëtiu një dritë në shkretëtirën e gjoksit, si feneri i një beduini që ecën mes deveve nëpër rërën e Saharës. Nuk do të më sakrifikojnë, mendoi ai. Udhëheqja do të ma falë. Dhe në buzët e tij rroddhi një buzëqeshje llokumeje, e butë dhe e ëmbël. Nuk mund të më këmbejë udhëheqja mua me Sotir Kuckën.

Ndërkohë para banakut shoku K. vuri re Sotir Kuckën dhe Zyrap Kandarin. Të dy si binjakë vështronin me buzëqeshje të ngrira nga tryesa e udhëheqjes dhe prisnin të ftosheshin. Aka-

demiku Xheladin Apollonia ende nuk i kishte parë. Vetëm kur shoku K. u bëri me dorë të afroheshin, ai i vuri re dhe u ngrys i téri. E ndjeu se ftesa e shokut K. shprehte dashurinë për këto dhelpa dinake që kanë ngrënë aq pula në studion e tij.

Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari hoqën borsalinat dhe u përkulen deri në truall, duke ia dhënë dorën në fillim shokut K. pastaj shokut Bejto Xhara.

– Uluni, uluni! Na bëhet qejfi të pimë një kafe bashkë! – tha shoku K.

– Faleminderit! – thanë me një gojë dhe me një buzëqeshje të dy akademikët shëmbellyes.

– Na pëlqeu diskutimi juaj i prerë dhe parimor, – iu kthye shoku K. akademik Sotir Kuckës.

– Për momentin ishte tepër i domosdoshëm, – shtoi shoku Bejto me njérën nofull pak të shtrembër.

Sotir Kucka vuri duart e holla në gjunjë dhe filloi t'i fërkojë sikur të fshinte djersën e pëllëmbëve në pantallonat. E ndjente veten të lumtur që vetë shoku K., ia ngrinte lart fjalën e tij në konferencë kundër Dane Gajtanit dhe Xheladin Apollonisë.

– Ne, shoku K., ne, domethënë me profesor Apolloninë jemi miq të vjetër. Miqësinë, domethënë, e kemi forcuar, domethënë, duke mos ia fshehur njëri-tjetrit të vërtetën, domethënë... – bëlbëzoi Sotir Kucka duke fërkuar për gjunjët pëllëmbët e djersira.

“Ik mor pëllëmbëlëtyrë që të ndritin gjunjët e pantallonave nga djersa! E çfarë të vërtete më ke thënë ti mua! E çfarë gjenjeshtre më ke kundërshtuar, duke m'u lëpirë!” – mendoi Xheladin Apollonia me përbuzje.

– Ashtu duhet. Partia na mëson ta themi të vërtetën në sy, ta zhvillojmë luftën e klasave edhe me shoku-shokun. Në themel të miqësisë qëndron lufta e klasave. Lufta kundër mbeturinave të huaja në ndërgjegje është shprehje e luftës së klasave... – tha shoku K. dhe i pyeti nëse dëshëronin ndonjë kafe.

– Faleminderit, sapo e pimë... – gjenjeu me një zë dhe me një buzëqeshje të ngrirë Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari.

– Po atëhere merrni nga një mollë. Këto të shkreta tani në qershor ju nuk i gjeni dot në pazar... – tha udhëheqësi Bejto Xhara dhe u afroi pjatën.

Xheladin Apollonia u rrënqeth nga kjo paturpësi krejtësisht cinike. Është e pabesueshme! Ka njëzet minuta që rri në një tryezë me ta dhe s'më pyetën nëse dua një kafe, a një mollë. Kurse vijnë papritur dy shtatanikë, dy dësh takë shkençorë, Sotir Kucka dhe Zyrap Kandari dhe nuk dinë me se t'i gostisin: "A dëshëroni kafe, a dëshëroni mollë, a dëshëroni lajthi a kikirikë". Ja, një rast i tillë fare i imët, si një grimëz që mezi shihet në mikroskop, e kthen njeriun e ndershëm në kundërshtar të rendit dhe të udhëheqjes, duke e larguar nga idealet e shenjtë të tij.

Në çastin kur shoku K. e kishte mendjen nga akademikët, udhëheqësi Bejto Xhara u egërsua në fytyrë me vështrim tek banaku. Kishte vënë re Dane Gajtanin tek po pinte kafe me një vajzë të gjatë e të pashme. Përnjëherësh i ra me pëllëmbë tryezës dhe shfryu. Akademikët sa nuk u hodhën përpjetë. Madje Sotir Kuckës i shpëtoi thika nga molla dhe për pak sa preu grishtin. Dhe po ta priste do të ishte një turp i madh para udhëheqjes.

– I paturpshëm! – thirri pas shfryrjes shoku Bejto Xhara me kokë nga banaku.

Shoku K. bashkë me akademikët e vështruan me habi.

– Ç'ka ngjarë? – pyeti shoku K.

Shoku Bejto tregoi me kokë nga banaku. Të katër të tjerët kthyen fytyrat. Dane Gajtani pinte kafe! Me të edhe Rita. Sotir Kucka u zbeh. Të motrën e tij po e shikonte udhëheqja me një njeri tepër të padëshëruar. Po ç'bën kjo e çmendur, që po më fut tuberkulozin!

– Po ky sfidë na bën? – u vrenjt shoku K. me vështrim nga Dane Gajtani.

– Po ajo grua ç'është? – pyeti udhëheqësi Bejto Xhara.

Sotir Kucka u bë dhe. I hoqi pëllëmbët nga gjunjët dhe filloj t'i fërkojë me njëra-tjetër pasi cëmbithi mjekrën e vet. Xheladin Apollonia ndjeu një kënaqësi të paprovuar gati fizike.

– Hë, tani le të përgjigjet skilja Kuckë për të motrën e tij, për të paqëndrueshmen meduzë, që gjithmonë piret drejt të jashtëzakonshmes kontestuese dhe pastaj nga frika, për të mbrojtur lëkurën e saj të medustë, e braktis dhe joshet pas një figure tjetër. Pse s'e hap gojën skilja Kuckë dhe të thotë: “Eshtë motra ime?” Nuk e ka atë burrëri dhe as do ta ketë kurrë, mendoi Xheladin Apollonia. Hëm! Tani as mollët nuk i dua. Le t'i zihen në grykë Sotir Kuckës!

Dhe vërtet, Sotir Kucka, duke u gëlltitur u skuq i téri dhe filloj t'i lëvizte mollëza e fytit si qafa e gjelit të detit kur këndon tek i vërshëllen dikush. Edhe këtu për pak sa u turpërua para udhëheqjes, por më në fund e gëlltiti thelën e përtypur të mollës.

U bë një pauzë e gjatë. Askush nuk fliste. Zyrap Kandari ziente përbrenda. Mirë t'i bëhet Sotir Kuckës, që ia ka lëshuar frerin së motrës. Hë, jep përgjigje tani para udhëheqjes!

– Vërtet ç'është kjo femër? – pyeti shoku K.

Akademiku Xheladin Apollonia ngriti kokën dhe u mat të flasë, por e ndërpren Zyrap Kandari.

– Është e motra e profesor Sotirit. Është mjeke. Me sa vura re, Dane Gajtanit iu morën mendtë, ndoshta nga tensioni i ulët dhe po i jep ndonjë kafe. Gjithë atë burrë e pashë që gati sa s'u rrëzua në korridor. E, ç't'i bësh! – psherëtiu ai.

– Ashtu? – tha shoku Bejto.

“Këtij i them mik”, mendoi Sotir Kucka për Zyrap Kandarin dhe u lehtësua në shpirt. Hëm! Edhe këtu nuk i shkoi të pabesit Xheladin Apollonia. Sapo u bë gati të spiunonte, si akademik Lisenkoja i Rusisë, e zuri në grackë vëllai im dhe shkuar vëllait, Zyrap Kandari. Ah, ç'do ta kisha puthur, por ç't'i bëj se jam në mes të udhëheqjes, tha me vete Sotir Kucka. Ndërsa akademiku Xheladin Apollonia eurreu Zyrap Kandarin, këtë kopjues të artikujve të revistave marksiste, ekonomike, vulgare të kohës së Vasil Kolarovit. Ky langua i lindur kockë e lëkurë nuk mungon t'i dalë zot shëmbëlltyrës së tij Sotir Kuckës. E nxori, qenin nga vorbulla, që do ta kishte shpënë në fund të pellgut.

Në këtë kohë Dane Gajtani pinte kafe me Ritën i veçuar nga të tjerët. Prapa krahëve dëgjonte pëshpëritje me zë të ulët

por nuk i përfillte, pasi e dinte se këto janë të pashmangshme në ligjshmërinë e tyre. E ndiente se edhe në tryezën e udhëheqjes po këto rrëke thashethemesh kishin vërvshuar.

Ai e piu filxhanin dhe doli bashkë me Ritën, i përcjellë nga dhjetëra vështrime dhe nga era e këndshme e kafes. Ecte nëpër korridor, pa kthyer kokën, i gjatë dhe hundëlesh, me kapele të bardhë kashte dhe me xhaketë nën sqetull.

Në oborr, si në kafe, njerëzit pëshpërisnin me shoku shokun dy nga dy e tre nga tre, duke ecur e duke bërë me dorë. Nuk i afrohej njeri. Madje kurrikush nuk ia hidhte sytë drejt për së drejti, përveç se tërthorazi, kush me zemërim, kush me ironi dhe kush me buzëqeshje keqardhëse. Nuk e besonte që të ishte formuar një sjellje apo një moral kaq i tërësishtëm dhe kaq i plotë tek të gjithë njerëzit, nuk ishte e mundur që të gjithë të mendonin me një kokë të vetme. Pjesa më e madhe, mendoi ai, nga frika luante teatër, ironiku luan teatër, i gëzuari luan teatër, parimori luan teatër. Quo vadis!

Vetëm një gazetar e vështroi me buzëqeshje dhe ngriti lart duart e tij të shtrënguara në shenjë përgëzimi. Dane Gajtani tha me vete:

– S’është e mundur të mos ketë edhe të tjerë.

E shoqëronte vetëm Rita, edhe ajo e drojtur dhe e heshtur nën bredhin e gjatë me krahët që fshinin murin.

– Po ta kesh të vështirë, mos qëndro me mua! – i tha Dane Gajtani.

– I marrë! – qeshi Rita me zë.

– Nesër po të ndërrojë gjendja, yt vëlla, Sotiri, do të rrahë gjoksin: “unë kam luftuar kundër tiranisë së autoriteteve, unë kam qenë për...” Hëm! Dhe këtë pis do ta dëgjojnë dhe do ta quajnë përparimtar. Ai madje do të shkruajë edhe artikuj për çlirim e mendimit nga zinxhirët, – tha Dane Gajtani nën bredhin e kaltërt.

– Mjaft! – tha Rita, – gjendja nuk ndërron dhe s’ka përse të ndërrojë.

– Sa keq më vjen, – tha Dane Gajtani pa e vështruar.

– Për cilin? – pyeti Rita.

– Për ty!

Tek kuvendonin erdhi me vrap një vajzë nga të sekretarisë së konferencës për t'ia marrë Dane Gajtanit diskutimin.

– Mos ia jep, – i tha Rita ngadalë.

Ai e vështroi i vrenjtur.

– Unë në mbledhje nuk e lexova deri në fund. Për ata që e kërkojnë e kam shkruar, – dhe ia dha vajzës duke shtuar: – le ta kenë dokument për në hetuesi.

Vajza e sekretarisë ia hodhi sytë e bukur me habi dhe pastaj qeshi me leshin e tij të hundës.

Rita kafshoi buzën dhe e urdhëroi të heshtte, pasi dy të panjohur u qëndronin përherë pranë. Që në qëndrimin e tyre Dane Gajtani i kuptoi se ata ishin operativë të sigurimit. Ai e dinte se këtej e tutje do të kishte të bënte me këtë kategori njerëzish. Prandaj nuk dëshéronte që Rita të vinte pas tij. Ai e ndiente fundin e vet. Kur mendoi për këtë punë, i erdhi keq vetëm për të ëmën, që do të mbetej pa njeri. I ati i kishte vdekur nga kanceri në fyt, ndoshta ngaqë pinte shumë duhan. Pas vdekjes së tij eëma i lutej Danes të martohej, pasi donte edhe ajo të rriste nipër e mbesa, por ai i thoshte duke qeshur: “Marrim një fëmijë në befotrof dhe e rrisim”.

Dhe vërtet e kishte menduar të shkonte në ndonjë shtëpi fëmije dhe të zgjidhët një çun të bukur, që të merrej me atë e shkreta nënë. Por tani, kur i vuri re ata të dy që e ndiqnin iu shtua dëshira për ta vënë në jetë mendimin e tij për fëmijën. Patjetër do ta marr një fëmijë, mendoi ai. Nëna së shpejti nuk do të më ketë pranë. Ajo do të çmendet në vetmi. Fëmija do t'i sjellë gjëzim dhe unë do të kem një djalë që do të më presë kur të dal nga burgu.

Duke qëndruar nën bredh, ata shikonin si shëtisnin pjesë-marrësit e konferencës, si kuvendonin herë të qetë e herë të rrëmbyer. Me siguri gjithë kuvendimi i tyre vërtitej rrëth Dane Gajtanit dhe Xheladin Apollonisë. Njerëzit kishin filluar të interesoheshin për jetën e Danes, prej nga vinte e ku jetonte, ç'lidhje kishte me akademik Apolloninë dhe me Sotir Kuckën, ku e ka njojur Ritën dhe ç'raporte ka me të e të tjera. Pastaj disa kuriozë bënë sikur shëtisnin dhe vinin deri te bredhi për ta parë këtë hundëlesh që pati një guxim aq të çmendur sa që

nuk mori parasysh rrjedhimet: internimin, arrestimin, burgun... Dane Gajtani i ndiente vështrimet e tyre dhe i merrte me mend pëshpëritjet, fjalët, gjykimet... Në heshtje përsëri psherëtiu.

– U mërzite? – pyeti Rita tek ia dëgjoi psherëtimën e gjatë.

Asaj për një çast i erdhi keq për këtë njeri me guxim të marrë dhe mendime rebele, për këtë burrë të panënshtuar dhe hijerëndë.

– U dëshpërove? – pyeti Rita përsëri.

– Ah, jo! Po mendoj për diçka.

– Për çfarë? – pyeti ajo me kërshëri.

– Për ty është për të qeshur... – tha Dane Gajtani.

– Megjithatë...

– Mendoj të marr një fëmijë në befotrof dhe t'ia shpie nënës. Ajo së shpejti do të mbetet pa mua. Unë do t'i kem duart... – tha ai, dhe imitoi prangat.

– I marrë! – tha ajo aty për aty, por pastaj me të vërtetë u tremb edhe për Dane Gajtanin edhe për veten.

Në seancën e mëvonshme ai nuk mori pjesë; ishte i lodhur dhe shkoi të shtrihej në dhomën e hotelit. Ritës iu lut që të mos e përcillte.

– Më përcjellin këta, – bëri me kokë nga dy ndjekësit e panjohur.

Dane Gajtani u zgjua kur dielli ishte në të perënduar. Sikur të kishte ngrënë drekë, mund të ishte zgjuar edhe në mesnatë, por e ndjeu urinë edhe në gjumë, pasi filloj të shihte në èndërr tryeza të shtruara me gjellë të shishme. Hante e nuk ngopej, përtypej e s'gëlltitej. Nga kjo torturë urie hapi sytë dhe e pa veten të vetmuar në një dhomë të hotel «Pezës». Por ai në këto çaste mund të mos ndodhej në një dhomë të tillë fillikat **dhe me bark të zbrazët**. Mund të përgatitej për të shkuar në darkën që shtrohej për under të mbylljes së Konferencës **Kombëtare Shkencore**, ku do të kërcisin pirunjë dhe gotat, ku do të ngriheshin njëra pas tjetrës dollitë përmes fjalëve të zgjedhura të oratorëve dhe përmes buzëqeshjeve të

udhëheqësve. Do të shikonte në tryezën kryesore akademik Xheladin Apolloninë mes autoriteteteve të shquara të vendit me fytyrë të lumtur, me gotën e verës të ngritur me delikatesë pranë buzëve të tij nga kanë dalë qindra kumtesa, diskutime e fjalime, që kanë lënë pa mend mijëra njerëz. Do të dëgjonte pëshpëritjet dhe psherëtimat e grave për vajzën e profesor Xheladin Apollonisë që bëri operacion bajamet në Vjenë e që tanë çlodhet dhe argëtohet duke parë mrekullitë e kryeqytetit ku tingëllojnë valset e Shtrausit dhe ku fle Danubi blu.

– Ah, po, ka blerë gjëra të bukura?

– Sigurisht Vjena!

– Ç’ë diskuton!

Një fjalë rebele, një diskutim që prish harmoninë e këndshme shoqërore, një mendim që thyen përshtatshmérinë me jetën zyrtare, një ide jashtë rrjedhës së përditshme të gazetarëve mund të shprehet për një çerek ore, për njëzet minuta, madje edhe për një çast shumë të shkurtër. Në jetën e njeriut si sasi ky çast është i papërfillshëm. Por ndodh që dhjetë apo njëzet minuta mendimesh mund të shembin përnjëherësh dyzet apo shtatëdhjetë vjet të jetës së njeriut. Dane Gajtani ishte pesëdhjetëvjeç. Pesha e dhjetë minutave të diskutimit të tij ia shtypi të pesëdhjetë vjetët... Për ata që ishin në darkën zyrtare tanë të pesëdhjetë vjetët e tij dhe ai vetë nuk vlenin.

Me këto mendime ai u vesh dhe zbriti shkallët e hotelit, duke mos e harruar kapelen e kashtës. Në sallonin e vogël, nën shkallë, ai vuri re të dy ndjekësit, të ulur në kolltukët e vjetër me susta të dobësuara. Kur e panë, ata nuk lëvizën; vështruan vetëm me bisht të syrit. Ai mendoi se do të pëshpëritnin: “Ja, Hundëleshi!” por ata ishin të edukuar dhe nuk mund të përdorinnofka në vendet publike. Hëm, e dinë ata vendin, ku t’i përdorin këto nofka, mendoi Dane Gajtani, duke lënë çelësin në sportel.

Mendoi të hante darkë në rastorant «Donika» në bulevardin «Stalin». Edhe ky emër! Donikën e shkretë e kanë mbyllur në një mencë të quajtur restorant, kurse Stalinin e kanë nxjerrë në bulevardin më të madh të Tiranës! Nga ky emër ai u drodh.

Në restorant «Donika» priti në këmbë derisa u lirua një tryezë. Vinte një erë e tharët, një erë e përzier me atë të tymit të qofteve të shëmtuara, të gatuara me brumë, vezë e pak mish të ndenjur. Nga kjo erë ai zuri me dorë hundën e tij me lesh. Dy-tre të rinj për krah vunë buzën në gaz dhe pëshpëritën: "Ç'lesh paska në hundë!"

Përballë hante një djalë nga tridhjetëvjeçar pa xhaketë, me një këmishë ngjyrë qielli, me mëngë të shkurtra. Sa herë ngriante lugën e vështronë dhe, kur ndiente shikimin e Dane Gajtanit, i ulte sytë në pjatë. Dukej sikur e njihet, dukej sikur kishte dëshirë ta takonte, por druhej.

Në këtë çast erdhi kamarieri për të marrë porosinë. Nuk kishte se ç'gjellë të zgjidhte, vetëm qofte, tha kamarieri.

Dane Gajtani tundi kokën.

– Birrë?

– As që bëhet fjalë! – tha kamarieri.

– Raki?

– As era s'i ndihet! – tha kamarieri.

– Uzo?

– Më pëlqen këmbëngulja juaj. Kanë mbetur nga dy gota, po jua sjell, – qeshi kamarieri duke u larguar.

Djali që ishte ulur përballë, u ngrit dhe u drejtua në tryezën e Dane Gajtanit. Me t'u ngritur ai, tryezën ia zunë dy ndjekësit, që me sa dukej pritnin diku që të lirohej ndonjë vend.

– Më falni, – tha djali, – Unë jam një ekonomist. Më quajnë Roland. Ju dëgjova sot në mëngjes në konferencë. Mund të ulem?

Dane Gajtani vështroi të dy ndjekësit, që mbanin vesh në tryezën përballë. "Ç'të duhet more djalë", mendoi ai, por i bëri me kokë të ulej.

– Nuk paski shkuar në darkën zyrtare? – pyeti Dane Gajtani.

– Nuk kishim të gjithë ftesa, – tha djali. – Kjo s'ka rëndësi! Erdha t'ju them se diskutimi juaj më tronditi. I mrekullueshëm, mendime të vërteta, të shprehura me përgjegjësi qytetare. Lëre se ç'mendon presidiumi! Shumë njerëz në sallë me zemër ju duartrokitën. Fshehurazi duartrokitën. Në shpirt.

– Uleni zérin, – tha Dane Gajtani.

Për atë, fjalët e këtij djali të panjohur, të takuar rastësisht në «Donikën» e varfër, ishin një tufë drite në zbrazësinë e pa-fundme të kraharorit. Atij nuk i pëlqenin lajkat, pasi edhe nuk i kishte provuar; nuk i duheshin as fjalët vetëtitëse, lavdëruese në mbarim të punëve të zakonshme, por në këto çaste i nevojitej një ledhatim, një ilaç për plagën e hapur.

Kamarieri solli qoftet dhe dy gotat e uzos të premtuara. Dane Gajtani iu lut të porsanjohurit të merrte një gotë uzo, por ai nuk donte, pasi tanimë kishte ngrënë.

– Ky restorant është pasqyrë e atij ligji ekonomik themeltar, që lakon nëpër buzë akademiku Xheladin Apollonia... – qeshi hidhur djali, duke parë qoftet e shëmtuara në pjatën e Dane Gajtanit.

Dane Gajtani ia shkeli këmbën dhe i tha ngadalë të mos e ngrinte zérin.

– Mua më ndjekin! Në tryezën ku ishit ju, janë dy ndjekësit e mi.

Djali u mat të kthente kokën.

– Mos! – urdhëroi Dane Gajtani.

Djaloshi filloj të rrinte me zor, i vinte turp të largohej. Kishte frikë se Dane Gajtani dö ta quante lepur. Një tufë flokësh, si krahë rabecke, ia kishte zënë gjysmën e ballit të mbushur me bula të imta djerse. Kuptohej që donte të ngríhej e ta linte tryezën e përgjuar. Dane Gajtani e ndjeu këtë dhe buzë-qeshi me keqardhje, duke e vënë dorën e madhe në krahun e hollë të dashamirësit të tij:

– Ju falenderoj! Në këto raste edhe falenderimi im është i rrezikshëm... Do t'ju kujtoj.

– Eh! – bëri djaloshi dhe u largua, duke ia shtrënguar dorën.

Njëri nga ndjekësit u ngrit fill pas tij si ta thërriste njeri me urgjencë. Tjetri shtirej sikur lexonte listën e gjellëve me stilolaps të kuq në dorë. Dane Gajtani e shikonte herë pas here i përhumbur dhe pinte atë pak uzo që kishte mbetur në gotë. Më në fund ai mori kapelen e kashtës, e pagoi kamarierin në këmbë dhe doli. Tanimë dritat në bulevard ishin ndezur dhe nga mali i Dajtit vinte

një fllad i freskët. Tirana shquhet për netët e këndshme pa zاغushi, pasi ka një thesar të madh freskie, Dajtin e gjelbërt. Në vapën e korrikut e të gushtit e gjithë Tirana mund të ngjitet në Dajt dhe të fshihet mes degëve të aheve e pishave shekullore, mendoi Dane Gajtani si një fantazot naiv.

Nën llampat e bulevardit ai vuri re Rita Kuckën tek ecte vetëm me një çantë të madhe të varur në krah. Ajo ecte gati përballë tij dhe ndjeheshin trokitjet e takave të larta të sandaleve të saj. Por papritur ajo ndërroi rrugë dhe u hodh në anën tjetër të bulevardit. Dane Gajtani kujtoi studion e akademikut Xheladin Apollonia, kur rrinte ajo me bluzën e saj të bardhë, me vijën e hollë në mes të buzës së poshtme, me trupin e lëmuar si të delfinit dhe me krenarinë moderne e mospërfillëse, të spërkatur me pak esencë nihilizmi. Kujtoi kundërshtimet rebele të saj, që të jepnin përshtypjen se kishe të bëje me një vajzë me mendime të pavarura dhe të lira. Ai qeshi vakët si i sëmurë dhe ktheu kokën prapa, duke thënë me vete: ah, sa budallenj që jemi! Ah, sa të marrë! Ja, kjo Rita nesër do të ngrihet e do të thotë: “unë kam luftuar për mendimin e lirë”. Dhe ato që kanë lënë burrat e tyre të arrestuar e të burgosur, ato që janë ndarë me gjyq për t'i shpëtuar heqjes nga puna dhe internimit, do të thotë “ne i kemi dashur burrat tanë”.

Dane Gajtani e ndjeu se si e ndiqnin dy agjentët, e ndiqnin natyrshëm sikur shëtisnin si gjithë qytetarët e tjerë. “Hëm, tha ai me vete, këta do të më luajnë mendsh”.

E la bulevardin dhe koti së koti hyri në rrugicën që të nxjerr tek kinema «17 Nëntori». “Eh, «17 Nëntor», - mendoi ai, – dita e çlirimtë Tiranës. Im atë luftoi për çlirimin e saj. I biri ndiqet në këto rrugë, ku eci i ati me pushkë!”

Vjedhurazi vështroi nga pas. Përsëri e ndiqnin. Atëhere ai u kthye prapë në bulevard, doemos i ndjekur nga ata të dy... Bulevardi tani iu duk me përmasa akoma më të mëdha se pak më parë. Ishin rralluar dritat dhe objektet dhe sendet kishin humbur format e tyre. Dane Gajtani u nis nga ana e stacionit të trenit pa vetëdije. Vinte treni i fundit. Mbase shfaqej ndonjë i njojur, që nuk e kishte marrë vesh historinë e tij të fundit. Të bridhët me të dhe të derdhët një lumë fjalësh, lumë që

ende nuk i kishte shteruar. Po, po! Ky lumë së shpejti do të shterohet... Ai do të thahet dhe qenia ime do të shndërrohet në shkretëtirë, në Gob, në Saharë, në Karakum... – mendoi ai si në ethe.

Mandej u kthye dhe e la stacionin e trenit prapa shpinës. Ndjeu se i lëshonin këmbët xixa dhe gjunjët i priteshin. Nuk ishte kjo maratonë e pavetëdijshme për moshën e tij. Sido-qoftë ishte 50-vjeçar, beqar i moshuar, mund të themi. Ah sa e gjatë do të ishte kjo natë! Natë vetmie...

Kësaj nate do të donte të ishte buzë lumi me shelgje të fshatit, ku kuaknin bretkosat dhe ku këndonte gjoni i padukshëm. Pastaj të zhvishej e të hidhej në pellgun më të thellë të lumit si në fëmijérinë e rininë e tij të hershme. Në këtë lumë ishte larë edhe Xheladin Apollonia, kur nuk kishte menduar për asnjë shkencë.

I pihej një kafe, i duhej një mik... E parandiente se e ardhmja e tij do të ishte pa kafe dhe pa miq. Dhe i erdhi për të qarë. O perëndi! – psherëtiu ai dhe u nis për në hotel.

Në hotel sportelisti bashkë me çelësin i dha një zarf të vogël. Kur u ngjit në dhomë, e hapi zarin dhe gjeti një pusullë të shkruar. E kërkonin në ministrinë e bujqësisë, në drejtorinë e kuadrit, të nesërmen në orën tetë të mëngjesit. Nga kjo thirrje Dane Gajtani e mori me mend se puna e tij do të shkonte deri në fund me shpejtësi të madhe. Por ai nuk u çudit, pasi e priste. Në mos sot, nesër kjo do të ndodhëte.

Ra të flerë herët dhe të nesërmen shkoi drejt e në drejtorinë e kuadrit në Ministri. Siç e parandiente, drejtori i kuadrit, Selam Dervishi, që e njihte prej kohësh, dhe që e kishte përshtëndetur në konferencë, nuk i dha as dorën dhe nuk e ftoi as të ulej. E vështroi egër nën vetulla, gërmoi nëpër dosjet e trasha dhe nëpër sirtaret, nxori një fletë të vogël letre me disa shënimë të shkruara me stilolaps dhe duke u kollitur i tha thatë dhe telegrafisht:

– Për qëndrimin tuaj armiqësor ju jeni pushuar nga puna. Vendimi do t’ju vijë nga Komiteti Ekzekutiv i rrethit. Armiq si ju nuk mund të janë kuadro të bujqësisë sonë socialiste. Ju me qëllim keni vepruar për të ulur rendimentin e qumështit ku

punoni dhe me këtë keni ngjallur pakënaqësi në familjet fshatare. Nuk është vetëm problemi i pikëpamjeve të mbrapshta, që shfaqët në konferencë. Pikëpamjet njeriu ka të drejtë t'i shfaqë, por shfaqja e tyre tek ju është rrjedhim i një veprimtari të tërë armiqësore. Duke marrë çështjen në kompleks, ju dilni si një armik tipik i rendit socialist...

Dane Gajtani nuk ia ndante sytë fytyrës së verdhë të drejtorit të kuadrit tek lexonte shënimet e parapërgatitura në fletën që kishte përpara. Përmes leximit ai e ndjente se dikush nga shkalla e nomenklaturës ia kishte diktuar këto shënime për t'i transmetuar pikë për pikë. O moral i prishur! mendoi ai dhe pyeti:

– Të shkoj?

Drejtori i kuadrit ngriti sytë pa e vështruar.

– Ju do të prisni në Tiranë edhe tri-katër ditë, pasi mund të na duheni për sqarime të mëtejshme...

Dhe Dane Gajtani e kuptoi se mund edhe të mos kthehej në fshat tek e ëma...

Ai qëndroi edhe tri-katër ditë në Tiranë, siç ishte urdhëruar nga drejtori i drejtorisë së kuadrit. Nga ankthi do të ishte çmendur, sikur të mos ishte marrë me një punë të jashtë-zakonshme, që nuk mund ta përfytyronte njeri. Kishte vendsur të merrte një fëmijë nga befotrofi, një djalië tre-katër vjeçar. Kishte shkuar edhe në shtëpinë e fëmijës, kishte takuar drejtoreshën, kishte zgjedhur djalin më të bukur dhe më të zgjuar dhe kishte filluar të merrej me formalitetet e birësimit, duke hyrë e duke dalë zyrë më zyrë.

Në fillim nëpër zyra e quajtën të çmendur, pasi nuk kishte ndodhur që një burrë i pamartuar të birësonte një fëmijë kopil. Fëmijët jashtëmartese gjithmonë i marrin ata që kanë fatkeqësinë të mos lindin. Kurse ky as ka provuar të martohet, as ka provuar të bëjë fëmijë...

Edhe nëpunësja e gjendjes civile kujtoi se ky hundëlesh po tallej me disa gjëra që nuk bëhet shaka.

– Ç'të duhet fëmija, – i kishte thënë.

– Më duhet të më presë pas një mungese shumë të gjatë që e kam parashikuar!

– E çuditshme! Por ti martohu të kesh fëmijë, atëhere do të të presë edhe gruaja edhe fëmija...

– Nuk e kam lehtë të martohem. Unë, siç e shihni, hundën e kam me lesh dhe gratë më largohen... – e kishte kthyer ai me shaka dhe pas një kuvendimi të gjatë i kishte dhënë emrin e fëmijës që pati zgjedhur në befotrof.

Me shkresa në xhep ai shkoi në shtëpinë e fëmijës dhe e mori në krahë Gjonin e vogël trevjeçar. Gjoni menjëherë u tulit në gjoksin e tij të madh dhe Dane Gajtani ia vuri në flokët e buta faqen e ashpër.

– Unë jam Dane Gajtani, yt atë. Që sot e tutje ti je Gjon Gajtani. Do të kesh edhe një gjyshe që di shumë përralla të vërteta e të trilluara. Gjyshen e quajnë Behije... – i fliste Dane Gajtani fëmijës, duke u çapitur në trotuar mes njerëzve të panjohur.

Tek çapitej hodhi vështrimin që prapa kurrizit të Gjonit të vogël. Pas tij vinin dy ndjekësit. Dane Gajtani ia fërkoi fëmijës flokët e butë me faqen e tij si furçë.

– Babi! – tha fëmija.

– Bir i babit!

– Ujë, – tha fëmija.

– U, dhe mua ujë më pihet, do të pijmë në hotel, – i tha Dane Gajtani.

– C'është hoteli? – pyeti fëmija.

– Shtëpi e madhe, – shpjegoi Dane Gajtani.

– Kaq e madhe? – pyeti fëmija dhe hapi krahët në gjoksin e Dane Gajtanit për të treguar përmasat e shtëpisë.

Dane Gajtani ktheu përsëri kokën pas. Në çast i rrahu zemra.

Dy ndjekësit ishin zhdukur. Mbështetova prej tyre, mendoi ai me fëmijën në gjoks.

– Ujë! – tha fëmija.

– Ja, arritëm, – tha Dane Gajtani dhe për ta qetësuar i këndoi një këngë të sajuar:

*Të mora të rritesht i gjallë,  
Në prag të më presësh gazmor,  
Tani në qershori të them fjalë,  
Po kënga të vjen në shtator.*

*S'ta them në shtatorin e ardhshëm,  
Pas shumë shiatoresh ta them,  
Më presin zinxhirët e ashpër,  
Dhe erë e qelisë si helm...*

*Po helmi në gjak s'më bijn mua,  
Se ti do më presësh në oborr,  
Atje ku na piqet një ftua,  
Një ftua që zverdhët në shtator.*

*Nën ftua do pimë pak ujë,  
Ti burrë atëhere do jesh,  
Do thuash i qetë e pa bujë:  
“Ç'u bëre, o Dan, bundëlesh?”*

*Na pret të dy at e djale,  
Një shteg aq i hidhur gjembor,  
Tani në qershori të them fjalë,  
Po kënga të vjen në shtator...*

Djali i tulitur në gjoksin e Dane Gajtanit, lutej që kënga të përsëritez gjithë rrugës dhe i ati i bindej, duke kënduar ngadalë herë një strofë, e herë një tjetër, madje edhe duke sajuar të reja. Para hotel «Pezës» kishte ndaluar një gaz kinez me ngjyrë të zezë pa dritare. Pranë «Gazit» qëndronin dy njerëz. Ishin dy ndjekësit. Dane Gajtanit për pak sa i shpëtoi Gjoni nga gjoksi.

– O perëndi! – tha ai me zë të lartë. – Prandaj më udhëzuan në ministri që të mos largohesha! O ç'mekanizëm i madh! Oh, ç'persosmëri!

– Ç'ke, babi?

– Rri bir, rri! – tha Dane Gajtani me faqe në flokët e tij të buta dhe të ngrohta.

Për çudinë e Dane Gajtanit të dy ndjekësat e lanë gazin kinez dhe u futën në hotel «Peza». Në çast u dukën sikur me Dane Gajtanin asgjë nuk i lidhte. Atëhere ai u kthyte pas me djalin në krahë, duke ecur kot së koti pa ditur se ku do të shkonte dhe ku do të ndalej. Në ecje e sipër i feksi në vetëdije një pikë e vogël në fillim sa një majë lapsi, pastaj sa kopsa e këmishës së tij dhe më vonë sa dielli, që e kishte mbi kokën e mbuluar me kapelen prej kashte. Fëmijën tani për tani nuk duhej ta merrte me vete. Dhe, në përgjithësi, gaboi rëndë, që pas asaj fjalë të mbajtur në konferencë, kur dihej se ku do të përfundonte, kur vuri re edhe gjurmuesit, shkoi si një budalla i vërtetë në shtëpinë e fëmijës për të marrë Gjonin e shkretë. Një marrëzi e plotë! Zaten ai marrëzira ka bërë gjithmonë. Kishte të drejtë Rita, kur i kishte thënë njëherë, se ai ishte një kalorës lakuriq, që udhëtonte nëpër botë krejt i zhveshur për të gjetur të vërtetën, që i shprehte të gjitha gjërat që mendonte, pa marrë parasysh rrjedhimet. Hëm! Rita! Po sikur të shkonte dhe t'ia linte asaj fëmijën sa të merrej vesh sesi do të vinte puna e tij këto ditë që do të qëndronte në Tiranë? Gjë që s'bëhet! Rita nuk do të kishte guxim thjesht ta takonte Dane Gajtanin, jo pastaj t'i mbante edhe një fëmijë kopil. Ah, guxi-mi është diçka tjetër; ai nuk lind dhe nuk rritet në ato folera, ku ka lindur dhe është rritur Rita! Atij iu kujtua mbrëmja pas konferencës, kur u gjend ballë për ballë me Ritën në bulevard dhe kur ajo ndërroi rrugën për të mos e takuar. Mbase kishte të drejtë. Përse ta pësosh për një takim të çastit, kur nga kjo gjë nuk mund të sjellësh asnjë dobi? Me një takim të tillë a mund ta ndihmosh fatkeqin? Nuk bën asgjë tjetër veçse shton fatkeqët: nga një i shton në dy! Ka ndodhur që një mik ka

takuar shokun e vet të survejuar dhe pastaj ose e kanë thirrur në Sigurim, ose kanë filluar të dyshojnë edhe për atë dhe kanë nisur ta përgjojnë dhe ta ndjekin. Prandaj ne bëhem i zemërgushtë kur zemërohem me miqtë tanë që kanë frikë të na takojnë pas fatkeqësish të tilla. Rita vërtet kishte mendime librale, por ato ishin pa ndonjë rrezikshmëri shoqërore, siç i thonë fjalës. Mendime si të Ritës kanë shpesh edhe fëmijët e anëtarëve të Byrosë Politike dhe të ministrave për t'u treguar modernë dhe me ide progresiste, duke u shtirë sikur qëndrojnë dy pashë mbi të tjerët që nuk e njohin Evropën! Madje ata vishen sipas modës së fundit perëndimore, dansojnë në mënyrë ekstravagande, pijnë whisky, Dry Gin, Campari e me radhë; shëtisin dhe ulen në kafe me poetë dhe artistë të shquar, duke treguar disa anekdota dhe historira sallonesh nga jeta mondane. Nejse, kjo është puna e tyre. Po çfarë të bënte Dane Gajtani me kopilin e nxjerrë nga Shtëpia e Fëmijës? Ku ta shpinte se? Mendoi se mund të gjente ndonjë bashkëfshatarin e tij në stacionin e trenit për ta nisur fëmijën nga andej në fshat tek eëma. Sigurisht, kjo do të ishte një rastësi, pasi bashkëfshatarët e tij udhëtonin shumë rrallë për në Tiranë. Doe mos ai mund të nisej edhe vetë për në fshat, që tani, madje në çast. Çështja ishte se kush e siguronte se nuk e arrestonin që në tren me fëmijë në krahë! Vërtet i ziente koka dhe ajo pika e vogël e feksur në fillim në ndërgjegje, pasi u zmadhua dhe u bë sa dielli, tani u shumëzua si bletët në hoje, që mund t'i quajmë pika lëvizëse plot gumëzhimë. Njëra nga këto pika lëvizëse, si një mizë blete, erdhi dhe e thumboi në vetëdijen gumëzhuese: Sikur të shkonte drejt dhe tek profesor akademik Xheladin Apollonia dhe t'ia linte fëmijën Netës, gruas së shokut të tij të fëmijërisë? E çfarë do t'i bëjnë akademikut? Asgjë! Hëm! Asgjë, thotë Dane Gajtani, por çfarë thotë akademik Xheladin Apollonia se? Le që të shkonte Dane Gajtani tek akademiku pas gjithë asaj zallamahie që ngriti në konferencë, do të ishte një cinizëm bërtitës. Atëhere do të quhej vërtet një kalorës lakuriq! Megjithatë, ai e mori përsipër të gjitha: përuljen, turpin dhe cinizmin. U nis drejt e në shtëpinë e profesorit dhe akademikut Xheladin Apollonia, duke ha-

rruar pér disa çaste fémijën që mbante në krahë; u nis siç nisej para se tē mbahej konferenca shkencore.

– Më pihet ujë! Ku është hoteli? – thirri fémija dhe Dane Gajtani u zgjua nga gumëzhitja e mendimeve, dyshimeve dhe vendosmërisë.

– Ja, tani do tē pimë ujë në shtëpinë e një mikut tim, – i tha ai fémijës sikur tē ishte i madh.

Para se tē arrinte në shtëpinë e Xheladin Apollonisë, ai u ndal në një kafe me vetëshërbim dhe i dha djalit një aranxhatë tē freskët. Djali pas aranxhatës kërkoi ujë dhe Dane Gajtani qeshi.

– Do tē vijë një kohë që ujin ta pish, kur tē tē dalë rakia.

Tani djalin e mori pér dore dhe i tregoi me kokë apartamentin e akademik Xheladin Apollonisë dhe i tha se atje mund tē rrinte disa ditë apo disa javë gjersa tē vinte gjyshja pér ta marrë në fshat, pasi babi Dane do tē nisej pér një udhëtim, i cili mbase do tē ishte i gjatë. Përsëri ai i fliste fémijës si një tē madhi dhe i vogli heshtte sikur t'i kuptonte tē gjitha gjërat që tregonte Dane Gajtani.

Shkallët që tē shpinin në apartamentin e akademik Xheladin Apollonisë ishin në hije dhe bënte freskët. Para shkallëve ai me tē voglin u ndalën dhe qëndruan pér disa minuta në këmbë. Dane Gajtani u lëkund. Të ngjitej, apo tē mos ngjitej? Më në fund psherëtiu thellë, vështroi pérreth nëse e ndiqte ndokush dhe u ul në shkallën e parë, duke e marrë fémijën në prehër. Dëgjonte vetëm frymëmarrjen e vet dhe tē tē voglit mes asaj guve tē freskët betoni. Jam si një ujk me këlyshin e vet, mendoi ai. Një ujk i ndjekur nga gjahtarët. Dhe e vuri mjekrën e tij në kokën me flokë tē butë tē fémijës, duke ndjerë një erë tē çuditshme si tē qumëshitit dhe tē barit bashkë.

– Jam një ujk me këlyshin e tij! – thirri ai papritur.

Djali e ngriti kokën lart dhe Dane Gajtanit i kërcitën dhëmbët gati sa t'ia kafshonin gjuhën.

– Edhe dhëmbët më kërcasin si tē ujkut! – thirri ai përsëri.

– Babi, sa ujq ka këtu? – pyeti fémija.

– Unë jam ujk! – tha Dane Gajtani dhe hapi gojën, duke treguar dhëmbët.

I vogli qeshi.

– Ti gënjen, nuk je ujk! Ujku është me lesh!

Edhe Dane Gajtani qeshi dhe vuri dorën mbi hundën e tij.

– Edhe unë kam lesh. E shikon? – dhe ia tregoi hundën.

Fëmija ia vuri dorën në hundë dhe duke zbuluar dhëmbët e tij të vegjël e të bardhë si fasulet e kopshtit të Dane Gajtanit, apo si guriçkat e zallit të lumit nën dritën e hënës, tha:

– Ti ke pak lesh. Ujku ka shumë. Po mua do të më dalë lesh në hundë, kur të rritem?

– E ç'ë do leshin në hundë? Leshi në hundë nuk është gjë!

– tha Dane Gajtani i menduar sikur të kishte ndonjë rëndësi të veçantë leshi në hundët e njerëzve.

Tek rrinte në shkallë, Dane Gajtanit i vanë sytë në librarinë «Flora», ku shiteshin librat marksiste dhe politike. Libraria ishte përballë apartamentit të profesor akademik Xheladin Apollonisë. Atje rrallë hynin e delnin njerëz, përveç ndonjë instruktori nga komitetet e partisë, ose ndonjë turisti kurioz, që donte të dinte se me çfarë marksizmi po merreshin shqiptarët e çuditshëm. Me një vështrim të përhumbur Dane Gajtani dalloi, si mes mjegullit, profesor Sotir Kuckën. Iu duk sikur atë e mbështillte një mjegull i hirtë dhe këmbët nuk i kishte në tokë, por në një si vello të murrme, duke ecur si personazhet e një filmi me xhirim të ngadaltë.

Personazhet e komedisë sime! – mendoi Dane Gajtani me zë.

– Ç'është peçonaçi? – pyeti fëmija, duke e zgjuar Dane Gajtanin nga përhumbja.

– E shikon atë xhaxhin atje? Ai është «peçonaç» dhe atë e kam zënë për veshi, – tha Dane Gajtani, duke treguar Sotir Kuckën e hollë si kallam.

Profesor Sotir Kucka hyri në librari dhe pas pak doli me një libër me format të madh si të një albumi. Ai vështroi sakaq në shkallë dhe i hodhi një sy shkallëve nga zgjatej hija. Pastaj vuri pëllëmbën e dorës para ballit si një strehë kapele, u përkul si një gjahtar dhe e përqëndroi vështrimin tek Dane

Gajtani. Pas disa sekondave e drejtoi trupin dhe i ngriti sytë në dritaren e apartamentit të Xheladin Apollonisë. Bëri një dy-tri herë he-he me zërin e tij të hollë dhe e tundi në erë librin me format albumi në drejtim të dritares së apartamentit të akademikut: – Mbarove, or Xheladin Apollonia, mbarove! Ja, ky libër do të t'i thyejë hundët, që i fshin me shaminë e mëndafshëtë të Netës! He-he! – thirri ai pothuajse pa kuptim dhe ktheu vështrimin përsëri nga Dane Gajtani, duke i treguar atij grushtin e voçkël me gishtin në mes. Qeshi me të madhe, hoqi nga koka e voçkël kapelën, u përkul në shenjë nderimi nga Dane Gajtani dhe u largua me hapa të shkurtra dhe të shpejta.

I marri! tha Dane Gajtani dhe u kujtua për diçka. Profesor Sotir Kucka kishte hapur fjalë mes shokëve të tij se priste librin e vet t'i delte nga shtypi, libër që do ta trondiste elitën shkencore nga shtrimi dhe zgjidhja e mjaft çështjeve të një kilibri të madh. Me sa dukej ai albumi që mbante në dorë dhe që ia tundi në erë hijes së Xheladin Apollonisë, do të ishte kjo veprë e mezipritur.

I marri! përsëriti me vete Dane Gajtani dhe qeshi, se kujtoi atë ditë kur e zuri për veshi profesor Sotir Kuckën para akademik Xheladin Apollonisë, profesor Zyrap Kandarit, Ritës dhe grave të shkencëtarëve. Ajo ditë tanë Dane Gajtanit i dukej e largët deri në pafundësi. Nuk përsëritet më! Do të përsëritej sikur mos kishte folur në atë konferencën e mallkuar, e cila caktoi edhe drejtimin e fatit të tij. Sikur mos kish-te qenë ajo konferencë, ai do të vinte shpesh në shtëpinë e Xheladin Apollonisë dhe do të zbavitej me shkencëtarët, veçanërisht me këtë Sotir Kuckën, që ia pëlqente edhe mbiemrin! Kucka-Kucka-Kucka! – bëri ai papritur dhe vuri re se me shqiptimin e këtij mbiemri gjuha ia prekte shpesh dhëmbët e mëdhenj. Ah, po! Edhe Rita mbante këtë mbiemër: Kucka! Por bashkë me emrin e Ritës, mbiemri Kucka shqiptohet më butë! Po të ndodhë që të martohej me Ritën, ajo do ta kthente mbiemrin nga Kucka në Gajtani. Ha-ha! Do t'i vinte emrit të saj një gjatë. Gjë që nuk bëhet! Ky gjatë nuk besoj t'i vihet ndonjë gruaje, mendoi

Dane Gajtani. Megjithatë në largësi atij i shkonin mendtë tek Rita. Dhe ai këndoi vargjet e një vjershe të thurrur aty për aty në shkallën me hije:

*Kur ikja larg, drejt teje vija,  
kur vija afër, ikja shpejt.  
Për dreq, më trempte largësia  
Dhe afërsia aq për dreq.*

*As e kuptoja si të desha,  
Një mjegull pus, një turbulli,  
Si një poet që shkruan vjersha  
Dhe ç'del nga vjershat, nuk e di.*

*Dhe ndoshta kjo ish dashuria  
Në shpirtin tim, në sytë e tu:  
Për dreq, na trempte largësia  
Dhe afërsia gjithashtu.*

– Po kjo nuk është një këngë për Rita Kuckën! – tha Dane Gajtani me zë, sikur kuvendonte me ndonjë të dytë.

– Për kë është? – pyeti fëmija, duke kujtar se Dane Gajtani fliste me të.

Ai ia vuri donë në flokët dhe duke ia shpupurit, pasi e puthi, iu përgjegj:

– Kjo këngë është për një grua abstrakte, që nuk jeton as në apartament, as nën shkallë; as në rrugë, por vrapon atje lart mbi retë, shkel në retë si në një qilim të madh dhe ngjet pa e ditur se ku do të arrijë dhe se në çfarë krevati do të flerë. Është një grua që duket, por që nuk preket me dorë. Sa të zgjatësh dorën dhe ta prekësh, ajo të kalon si uji i burimit nëpër gishtërinj dhe ikën tatëpjetë. Veçse është shumë e bukur!... – thoshte Dane Gajtani, duke harruar se ai që e dëgjonte ishte një fëmijë.

Më e çuditshmja është se ky burrë 50-vjeçar, që kishte një logjikë të thatë dhe të rreptë, që dinte të ironizonte, të tallte, të përqeshte dhe të bëhej një cinik i madh dhe i padëgjuar,

ndonjëherë kthehej në një fëmijë naiv apo në një budalla, që mund ta vinin në lojë të gjithë. Atij i kërcente shpesh damari apo delti i një poeti të lajthitur, që nuk mund t'ia ndalonte askush shpërthimet e marrëzisë. Në këto shpërthime ai i këndoi një herë Ritës një këngë, që ajo u tmerrua, pasi një gjë të tillë nuk kishte njeri që ta bënte, përveç se një të prishuri nga mendtë:

*Vërtitet një re e zezë mbi botë,  
E zezë si unë;  
Leh natën një qen i tërbuar nën portë,  
Leh natën si unë.*

*Zvarritet një gjarpër nga tokë e vithisur,  
Një gjarpër si unë;  
Kalojnë në shtigje plot njerëz të krisur  
Të krisur si unë.*

*Lëkunden në qoshet e rrugëve kurvat,  
Dhe kurvat si unë;  
Bërtasin lypsarët shëmtuar nga gungat,  
Shëmtuar si unë.*

*Kércejnë majmunët në pyjet dhe xhunglat,  
Majmunçe dhe unë;  
Jeton botë e çmendur me vallet dhe plumbat,  
E çmendur si unë.*

*Tmerrohet njeriu, kur lind mbinjeriu,  
Tmerrohem dhe unë;  
Kur vdes mbinjeriu, merr zemër fatziu,  
Marr zemër dhe unë...*

—Mjaft, — kishte thirrë Rita, — se më çmende! Ç'janë këto marrëzi! — dhe kishte zënë veshët me duar.

Dane Gajtani pastaj ishte tallur me liberalizmat pseudopër-parimtare të Rita Kuckës, kishte zënë me dorë leshin e hundës

dhe ishte larguar prej saj, duke shpërthyer në një varg fjalësh, varg që është vështirë ta shkruash në këtë lloj letre që përdomrim ne shqiptarët...

Ai qëndroi gjatë në shkallë, duke mos vendosur për t'u ngjitur tek akademik Xheladin Apollonia. Fëmijës i erdhi për të bërë çiçin dhe ai u ngrit, duke e shpënë të voglin prapa shkallës. Ndërkohë nga pas ndjeu hapa të rëndë dhe të ngadalë. Ishte akademik Xheladin Apollonia që kthehej në shtëpia. Akademiku u kollit. Dane Gajtani e kuptoi që kjo kollë ishte artificiale, enkas. Po të mos donte të më takonte, mendoi ai, nuk do të kollitej; do të ngjitte shkallëtinëz dhe mua do të më linte këtu. Dhe atij padashur diçka i kaloi nëpër trup, si një hithër e padukshme. Ktheu kokën dhe u gjend ballë për ballë me Xheladin Apolloninë. Të dy vështronin njëri-tjetrin dhe heshtnin. Fëmija qëndronte fshehur prapa pantallonave të Dane Gajtanit, duke nxjerrë pakëz kokën drejt akademikut. Pastaj ai thirri gati më të qarë:

– O xhaxhi, mos e rrih babin!

Akademik Xheladin Apollonia vuri buzën në gaz:

– Jo, or shpirt! Ku rrighet gjithë ky babi! Ai më rreh mua! – dhe ai iu afrua të voglit, e kapi përnofulle ngadalë, duke ia ngritur kokën për t'ia parë sytë.

Dukej sikur të gjitha këto nuk kishin të bënин me Dane Gajtanin, por me një fëmijë të njobur prej kohësh. “Kjo është një hyrje për të kaluar në lëmin e marrëdhënieve të reja që janë krijuar mes nesh, një hyrje si këto shkallët. Shkalla e parë është fëmija, shkalla e dytë jam unë”, mendoi Dane Gajtani, duke arsyetuar për çudi edhe si një burokrat, edhe si një poet me metafora. Por ai i trembej këtij Xheladin Apollonisë. Ky njeri nuk dihet se çfarë kthesa merr!

Xheladin Apollonia ia hodhi krahun Dane Gajtanit në sup. Dane Gajtani mori frymë me gjithë mushkëritë dhe u zbut. Pastaj Xheladin Apollonia e zbriti krahun ngadalë nga shpatullat e Dane Gajtanit dhe lehtë-lehtë ia ndali dorën në të çarën e xhaketës, duke e shpuar nga pas me gishtin tregues.

Dane Gajtani u hodh përpjetë, se vërtet i dhëmbi, por nuk u zemërua. Këtë gjë ai ia kishte bërë më parë akademikut...

– Ngjitemi lart. Ti ke uri, fëmija dhe unë gjithashtu, – tha Xheladin Apollonia dhe filloj të ngjitej në shkallët e betonta.

Në apartament ishte vetëm Neta, për çudi e pakrehur dhe e palyer, gjë që rrallë mund të ndodhë, të paktën në sytë e Dane Gajtanit. Ajo i hodhi një vështrim të zyntë Dane Gajtanit, vështrim si të rridhte nga një armiqësi e vjetër, që mbart kujtime tepër të hidhura. Dane Gajtani këtë e kuptoi dhe uroi fatin që nuk i ngjiti shkallët para se të vinte Xheladin Apollonia. Kjo shtrigë me siguri do ta kishte nxjerrë përjashta derës sa të kishte bërë hapin e parë. Në sytë e Xheladin Apollonisë tanë ajo nuk mund të bëjë asgjë.

– E gjeta nën shkallë! – i tha Xheladin Apollonia të shoqes, duke bërë me kokën nga Dane Gajtani.

Neta diçka mërmëriti nën hundë, diçka të pakuptueshme, por të hidhur. Ajo i la ata dhe u fut në dhomën e saj.

– Gratë e pakrehura janë të tmerrshme! – tha Xheladin Apollonia dhe u ul në kolltuk, duke e udhëruar edhe Danen të trinte çlirshëm bashkë me fëmijën e tij.

Unë, si të të... – filloj Dane Gajtani, ndërsa Xheladin Apollonia e ndërpree.

– Lëre! E dreqose! Ti kujton se unë nuk i di ato që fole ti? – dhe Xheladin Apollonia u ngrit në këmbë me gishta në jek nën të dy sjetullat si Lenini. – Ë, nuk i di? I di që ç'ke me të, e di që punën tonë e mori lumi, por ky lumë nuk tregohet, siç e tregove ti... Dhe e ke pisk... E kupton sa pisk e ke? Edhe unë e kam pisk... Ti më dreq se unë... Ti i the...

– Dikush duhet t'i thotë, – tha Dane Gajtani dhe e vuri të voglin në kolltukun pranë, duke hequr kapelen e kashtës.

– Hë! Do ta vësh në gjunjë si gjithnjë... – tha Xheladin Apollonia për kapelen.

Andej nga kuzhina u dëgjua një zhurmë e disa krisma si ato të thyerjes së xhamave. Fëmija lëvizi nga vendi dhe u mblodh kruspull, si të fundosej në kolltukun e madh.

– Theu ndonjë pjatë. Nerva grash, – tha Xheladin Apollonia duke e hequr dorën nga jeku dhe duke e tundur në erë.

Pa mbaruar mirë fjalët akademiku, hyri Neta, siç ishte e pakrehur, me duar në ije dhe me një grimazë të egër në fytyrë:

– Po këtë ç’ma solle? Ma solle për hyneret që bëri në konferencë? Pika, pika! Ty kështu ta punojnë të gjithë. Ty të pështyjnë dhe me njérën dorë fshin pështymat, kurse me tjetrën i kap për krahu, duke i ftuar për drekë dhe për darkë! Pika burrit! – iu kanos ajo akademikut ballë për ballë.

– Mirë, mirë! Shko krihu! – tha fare i qetë Xheladin Apollonia.

– Dashke t’i dal edhe e kreher këtij lugati me hundën me lesh, si gjemba e atij kaktusit që kemi në ballkon! – thirri Neta e zbehtë si qiriri prej dhjami.

Dane Gajtani si gjithmonë kur përmendej leshi, vuri dorën mbi hundë si për të fshehur qimet e dendura.

– Mos i fshih, Dane, mos i fshih! – tha natyrshëm Xheladin Apollonia për qimet e hundës dhe Dane Gajtanit i erdhi aty për aty pér të qeshur. Ai e mbajti frymën, u skuq i téri dhe pastaj shpërtheu. Ishte një bombë qeshjeje me një shpërthim të hatashëm. Me sa dukej gjithë ato çaste ankthi dhe dëshpërimi që kishte përjetuar, tani kaluan në një trajtë tjetër, në trajtën e të qeshurit. Në çast filloj të qeshë me të madhe edhe Xheladin Apollonia bashkë me fëmijën e ngritur në gjunjë në kolltuk. Neta u hutua. Vuri dorën para gojës dhe vrapi në kuzhinë. Të dy burrat nuk e kuptuan. Por ajo qante.

E zonja e shtëpisë e shtroi drekën, por vetë nuk u ul në tryezë. Ajo e mori fëmijën për ta ushqyer në kuzhinë, duke i lënë ata të dy në studio. Le të bënin ç’të donin. Sytë le të nxirrin. I vinte keq vetëm për fëmijën.

Xheladin Apollonia i mbushi gotat me raki, dy gota të mëdha të kristalta, që vunë nga një zinxhir me rruza të vogla si pika vese, apo si bulat e shiut që duken nga poshtë në telat e telefonit.

– Të na bëjë mirë! Të kthehem atje nga kemi dalë! – tha ai, duke nënkuptuar origjinën prej fshatari.

– Gëzuar! – tha Dane Gajtani dhe e trokiti gotën e tij me të Xheladinit.

Ishte një gjë krejtësisht e paparashikuar dhe jashtë logjikës së rrjedhës së ngjarjeve. Si mund të bashkoheshin përsëri ata të dy pas gjithë atij tensioni nervash në atë të mallkuar konferencë? Mbase vërtet ishte një thirrje e nëndheshme e origjinës, apo një joshje që bënte një mendim i përbashkët gjithashtu i nëndheshëm, mendim ky për gjërat që nuk shkojnë në këtë jetë, por njerëzit ashtu siç nuk pajtohen me to në çaste të veçanta, ashtu edhe i kundërshtojnë po në çaste të veçanta, kur janë vetëm dhe nuk i dëgjon askush. Mund të jetë edhe diçka tjetër. Xheladin Apollonia e di se Dane Gajtani do të përfundojë keq. Keq, domethënë, atje ku flitet me muret. Ai sikur kërkon ta parapërgatitë Dane Gajtanin që në hetuesi të mos flasë ndonjë fjalë për shokun e vet të fëmijërisë. Sido që të bëhet të mos flasë...

– Unë dua që... – nisi të shpjegohet Dane Gajtani pas dytri gotave të pira me fund.

– E di, mos m'i thuaj!

Këtu Dane Gajtani e përplasi gotën. U, ky gjithmonë ma pret fjalën dhe më thotë e di! Tuaf njeri...

– Hiç, asgjë nuk di! – tha Dane Gajtani me zemërim.

– Ti do ta lësh tek unë djalin që ke marrë në shtëpinë e fëmijës. Unë pas një kohe do ta dërgoj në fshat tek jot ëmë! Ja, kjo është!... Dhe këtë di unë...

Miku hapi gojën dhe sytë. E mbushi vetë gotën dhe e ktheu me fund. Xheladin Apollonia nuk ia la të zbrazur. Përsëri e piu me fund.

– Nga e ditke ti, Xheloi? – pyeti ai, duke ngrënë pak rrokjet e fjalëve.

– Hëm! Ty të ndjekin. Pastaj... Lëre, lëre! I vogli mbetet ose rrugëve, ose dërgohet përsëri në shtëpinë e fëmijës. Këtu e le tek një miku yt. Të pyesin atje se çfarë të lidh me Xheladin Apolloninë? Vetëm origjina, asgjë tjetër. Çfarë kini biseduar? Hiç asgjë. Qyfyret e fëmijërisë! Bamb me dru dhe me çizme! Hiç asgjë... – tha Xheladin Apollonia duke vërtitur gotën nëpër gishtërinjtë. – Hëm! E dëgjove atë qukapikun Sotir Kucka si tha për mua në konferencë, se gjoja unë e paskam lexuar fjalimin tënd që në dorëshkrim dhe duke ditur për-

mbajtjen, ta dhashë fjalën? Ë? Më bën bashkëpunëtor me ty!... Do të të pyesin në hetuesi, ti hiç! Gënjeshtra!...

Dane Gajtanit i doli rakia. Ato gotat e pira me fund iu kthyen në ujë. Për t'u turbulluar ai piu edhe tri të tjera. – Ti, Xheladin, je burrë i lig! – tha ai me sy në tryezë.

Akademik Xheladin Apollonia vuri me zor buzën në gaz: – E, pse qenkam burrë i lig?

Sakaq Dane Gajtani pështeti ballin në tryezë, duke e larguar pjatën. Ashtu me ballë në tryezë filloj të qajë me dënesë. Ishte një qarje burri, që vinte nga thellësitë e mëdha të vetëdijes. E, ai kujtoi se Xheladin Apollonia do t'i bënte një të mirë si një shok i fëmijërisë nga i njëjtë fshat. Kurse Xheloja... Por Dane Gajtani ishte zënë ngushtë. Ku ta shpinte fëmijën dhe cilit t'ia jepte? Ai ishte gati të ngrihej nga tryesa, të merrte djalin dhe të ikte prapa diellit.

– Dane, çfarë bën? – u shqetësua Xheladin Apollonia dhe ia vuri dorën në kokë.

– Je i poshtër, Xhelo! – murmuriti ai, duke ngritur kokën dhe duke fshirë lotët me picetë.

Ndërkohë ra zilja e derës. Xheladin Apollonia u ngrit, por Neta nuk e la. Ajo vrapi e para për ta hapur. Jashtë u ndie zëri i Ritës. Neta ktheu kokën nga Xheladin Apollonia, që bënte me dorë për ta larguar Ritën. Menjëherë u ngrit Dane Gajtani, u drejtua në derë dhe thirri:

– Jemi këtu, Rita! Po pijmë e po bëjmë qejf me akademik Xheladin Apolloninë.

Me këmbë në dysheme si të marinarat në kuvertën e anijes, ai u lëkund, mënjanoi Netën dhe hapi derën. E zuri për krahu Ritën dhe e futi brenda:

– E sheh? Po pimë me rastin e mbarimit me sukses të plotë të konferencës!

Pastaj i thirri fëmijës:

– Gjoni, eja ta takosh teta Ritën! Tetë kaq të bukur ti nuk ke parë kurrë!

Djali doli nga kuzhina dhe iu afroa Ritës.

– Uh, sa i mirkë! – ia bëri Rita mes hutimit në një skenë të çuditshme që nuk e priste.

Xheladin Apollonia me tē shoqen kishin mbetur tē trullo-sur duke e vështruar njëri-tjetrin, sikur tē ishin tē panjohur në një apartament tē huaj.

Kapela prej kashte kishte rënë në truall, kur Dane Gajtani ishte ngritur tē takonte Ritën. Ai shkoi e mori kapelën, e zuri pér dore Gjonin e vogël, e vështroi gjatë akademik Xheladin Apolloninë dhe tundi kokën:

– Ti je burrë i lig, Xhelo! – dhe u nis tē dalë.

– Ku vete? Po fëmijën nuk do ta lësh? – i doli përparrë Xheladin Apollonia.

Ai i hapi krahët dhe e largoi akademikun. – Do ta shpie përsëri në shtëpinë e fëmijës. Mbase vjen nëna ime dhe e merr. Ti, Rita, një tē mirë do tē më bësh. Lajmëroje nënën dhe shko bashkë me atë në shtëpinë e fëmijës pér ta marrë Gjonin. Dokumentet po t'i lë ty!... Rita, e shtangur, një herë i ndalte sytë në fytyrën e Xheladin Apollonisë dhe një herë në atë tē Dane Gajtanit. Ajo nuk po e kuptonte se çfarë kishte ndodhur me ata tē dy, veçse e ndjente që Dante Gajtani ishte fyer rëndë nga akademiku. Ndjente edhe diçka tjetër. Të dy ata kishin pirë dhe në pije e sipër ishin zënë. Dhe më i dehur iu duk Dane Gajtani, prandaj vendosi t'i hapte rrugë dhe tē bënte siç urdhëronte ai. Nuk ia merrte mendja se do t'i kishte parë në një gjendje tē tillë. Ajo vetë shpejtoi ta takonte Dane Gajtanin me tē marrë vesh nga Sotir Kucka se ia paskësh zënë syri nën shkallët e apartamentit tē Xheladin Apollonisë me një fëmijë tē vogël në prehër.

– Ju paski pirë! – tha Rita. – Kjo nuk ka ndodhur asnëherë në shtëpinë tuaj! – iu kthyte ajo profesor Xheladin Apollonisë dhe tē shoqes së tij, Netës.

Neta kafshoi buzën dhe bëri me kokë nga akademiku pér tē treguar se ai i kishte fajet. Dane Gajtani e vuri re buzën e kafshuar tē Netës dhe shfryu:

– Po ti ç'ma kafshon atë buzë dhe mjaullit si macet në shkurt?

Neta uli kokën e fyer, ndërsa Xheladin Apollonia vështron-te me buzëqeshjen e njeriut zemërgjerë që bën lëshime në këto raste. Me këtë vështrim ai donte tē thoshte se nuk kemi

ç't'i bëjmë Dane Gajtanit, domethënë Daneja, si Daneja!...

Edhe pse i turbulluar nga rakia dhe nga zemërimi, Dane Gajtani këtë e kuptoi, por në të njëjtën kohë ndjeu edhe një lodhje e këputje të tmerrshme, prandaj heshti.

Ai e tërhoqi Ritën me vete dhe doli tok me të nga apartamenti i Xheladin Apollonisë, duke mbajtur për dore fëminë, që nuk bëzante.

– Për ku shpejton? – tha Rita, duke zbritur shkallët.

– Ah, për ku shpejtoj!...

– Po sikur ta mbaj unë fëmijën, gjersa të vijë nëna jote ta marrë? – tha Rita dhe shtoi: – mbase me ty nuk ndodh gjë...

Atij i erdhi ta ngrinte hopa Ritën dhe ta zbriste në krahë nëpër shkallët. U afrua pranë saj, ia hodhi krahun në shpatull dhe e shtrëngoi në gjoks, duke e puthur në buzë, në faqë, në qafë, në sy e në ballë aspak si një femër, por si diçka tjeter të madhe dhe të shenjtë. Rita i bindej dhe nuk largohej prej tij.

– Që këtu do të ndahemi. Në rrugë do të dal vetëm... – tha ai.

E përqafoi edhe një herë Ritën, e mori në krahë Gjonin, e puthi dhe i tha se kjo teta do të jetë si një mama e mirë dhe e bukur gjersa të kthehet babi, që ka pak punë në një vend.

Ata u ndanë në mesin e shkallëve.

Duke ecur, pa kthyer kokën nga pas, ai filloj gjysmë të recitojë e gjysmë të këndoje vargje si gjithmonë të panjohura për Ritën:

*Ju flamujt e mi, lamtumirë,  
Ju flamujt gjakosur e grisur,  
T'ju mbaja ka qenë e vështirë,  
T'ju hidhja, s'kam qenë i lajthitur.*

*Ndaj vdisni në gjurmët e gërryera,  
Përzibi mes hirit dhe rërës  
Dhe shtribi me shtiza të thyera  
Në shkallët e verdha të hënës*

*Atje në Saharën e Ëndrrës...*

Për Ritën kjo këngë ishte pa kuptim. Çfarë fjamujsh të grisur kishte ky Dane Gajtani, pse duhet t'i mbante apo t'i hidhete? Vetëm ai mund ta dinte! Por, mbase, edhe mund të ishte vajtimi i këtij kalorësi lakuriq...

Dane Gajtani i ra me grusht murit, duke thënë me vete se me kokë nuk mund t'i binte dot, pasi i dhëmbte, dhe zbriti me vrap poshtë përmes një zhurme të madhe hapash, sikur rrrokullisej diçka e rëndë. Duhej të shkonte në hotel «Peza», ku mbase e priste ai gazi i zi kinez. Që nga mesi i shkallëve i erdhi zëri i Ritës:

– Mirupafshim, Kalorësi lakuriq!

1979-1995

## KUJTESË PËR LEXUESIN

Romani «Kalorësi lakuriq» është shkruar kryesisht që në vitin 1979. Në fillim të viteve '80-të është botuar në revistën «Hosteni» vetëm kapitulli i parë me këmbënguljen e kryeredaktorit të atëhershëm Niko Nikolla, si gjithmonë dashamirës ndaj meje. Në fund të vitit 1990 është dhënë në gazetën «Drita» një variant disi i shkurtër i romanit me titullin - «I nëmuri», i cili nisi të botohej që në muajt e parë të vitit 1991 në disa numra njëri pas tjetrit.

Varianti që botohet është i plotë, siç është shkruar atëherë, me ndonjë plotësim fare të vogël në formë, por edhe diçka të parëndësishme në përbajtje. Në roman pasqyrohen ato shqetësime të njerëzve dhe ato mendime që kishte nxjerrë koha si rrjedhim i ngecjes dhe ngrirjes së shoqërisë, i krizës shpirtërore dhe ideore të saj. Duke pasur këtë sfond të krizës së përgjithshme të shoqërisë, pasqyrohen edhe raportet e njerëzve, dashuritë e turbullta dhe dëshirat.

Kapitulli i katërt në «Drita» është botuar fare i shkurtuar vetëm për arsyen vendi në gazetë. Në botimin e ri ky kapitull është dhënë i plotë. Botimet e romaneve dhe e prozës së gjatë në gazeta, gjithmonë nuk mund të jenë të tërësishme, pasi përbajtja e tyre copëtohet dhe shpérndahet. Vetëm kur publikohen në libra më vete quhen si botime të vërteta, pasi atëherë lexuesi formon një ide të plotë për veprën e autorit.

Dritëro Agolli

## BOTIME ÇABEJ

### VERBA MUNDI

1. Eqrem Çabej *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*
2. Gabriel Partos *Bota që erdhi prej të ftotit*
3. Georges Castellan *Histori e Ballkanit*
4. Bernd J. Fischer *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*

### KONSTELACIONE

1. Fatos Kongoli *Kufoma*•
2. Helena Kadare *Një grua nga Tirana*
3. Ismail Kadare *Piramida*
4. Ridvan Dibra *Nudo* •
5. Jamarbër Marko *Rastësishët me dashje*
6. Pjetër Arbnori *E bardha dhe e zeza*
7. Ismail Kadare *Shkaba*
8. Charles Bukowski *Femrat*
9. Dritëro Agolli *Kalorësi lakuriq*
10. Pjetër Arbnori *E panjohura, Vdekja e Gëbelsit*
11. Agatha Christie *Krim në Orient-Ekspres*
12. Susanna Tamaro *Thuaji zemrës po*
13. Luigi Pirandello *Jeta lakuriq* •

### LLAMPA MAGJIKE

1. Charles Perrault, *Zonja d'Aulnoy E bukura e pyjeve*
2. Pierre Gripa *Përrallat e rrugës «Broka»*
3. Vellezërit Grimm *Na ishte njëherë...*
4. Maurice Sendak *Hop këtu e hop atje, rrrokopujë e bëjmë ne!*
5. Virgil Muçi *Përralla shqiptare për 100 + 1 natë*
6. Mira Meksi *Magjistrica e Dyimbëdhjetë Pasqyrave*
7. Gaqo Bushaka *Çufoja dhe Bubi Kaçurrel*
8. Mimoza Erebara *Aventurat e 10 x 10 dhe Munuriro Kokëposhtit*

### TITUJ JASHTË KOLANAVE

Ferdinand Leka, Zef Simoni *Fjalori italisht-shqip*  
Kujtim Murati *Nata fle mbi tokë*

## Konstelacione 9

*Dritëro Agolli është Kafka me pak më shumë diell.*  
François Nourissier «Figaro Magasin»

*Një autor që meriton famë evropiane.*  
Alain Bosquet «Le Figaro»

*Vepra e Dritëro Agollit na intereson edhe për vlerën  
e saj universale.*  
Pierre Gamarra «Europe»